

# Ballafaqimi me realitetin

kujtimi i së kaluarës - formimi i së ardhmes



## **Ballafaqim me realitetin**

përkujtim i së kaluarës -  
formimin e të ardhmes

Vështrim gjithëpërfshirës  
në kulturat lokale të mbamendjes  
në tri komuna multietnike

**Pilot-projekt i Forumit Qendra  
Civile Paqësore - Maqedoni dhe Civil  
Qendër për liri**

ISBN-10 608-65629-6-2

ISBN-13 978-608-65629-6-0

EAN 9786086562960

# Ballafaqimi me realitetin

kujtimi i së kaluarës - formimi i së ardhmes  
vështrim gjithëpërfshirës mbi kulturat lokale të kujtesës në tri komuna shumetnike

**Autorë:**

**Gordana Duvnjak, Kirsten Shonefeld, Xhabir Deralla, Jos Beker**

**Biljana Jordanovska, Arbana Qerimi, Sasho Talevski, Kreshnik Ajdini**



## **Ballafaqimi me realitetin**

Kujtimi i së kaluarës - formimi i së ardhmes (Pilot projekt i Forumit Qendra Civile Paqësore - Maqedoni dhe Civil - Qendra për Liri)

**Botues:** CIVIL - Qendra për Liri dhe Forumi Qendra Civile Paqësore - Maqedoni

**Për botuesit:** Xhabir Deralla dhe Silke Majer Vit

**Redaktorë:** Xhabir Deralla dhe Kirsten Shonefelld

**Autorë:** Xhabir Deralla, Kirsten Shonefelld, Gordana Duvnjak, Biljana Jordanovska, Arbana Qerimi, Sasho Talevski, Kreshnik Ajdini, Jos Bekër

**Redaksi gjuhësore:** Natasha Cvetkovska, Kreshnik Ajdini, Biljana Jordanovska, Biljana Zdraveska

**Dizajn:** Arian Mehmeti dhe të tjerë

**Shtypi:** TP Dule 99, Shkup

### **Kontakte:**

CIVIL - Qendra për Liri

**Adresa:** Mito Haxhivasilev Jasmin 12/5, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

**Tel:** 02/5209176

civil@civil.org.mk

civil.mk@gmail.com

**[www.civil.org.mk](http://www.civil.org.mk)**

**[www.civil.today](http://www.civil.today)**

[www.facebook.com/civil.mk](https://www.facebook.com/civil.mk)

[www.twitter.com/CivilMacedonia](https://www.twitter.com/CivilMacedonia)

[www.youtube.com/user/CivilOrgMK](https://www.youtube.com/user/CivilOrgMK)

**[www.forumzfd.de](http://www.forumzfd.de)**

Marrja, publikimi dhe citimi i këtij publikimi është i lejuar nën rregullat e parapara me licencën Creative Commons Attribution 4.0 International License.

- 5** Parathënia
- 13** Qëllimet dhe metodologjia
- 25** Histori paralele dhe kujtesë selektive
- 49** Aktorë dhe palë të interesit
- 64** Kryetarët e komunave: Çair, Tetovë dhe Kërçovë
- 75** Muzetë || Kultivimi i kulturës së kujtimit në shkollat në Çair || Biblioteka "Koço Racin" - Tetovë
- 83** Përzgjedhje nga përmbajtjet on-line dhe të shtypura të përkushtuar ngjarjeve historike të përfshira me këtë hulumtim



# Parathënie

Ai që e kontrollon të kaluarën,  
e kontrollon të ardhmen.

Ai që e kontrollon të tashmen,  
e kontrollon të kaluarën.

Xhorxh Orvel, 1984

**H**istoria dhe kujtesa janë jashtëzakonisht prezente në jetën e njerëzve në Republikën e Maqedonisë. Ngjarjet nga e kaluara shpjegohen me një numër shumë të madh të mënyrave, të cilat mbivendosen dhe përplasen njëra me tjetrën, varësisht nga politika etno-fetare dhe nacionaliste në vend. Mbeturinat e ideologjive të ngurta dhe anakronike nga e kaluara, të përziera me ndjenjat nacionaliste, vlerat dhe identiteti të zbuluara së voni, kanë ndikim të madh mbi politikën dhe praktikën në nivelet zyrtare, si dhe mbi kulturën, mediat dhe arsimin.

Ballafaqimi me të kaluarën paraqiste një çështje të rëndësishme në shoqëritë post-konfliktuale në Bosnjë e Hercegovinë, Serbi dhe Kroaci, siç është thënë edhe nga një numër i madh i autorëve, se “në krahasim me shoqëritë e tjera post-konfliktuale, ‘iniciativat për ballafaqimin me të kaluarën’ filluan shumë herët në Ballkanin Perëndimor dhe për to u siguruan resurse të rëndësishme nga ana e bashkësisë ndërkombëtare”.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Martina Fischer dhe Ljubinka Petroviq-Ziemer: Ballafaqimi me të kaluarën në Ballkanin Perëndimor, Iniciativa për ndërtimin e paqes dhe të së drejtës tranzicionale në Bosnjë e Hercegovinë, Serbi dhe Kroaci, Berghof Report No/ 18, 2013

Pa dallim se sa është kjo e vërtetë për vendet e ish-Jugosllavisë, në të cilat shpërthyen luftërat në fillim të viteve 1990-ta, ky përfundimisht nuk është rasti me Maqedoninë. Inkuadrimi ndërkombëtar për dhënien fund të konfliktit etnik në vitin 2001 ishte shumë i madh, por ky inkuadrim pastaj u zbeh në periudhën post-konfliktuale në pjesën e ballafaqimit me të kaluarën. Krahas disa iniciativave dhe konferencave, është bërë pak për zgjidhjen e çështjeve të hapura.

Rastet juridike dhe çështjet politike, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me ngjarjet e konfliktit etnik të vitit 2001, vazhdojnë të jenë nën vallon e spekulimeve, si dhe të manipulimeve dhe negociatave politike. Konflikti, kushtet dhe ngjarjet të cilat sollën deri te kjo, si dhe pasojat e drejtpërdrejta, vazhdojnë të jenë çështje të hapura në vend. Rastet me personat e zhdukur (12 maqedonas dhe 6 shqiptarë), torturimi i punëtorëve ndërtimor të ndërmarrjes “Mavrova” dhe disa të tjerë, ende nuk janë zgjidhur në nivel shoqëror, krahas përpjekjeve të politikanëve të vendit për t’i mbyllur në korniza juridike/institucionale.

Ekziston një mungesë e përpjekjeve për fillimin e çfarë do lloji të debatit sa u përket “çështjeve të hapura”. Përkundrazi, konfliktet dhe luftërat janë të përfshira në memorien kolektive të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Krahas konfliktit të vitit 2001, periudha dhe ngjarje të tjera, siç është Periudha Otomane, Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore – duket se mbeten në mënyrë të çuditshme të paprekura në kuptimin e vërtetë të ballafaqimit me të kaluarën. Qeveria dhe institucionet shtetërore përpunuan dhe realizuan projekte masive dhe të shtrenjta për formësimin e ri të historisë dhe identitetit të maqedonasve etnik në vend. Këto përpjekje u përplasën me projekte për rritjen e nacionalizmit shqiptar etnik nga ana e partnerit të koalicionit qeveritar, partisë politike kryesore të shqiptarëve etnik në vend – Bashkimi Demokratik për Integritim.

Shoqëria e Maqedonisë në masë të madhe vuan nga politikat



(partiake) etnikisht të ndara dhe tejet të politizuara, të orientuara nga e kaluara. Shembuj dhe dëshmi për gjendjen e këtillë mund të takohen në bazë ditore, siç është pritja pompoze nga ana e institucioneve dhe personave më të lartë shtetëror (maqedonas etnik) të ish-nëpunësit policor Johan Tarçullovski, i dënuar me burg nga ana e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë (TNPJ) në Hagë, për kryerje të krimeve të luftës kundër civilëve shqiptarë etnik, gjatë konfliktit të vitit 2001, që mjaft flet për kushtet e politikave të orientuara nga e kaluara. Ai u prit jo si njeri i cili ka kryer krime lufte serioze, por si hero – kontradiktë për nga definicioni.

Është e qartë se efekti i ngjarjeve të këtilla (dhe ka shumë të këtij lloji në dekadën e fundit) është dezintegrues për tërë shoqërinë, e cila duhet të përpiqet të krijojë një identitet të pasluftës dhe të kujdeset për marrëdhëniet ndëretnike në një vend shumetnik.

Mungesa e iniciativave është e dukshme. Përveç te institucionet shtetërore dhe politike, iniciativat për ballafaqim konstruktiv me të kaluarën mungojnë edhe te aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të shoqërisë civile, që në tërësi ndikon mbi mënyrën me të cilën në kohë të sotme në Maqedoni trajtohet e kaluara. Me arsye ende pamjaftueshëm të zgjidhura për konfliktin e vitit 2001, me çështje të hapura, siç janë ato të cilat kanë të bëjnë me personat e zhdukur, të cilat nuk janë zgjidhur edhe pas 13 vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO), ende nuk ka në horizont një konsensus mes dy grupeve etnike kryesore. Në vend të kësaj, ekziston një politikë e përjashtimit dhe segregacionit.

Prodhimi më i dukshëm dhe më simbolik i politikave të këtilla të orientuara nga e kaluara është gjithsesi projekti kontrovers dhe i shtrenjtë Shkupi 2014. Projekti Shkupi 2014 përpiqet të merret njëkohësisht me trashëgiminë (e fabrikuar) antike maqedonase të kombit maqedonas, me vënien e theksit njëkohësisht mbi luftën çlirimtare nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX.

E njëjta gjë vlen edhe për anën shqiptare, ku, gjithashtu, ngjarje, simbole dhe heronj të kohës së formimit të kombit shqiptar dhe të shtetit shqiptar gjenden në krye të kujtesës. Megjithatë, kjo realizohet në një masë më të vogël, për shkak të kufizimeve buxhetore dhe politike, me të cilën gjë gjenerohen më shumë frustrime dhe ndarje. Historia më e re është mjaft prezente. Në anën shqiptare, ajo është e shoqëruar me përsëritjen e vazhdueshme të kujtesës për UÇK-në dhe betejat në vitin 2001. Në anën maqedonase etnike, 2001-shi paraqet motiv i cili përsëritet në media, kulturë, arsim dhe kujtesë, por, në një mënyrë mjaft konfrontuese, larg nga çfarë do mënyrë të zgjidhjes.

Si një nga "bashkuesit" e rrallë për grupet etnike, në dokumentet politike dhe akademike, si dhe në paraqitje të caktuara, përmendet Kryengritja e lindenit e vitit 1903, kundër pushtimit otoman. Krahas shpresës legjitime të brishtë, se kryengritja (e përbashkët) kundër pushtimit osman mund të funksionojë si pikë referuese për identitetin e përbashkët të grupeve etnike në Maqedoni – moskuptimet e vazhdueshme sa i përket kësaj ngjarjeje historike mes bashkësive etnike në vend, si dhe mes qeverisë maqedonase dhe asaj bullgare, hedh një hije të rëndë mbi këtë shpresë. Kjo tregon: çfarë do lloji i identitetit të ndër-tuar mbi vijat e demarkacionit etnik, është i dënuar me dështim.

Gjithashtu, kjo flet edhe për dobësitë e qasjes së tërësishme të politikave të udhëhequra në të kaluarën në Maqedoni – madje, nga të dy palët. Çfarë do lloji i politikës, e cila fokusohet mbi proceset e ndërtimit të kombit nga shekulli XIX dhe fillimi i shekullit XX, në përpjekjen për ta kultivuar ndërtimin e vonshëm të kombit, paraqet një anakronizëm – që mund t'u shërbejë nevojave afatshkurtra të sipërmarrësve etnik politik, nëpërmjet përforsimit të politikave të përjashtimit, por, fare nuk është në pajtim me karakterin shumetnik të vendit dhe është tërësisht e kundërt me orientimin e saj të proklamuar evropian. Jo në një paskomb-shtet të shekullit XXI.

Më se e qartë është se politikat e këtilla të orientuara nga e kaluara në Maqedoni paraqesin një përpjekje për t'u kontrolluar e tashmja dhe e ardhmja e shtetit. Siç thekson Orveli në romanin e tij të njohur "1984": Ai që e kontrollon të kaluarën, e kontrollon të ardhmen. Ai që e kontrollon të tashmen, e kontrollon të kaluarën. Përpjekja e këtillë për ta fituar të kaluarën kushton shumë; kjo në fund do të sjellë deri te një situatë në të cilën të gjithë janë humbës. Asnjë grup etnik apo politik nuk do ta fitojë të ardhmen nëpërmjet përforcimit të së kaluarës së vet, por, të gjitha grupet do ta humbin rastin për të ndërtuar një identitet të përbashkët dhe do të drejtohen nga e ardhmja e errët. Shpifja e historisë dhe shtrembërimi i fakteve historike mund të jetë politikisht fitimprurëse në afat të shkurtër, por, sigurisht që sjell humbje të mëdha në bazë afatgjate.

Politika e tanishme në Maqedoni e identiteteve të orientuara nga e kaluara me siguri se nuk është në të mirën e mirëqenies së vendit. Vendi gjendet në një kundërthënie të vazhdueshme me të kaluarën e vet, sidomos duke pasur parasysh karakterin e tij shumetnik, si dhe faktin se ai vazhdon të shërohet nga një konflikt etnik të dhunshëm. Krahas të gjitha këtyre, duket se vendi është i mbërthyer edhe në procesin e pafund të tranzicionit. Megjithatë, duket se përfitimet gjenden në kuadër të fitoreve afatshkurta të fuqisë politike dhe kontrollit mbi financat publike.

Shumica, nëse jo të gjitha, e politikave dhe praktikave të tanishme në fushën e ballafaqimit me të kaluarën, ndikojnë në shumë mënyra mbi të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Shënimi dhe kultura e kujtesës, si komponent më integral dhe më mbresëlënës të asaj që e njohim si ballafaqim me të kalu-

arën, është e qartë se mbështeten me shovinizmin nacional dhe diskriminimin etnik dhe fetar. Pastaj, është e zhvilluar kultura e pabarazisë gjinore, me të cilën gjë ulet roli i gruas, apo, më saktë, roli i saj kufizohet në një mjet reproduktiv. Lufta dhe dhuna konsiderohen si vlera më të larta. Vetëm me një shikim të shpejtë mbi numrin treshifror të përmendoreve të përfshira me projektin Shkupi 2014 dhe të cilat u ndërtuan në 5 vitet e fundit, do të sigurohet dëshmi fizike më se e nevojshme për përkrahjen e këtij supozimi.

Me rëndësi më të lartë është që të zhvillohet koncepti konstruktiv dhe i orientuar nga e ardhmja, për ballafaqimin me të kaluarën, për të gjitha shoqëritë paskonfliktuoze dhe vendet që shkojnë drejt demokracisë. Është shumë e rëndësishme se si një shoqëri ballafaqohet me të kaluarën e vet dhe si e shënon luftën. Elitat politike maqedonase përfundimisht nuk ia dalin të ballafaqohen me realitetin gjatë ballafaqimit me çështjet e tilla.

Ballafaqimi me të kaluarën paraqet një proces shumështrësor të transformimit, i cili kombinon masa për të drejtën për të ditur, të drejtën për drejtësi, të drejtën e dëmshpërblimit, si dhe garancinë për mospërsëritje – siç theksohet në kornizën me ndikim të cilën e zhvilloi Swiss Peace.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Korniza konceptuale e ballafaqimit me të kaluarën u elaborua nga Swisspeace dhe Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrës. Është bazuar në parimet të cilat Luis Xhointi, si raportues i posaçëm i KB, rekomandoi në vitin 1997 në raportin e tij çështjen e mosndëshkimit të autorëve të krimit ndaj të drejtave të njeriut. Raportin mund ta shikoni në: <http://www.unhcr.ch/huridocda/huridoca.nsf/%28Symbol-%29/E.CN.4.sub.2.1997.20.Rev.1.En>

Kjo do të thotë kombinim i masave ligjore dhe simbolike në drejtim të shoqërisë, para së gjithash, për t'u sjellë drejtësi viktimave nga konflikti i kaluar, në bazë të standardeve të vendosura ndërkombëtare dhe mekanizmave për të drejtat e njeriut, siç është TNPJ. Kjo, gjithashtu, do të thotë të iniciohet një debat, i cili do t'u mundësojë viktimave, shkelësve dhe të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, të këmbëjnë qëndrime në lidhje me të kaluarën konfliktuoze, të njihet përgjegjësia për krime (luftë) dhe në këtë mënyrë të ndërtohet një identitet i ri, i përbashkët. Ky do të jetë një koncept për ballafaqimin me të kaluarën, i cili do t'i zgjidhë dhe nuk do t'i tejkalojë çështjet e hapura dhe do të ketë një qasje paqësore me dënimin e luftës, dhunës, nacionalizmit dhe shovinizmit. Do t'i përfshijë të gjitha grupet në shoqëri, maqedonasit dhe shqiptarët, të rinj dhe të moshuar, burra dhe gra. Gjithsesi, koncepti i këtillë i ballafaqimit me të kaluarën duhet ta distancojë vetveten nga çdo lloj dhune, si mjet për zgjidhjen e konflikteve dhe të drejtohet nga shtytja e demokracisë, sundimit të së drejtës, të drejtat e njeriut dhe jodhunës.

Kujtesa paraqet një pjesë thelbësore e veprimeve simbolike, me të cilën gjë preket gjithçka nga e lartpërmendura. Kur bëhet fjalë për efektet nga politika e deritanishme e kujtesës, e cila udhëhiqet nga fuqia, është e qartë se kujtesa paraqet një element të rëndësishëm në ndërtimin e identitetit të paskonfliktit. Identiteti i këtillë mund të dalë nga besimi i ri apo i rinovuar, koncept ky i paraqitur nga Pablo de Greif<sup>3</sup>.

---

<sup>3</sup> Për më shumë aspekte për lidhjen e ballafaqimit me të kaluarën dhe kujtesës, shiko kapitullin: Kujtimi i së kaluarës - formimi i të ardhmes. Pjesë nga letërsia shkencore ndërkombëtare mbi memorjen dhe kujtesën.

<sup>4</sup> Për më tepër, shiko: Pablo de Greiff. Koncepti normativ i të drejtës në tranzicion, në: Departamenti Federal i Punëve të Jashtme FDFA: Politorbis. Zeitschrift für Außenpolitik, Nr. 50, 3/2010, pp. 17-29. E disponueshme në: <http://www.dplf.org/uploads/1292518783.pdf>

Krahas masave juridike të domosdoshme për ndjekjen e shkelësve të ligjit të sundimit, për realizimin e këtij qëllimi mund të shërbejnë edhe elemente të shprehjes së të vërtetës dhe komisione për vërtetësinë. Fjala “civil”, gjithashtu, flet për llojin e identitetit, i cili është i mundur nëpërmjet ballafaqimit me të kaluarën, i cili përfshin identitetin civil, të drejtat e njeriut, liri dhe barazi sociale, në pajtim me diversitetin sa më të madh kulturor dhe etnik.

Ballafaqimi i këtyllë me të kaluarën sot, është posaçërisht i nevojshëm për Maqedoninë. Përvoja tregon se proceset për ballafaqim me të kaluarën, të cilët lokalisht janë ngulitur dhe udhëhiqen nga aktorët lokal, kanë mundësi më të madhe t'i përmbushin parakushtet e lartpërmendura dhe të kontribuojnë drejt ballafaqimit me të kaluarën, i cili do të jetë konstruktiv dhe i orientuar nga e ardhmja, në nivel kombëtar<sup>5</sup>.

Për këtë arsye vendosëm që projektin tonë ta vendosim në nivel të bashkësisë.

Shkup, pranverë 2014

Kirsten Shonefeld

Xhabir Deralla

---

<sup>5</sup> Shiko për këtë aspekt: Martina Fischer dhe Ljubinka Petrovic-Ziemer: Ballafaqimi me të kaluarën në Ballkanin Perëndimor, Iniciativa për Ndërtimin e Paqes dhe të Drejtës në Tranzicion në Bosnjë e Hercegovinë, Serbi dhe Kroaci, Raporti Berghof Nr/ 18, 2013

# KONTROLLI I REALITETIT: Kujtesa mbi të kaluarën – formimi i të ardhmes

## 1. Qëllimi i projektit: Krijimi i kulturave lokale inkluzive dhe kujtesa në nivel lokal

**D**uke i pasur parasysh vërejtjet hyrëse për rolin e Ballafaqimit me të Kaluarën (BK) dhe proceset e shënimit të ngjarjeve historike në vendet e tranzicionit dhe paskonfliktuoze, si dhe praninë e kulturës së kujtesës, e cila është joinkuadruese, së bashku me narrativat nacionalistike në Maqedoni, projekti e ka qëllimin siç vijon:

*"Të kontribuohet drejt zhvillimit të kulturës inkluzive të kujtesës në Maqedoni në nivel të bashkësisë dhe të zhvillohen kapacitetet e palëve lokale të interesuara për transformimin e konflikteve dhe ballafaqimin me të kaluarën."*

Prandaj, qëllimi i projektit është zhvillimi i koncepteve dhe krijimi i mundësive për këmbim të qëndrimeve të palëve lokale të interesuara dhe të qytetarëve, sa i përket të kaluarës konfliktuoze. Kjo do të thotë të vendoset kultura e kujtesës dhe balla-

faqimi me të kaluarën, e cila gjë do t'i inkuadrojë të gjitha grupet etnike, politike, të moshës dhe gjinisë, si dhe të gjitha qëndrimet dhe aspektet, sa u përket ngjarjeve dhe periudhave të kaluara. Në përpjekjen për t'u krijuar kultura dhe kujtesa lokale inkluzive dhe konstruktive në nivel të bashkësisë, Civil – Qendra për Liri dhe Forum ZFD do të punojnë së bashku me partnerët lokal dhe strategjik të shoqërisë civile, administratën shtetërore dhe politikanët. Standardet sa u përket të drejtave të njeriut dhe drejtësia e tranzicionit do të paraqesin një pikënisje për të gjitha përpjekjet tona, në mënyrën e cila shpjegohet më poshtë.

Deri në fund të projektit në vitin 2016, do të formulohen praktika dhe koncepte për kultura të kujtesës në nivel lokal në vend dhe do të përforcohen edhe kapacitetet e aktorëve lokal në pjesën e ballafaqimit me të kaluarën dhe me shënimet.

Pas fazës së parë nga marsi deri në gusht të vitit 2014, Forum ZFD dhe Civil – Qendra për Liri kishin për qëllim ta hulumtojnë gjendjen në pjesën e ballafaqimit me të kaluarën dhe kulturën e shënimit në nivel lokal në Maqedoni. Pasi fokusi kryesor i projektit është krijimi i kulturave inkluzive të kujtesës dhe nga kjo edhe një komponent i fuqishëm ndëretnik, zgjedhëm tri bashkësi shumetnike, të cilat janë me rëndësi të posaçme për marrëdhëniet ndëretnike në vend:

- Tetova është posaçërisht e lidhur edhe për shkak se ishte e goditur nga konflikti në vitin 2001.
- Kërçova, si komunë e fundit në të cilën dispozitat e Marrëveshjes Paqësore të Ohrit u realizuan nëpërmjet reformës territoriale të vitit 2013.
- Çairi, si komunë shumetnike me numrin më të madh të banorëve dhe (pjesërisht) e goditur me projektin Shkupi 2014.

Në fazën fillestare, nga ana e Civil – Qendrës për Liri gjatë majit dhe qershorit të vitit 2014, u organizuan shtatë takime me gru-



pet e qëllimit (gjashtë grupe të qëllimit monoetnike nga modeli i bashkësive dhe një grup i qëllimit shumetnik në nivel qendror) dhe 16 intervista me palët e interesit të shoqërisë civile lokale, politikanë vendor, historianë dhe persona të tjerë.

## 2. Të drejtat e njeriut dhe transformimi i konfliktit – qasje komplementare

**P**ara se të jepet shpjegimi i metodologjisë së studimit, gjegjësisht të hulumtimit aksionar dhe mbështetjes mbi praktikat për paqe, duhet të jepen vërejtje të caktuara sa i përket qasjes.

Përpjekja jonë është që të kombinohet qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut me aspekt të transformimit të konflikteve. Edhe pse të dyja perspektivat ofrojnë perspektiva të ndryshme analitike dhe funksionojnë me Teori të Ndryshimeve të ndryshme, konsiderojmë se kombinimi i tyre nuk mund të ofrojë një qasje të frytshme, multidisiplinore dhe të kontribuojë drejt krijimit të një paqeje të qëndrueshme dhe të ndihmojë të kultivohet demokracia dhe e drejta e sundimit.

Kjo do të thotë të kombinohen ide të ndryshimeve, të cilat janë të rrënjësura në qasjen ligjërisht të bazuar të të drejtave të njeriut dhe aktivitete në fushën e emancipimit, arsimit dhe lobimit me qasjen procesore-orientuese të transformimit të konfliktit.

Në këtë kontekst, qasja e Civilit është shumështrësore dhe e pasqyron realitetin socio-politik dhe kulturor të vendit në rajon, por, përfundimisht e paraqet edhe aspektin e të drejtave të njeriut, sa i përket ballafaqimit me të kaluarën. Sensibilizimi sa i përket çështjes së të drejtave të njeriut është i rëndësishëm kur bëhet fjalë për fushën e ballafaqimit me të kaluarën, duke pasur parasysh ndikimin e madh që e ka mbi gjendjen me të drejtat

e njeriut në nivel vendor dhe kombëtar, sidomos në pjesën e të drejtave të pakicave dhe të drejtave kulturore, por, gjithashtu, edhe në fushën e të drejtave ekonomike, arsimit dhe qasjes deri te drejtësia.

Nga aspekti i transformimit të konflikteve, ndryshimi mund të ndodhë vetëm kur faktorët në kuadër të shoqërisë e dëshirojnë këtë. Prandaj, ndryshimi nuk mund të imponohet nga jashtë, me intervenim të jashtëm, por, duhet të ndërtohet nga brenda. Besohet se me dhënien e kahes drejt proceseve konstruktive hapet mundësia për ndryshime në sjelljen dhe në qëndrimet e faktorëve. Në kuadër të këtij koncepti, palë të treta mund të luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e proceseve të transformimit të konflikteve<sup>1</sup>. Kështu që, në këtë projekt Forum ZFD e konsideron veten si palë e tretë, e cila ka për qëllim sensibilizimin e palëve lokale të interesuara sa i përket temës, si dhe lehtësimin e proceseve për vendosjen e kulturave lokale të kujtesës së bashku me partnerët lokal<sup>2</sup>.

## **Metodologjia: hulumtimi aksionar dhe shqyrtimi i praktikave për paqe**

Në përpjekjen për t'u kombinuar qasjet e bazuara mbi të drejtat e njeriut, ndërtimit të paqes dhe transformimit të konflikteve, ne zgjodhëm të punojmë me metodat e hulumtimit aksionar dhe shqyrtimin e praktikave për paqe.

---

<sup>1</sup>Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ): Lidhja mes të drejtave të njeriut dhe transformimi i konfliktit. Udhëzime për pjesëmarrësit të zhvillimit, 2011. URL: <http://hrbportal.org/archives/resources/connecting-human-rights-and-conflict-transformation-guidance-for-development-practitioners>.

<sup>2</sup> Për vazhdimin e leximit për Forum ZFD si palë e tretë, shikoje deklaratën e misionit: URL: <http://www.forumzfd.de/en/node/897>

Hulumtimi aksionar paraqet metodë për hulumtimin shoqëror, i cili ka tendencë ta kombinojë hulumtimin dhe proceset e mësimin, si për ata të cilët e bëjnë hulumtimin, ashtu edhe për ata të cilët i nënshtrohen hulumtimit. Prejardhja e metodës daton nga vitet e 40-ta të shekullit XX, ndërsa Kërt Levini konsiderohet si babai i saj. Sot praktikohet në disiplina më të ndryshme akademike<sup>3</sup>. Mes tjerash, kjo metodë është e përshtatshme për pilot-hulumtime, sidomos kur “gjendja është tejet e paqartë për parashtrimin e pyetjeve të sakta hulumtuese”. Pasi në Republikën e Maqedonisë deri më tani nuk është bërë një hulumtim mbi temën e kulturës lokale të kujtesës, pothuajse nuk ekziston njohuri akademike sa i përket kësaj, duket se metoda, siç është hulumtimi aksionar, është vërtet e përshtatshme për realizimin e studimit themelor.

Pasi që ky studim themelor duhet të paraqet një hyrje për shumë aktiviteteve projektuese, të cilat kanë për qëllim vendosjen e kulturave inkluzive, duket se është me rëndësi thelbësore që nga vetë fillimi në mënyrë aktive të inkuadrohen palët e interesuara, anëtarët e grupeve të qëllimit, si dhe shfrytëzuesit. Është supozim se inkuadrimi i këtyre personave jo vetëm që do të na sjellë deri te pranimi më i madh i aksionit dhe sigurimin e “nuk bën dëm” në kontekstin lokal, por edhe se dukshëm do të kontribuojë mbi cilësinë e hulumtimit, me atë që do të kihen parasysh mendimet dhe dituria e aktorëve lokal dhe popullatës lokale.

---

<sup>3</sup> Përshkrimi dhe citimi i kësaj pjese i referohet: O'Brien, R. (2001). Um exame da abordagem metodológica da pesquisa ação [Një shqyrtim i qasjes metodologjike të hulumtimit aksionar]. Në Roberto Richardson (Ed.), Teoria e Prática da Pesquisa Ação [Teoria dhe praktika e hulumtimit aksionar]. João Pessoa, Brazil: Universidade Federal da Paraíba. (Versioni anglisht): <http://www.web.ca/~robrien/papers/arfinal.html> (botuar më 20/1/2002)

Kjo pasqyrohet edhe në parimet e hulumtimit aksionar dhe në procesin e hulumtimit. Parimet e hulumtimit aksionar, të cilët do të përdoren gjatë formimit të studimit themelor për kulturat lokale të kujtesës në Maqedoni, janë:

- Kuptimi dhe pranimi i tjetrit si i ndryshëm nga unë;
- Dëgjimi i tjetrit;
- Gatishmëria të ndryshojmë vetveten, kontekstin dhe proceset në të cilët veprojmë dhe në të cilët reflektojmë;
- Kuptimi i idesë prapa veprimeve dhe aktiviteteve tona, zhvillimi i ndërgjegjes;
- Gjenerimi i teorive dhe koncepteve tona në bazë të përvojës, të cilën e fitojmë në praktikë;
- Pasurimi i praktikave tona nëpërmjet teorisë;
- Shfaqja e përgatitjes për të dyshuar në supozimet personale;
- Respektimi i diturive dhe arritjeve të të tjerëve dhe t'u lejohej të na inspirojnë në punën tonë;
- Qasja jonë është pjesëmarrëse dhe kooperative.

Sa i përket paradigmës hulumtuese, hulumtimi aksionar paraqet një paradigmë praktike. Kjo është mjaft e përshtatshme për një studim themelor, qëllimi i së cilit është praktika dhe ndryshimet në terren. Kjo do të thotë se ideja për neutralitet nuk mund të përdoret, sepse "hulumtuesi më aktiv më së shpeshti ka pjesë më të madhe në zgjidhjen e një situatë problematike". Sa i përket raportit teori-praktikë, ai është qarkullues sa edhe vetë procesi i hulumtimit. "Teoria e informon praktikën, ndërsa praktika e rredefinon në një transformim të vazhdueshëm".

Të gjithë këta parime dhe aspekte të hulumtimit aksionar i kemi pasur parasysh gjatë dizajnit të rrjedhës së veprimeve dhe re-

alizin e debateve me grupet e qëllimit, intervistave me palët e interesuara dhe gjatë krijimit të studimit themelor.

Ideja për reciprocitet, gjithashtu, implikon se edhe qasja edhe të dhënat u janë vënë në dispozicion të gjithë atyre që janë brenda procesit. Sipas qasjes së hulumtimit aksionar, pjesëmarrësit/bashkëhulumtuesit kanë të drejtë të jenë të informuar për qasjen, për rrjedhën e veprimeve dhe për rezultatet dhe kanë të drejtë ta thonë mendimin e vet sa u përket atyre.

Pikërisht për shkak të kësaj e publikojmë këtë studim në internet dhe në formë të shtypur dhe e bëjmë të disponueshëm për anëtarët e grupeve të qëllimit, palët e interesuara të cilat ishin të intervistuar dhe publiku i përgjithshëm. Gjatë kësaj dëshirojmë t'i përmirësojmë debatet vendore dhe kombëtare dhe ta rrënjosisim projektin tonë në kuadër të këtyre debateve.

### *Reflektimi i praktikave për paqe*

Për dallim nga hulumtimi aksionar, ne e kemi parasysh qasjen Reflektimi i Praktikave për Paqe (RPP)<sup>4</sup>. Njëra nga idetë e projektit RPP është se projektet paqësore i kanë parasysh të ashtuquajturat 'peace writ little' dhe 'peace writ large', që do të thotë të kemi parasysh procese paqësore më të mëdha dhe më të gjëra. E sjellë në kontekstin tonë, kjo do të thotë të bëhet hulumtim edhe i konteksteve lokale (Tetovë, Çair, Kërçovë) dhe të atyre kombëtare, si dhe kontekstit rajonal. Kjo do të përdoret edhe në hulumtimin e letërsisë dhe në ndarjen e një grupi të qëllimit në nivel lokal dhe kombëtar. Pastaj, në kontekstin vendor kjo do të thotë të inkuadrohen anëtarë të të gjithë sektorëve dhe niveleve të shoqërisë në kuadër të grupeve të qëllimit ("më

---

<sup>4</sup> Shiko për Reflektimin e projekteve për paqe, forma dhe dokumentet e projektit: URL: <http://www.cdacollaborative.org/programs/reflecting-on-peace-practice/>

shumë njerëz”) dhe të realizohen biseda individuale me të ashtuquajturit “njerëz kyç”, sepse kombinimi i të dyjave është definuar si një parakusht tjetër për suksesin e projekteve paqësore nga ana e projektit RPP.

Sa i përket Teorisë së Ndryshimeve, dizajni hulumtues, sidomos pyetësi i dedikuar për grupet e qëllimit dhe palët e interesuara, duhet ta pasqyrojnë komplementaren e nivelit individual dhe socio-ekonomik për arritjen e ndryshimeve. Për shkak të kësaj, pyetjet duhet t’i përfshijnë të dy nivelet, duke i hulumtuar perspektivat individuale dhe interaktive të kujtesave kulturore, por, gjithashtu, ta kenë parasysh edhe nivelin socio-politik, si shembuj të aspekteve grupore dhe politike, siç janë marrëdhëniet ndëretnike dhe efekti i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe aspekte të së drejtës tranzicionale.

### 3. Fushat e hulumtimit dhe pyetjet

**N**ë bazë të të menduarit metodologjik, u përpiluan pyetësorë anketues për intervista gjysmë të standardizuara. Pas hulumtimit të letërsisë ndërkombëtare dhe kombëtare profesionale për ballafaqim me të kaluarën dhe memorializim, vendosëm këtë studim ta orientojmë drejt formave të memorializimit në nivel lokal, përmbajtjen e tyre, faktorët e tyre, funksionet që ata i kanë dhe perspektivat për kulturat e kujtesës të orientuara nga e ardhmja dhe inkluzive. U realizuan intervista me grupet e qëllimit në bazë të pyetjeve kryesore në vijim.

#### **Forma të kulturës lokale të kujtesës**

- Në çfarë mënyre realizohet kujtesa: Cilat forma të kujtesës janë të pranishme (për shembull: përmendore, ngjarje, rrëfim individual i përrallave etj.)?
- A ekziston kujtesë inkluzive (ndëretnike dhe ndërpartiake) dhe nëse ekziston, kur dhe në çfarë forme mbahet?
- Cili është dallimi në praktikimin e kulturës së kujtesës të bazuar mbi përkatësinë gjinore?

#### **Përmbajtja e kulturës lokale e kujtesës**

- Cilat janë përmbajtjet më të rëndësishme të kujtesës për grupet e ndryshme në komunë dhe në vend?
- A ekzistojnë tema të përbashkëta të kujtesës për të gjitha grupet etnike në komunë?
- Çfarë mbahet mend dhe pse?
- Cilat janë temat, periudhat dhe ngjarjet të cilat janë eliminuar/margjinalizuar nga procesi i memorializimit?
- Si janë paraqitur grupet e ndryshme etnike dhe shoqërore/politike në kulturat lokale të kujtesës?

## **Aktorët e kulturës lokale të kujtesës**

- Cilat grupe (etnike/shoqërore/politike) janë përfshirë në procesin e memorializimit?
- Cilat janë grupet e fuqishme dhe cilat të marginalizuara në kulturat lokale të kujtesës?
- A kanë rol femrat në procesin e memorializimit dhe në rast se kanë, cili është roli i tyre (subjekt apo objekt i kujtesës apo të dyja)?

## **Funksionet e kulturave lokale të kujtesës**

- Cili është roli i kulturave lokale të kujtesës për komunën si tërësi dhe për grupet e ndryshme etnike dhe të tjera shoqërore në nivel lokal?
- Cili është funksioni specifik i tyre për bashkësitë e ndryshme etnike dhe grupeve politike në kuadër të bashkësive?
- A reflektojnë kulturat lokale të kujtesës ndarje aktuale politike, ndarje ndëretnike dhe si ndikon kjo mbi ta?
- Sa është e centralizuar kujtesa? Sa është e kaluara pjesë e të tashmes? Sa nga e tashmja është në të kaluarën? (qendrore - lokale; e kaluar - e tashme)
- Cili është roli që e kanë në raport me vendosjen e kulturës demokratike në nivel lokal?
- Cili është funksioni të cilin e kanë proceset lokale të kujtesës për identitetin kombëtar / ndërtimin e kombit dhe procese të tjera politike, sidomos për ndërtimin e paqes (OFA / Drejtësi Tranzitore)?
- Si kulturat lokale të kujtesës kontribuojnë në segregimin apo integrimin dhe polarizimin politik në nivel lokal dhe qendror dhe si këto procese janë ndërthurur mes vete?



## **Kultura lokale të kujtesës të orientuara nga e ardhmja / alternative**

- A janë kulturat lokale të kujtesës fare të dobishme?
- Si mund kulturat lokale inkluzive të kujtesës të kontribuojnë në përfundimin e marrëdhënieve ndëretnike, në ndërtimin e besimit dhe në kultivimin e procesit paqësor në nivel lokal dhe qendror?
- Cili mund të jetë roli i kulturave lokale të kujtesës në vendosjen e kulturës demokratike dhe në shtytjen e demokratizimit në nivel lokal dhe qendror?
- Si të inkuadrohen temat e marginalizuara / grupet e përjashtuara?
- Si do të dukeshin kulturat alternative të kujtesës të cilat do të inkurajonin paqe, jodhunë dhe kuptim ndëretnik? Cilat tema/ngjarje do t'i trajtojnë?
- Cilën formë do ta kishin?
- Cilat parakushte (shoqërore, politike, ekonomike) duhet të përmbushen, me qëllim të vendosjes së kulturës inkluzive të kujtesës?

**Kirsten Shonefeld**



Gordana Duvnjak

Histori paralele

kujtesë ekskluzive

# Histori paralele – kujtesë ekskluzive

**M**e qëllim që të fitojmë një pamje më të qartë për mendimet dhe qëndrimet e kategorive të ndryshme të njerëzve në tri komuna me popullatë të përzier, në periudhën maj-qershor 2014 u realizuan intervista me shtatë fokus grupe. Te të gjitha fokus grupet u përdor metodologjia identike, me qëllim që të bëhet një analizë krahasuese rreth perceptimit të tyre për çështje të fushës së kulturës së kujtesës, gjegjësisht ballafaqimin me të kaluarën, relevant për projektin.

Gjashtë fokus grupe u krijuan me nga pesë deri në gjashtë përfaqësues të bashkësive të cilat jetojnë në këto komuna, të cilat ishin me dominim monoetnik. Aq sa mundësonin kushtet, mbahej llogari edhe për llojllojshmërinë në bazë të strukturës së tyre gjinore, sociale dhe të moshës. Fokus grupi i shtatë përbëhej nga përfaqësuesit e të gjitha bashkësive të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë dhe shërbeu si resurs për analizë të gjendjeve në nivel kombëtar.

## **Strukturat e fokus grupeve nëpër komuna**

### **Çair**

Fokus grupin nga Komuna e Çairit (dominues me maqedonas etnik) e përbënin tre burra në moshë 30, 50 dhe 64-vjeçare, nga të cilët njëri është boshnjak, si dhe dy gra në moshë prej 40 dhe 45-vjeçare, nga të cilat njëra është anëtare e bashkësisë serbe.

Fokus grupi i përbërë nga shqiptarë etnikë nga komuna e Çairit përbëhej nga tre burra në moshë prej 37, 19 dhe 23-vjeçare, si dhe nga tre gra në moshë prej 21, 23 dhe 36-vjeçare.

### **Kërçovë**

Fokus grupi me maqedonas etnik në Komunën e Kërçovës numëronte gjashtë anëtarë, nga të cilët dy burra në moshë 60 dhe 56-vjeçare (rom), si dhe katër gra, nga të cilat dy në moshë 50-vjeçare, një në moshë 20-vjeçare dhe një në moshë 30-vjeçare.

Strukturën e fokus grupit nga komuna e Kërçovës, e përbërë nga pjesëtarë të bashkësisë shqiptare e përbënin dy burra në moshë 30 dhe 40-vjeçare, si dhe katër gra, nga të cilat dy në moshë 24-vjeçare, ndërsa dy të tjera kishin 36 dhe 64 vjet.

### **Tetova**

Fokus grupi me maqedonas etnik nga komuna e Tetovës përbëhej nga gjashtë veta, nga të cilët katër ishin burra në moshë 38, 42, 60 dhe 33-vjeçare, si dhe dy gra në moshë 20 dhe 25-vjeçare.

Fokus grupi me shqiptarë etnik numëronte 5 anëtarë, nga të cilët katër ishin burra, në moshë 23, 30, 35 dhe 50-vjeçare, si dhe një grua në moshë 24-vjeçare.

### **Niveli kombëtar**

Grupi i shtatë përbëhej nga gjashtë qytetarë me prejardhje etnike të përzier, nga të cilët katër ishin burra: maqedonasi (49-vjeçar), serbi (60-vjeçar), shqiptari (24-vjeçar), romi (24-vjeçar), si dhe dy gra, nga të cilat njëra maqedonase (27-vjeçare), ndërsa tjetra vllëhe (44-vjeçare).

## Cila periudhë historike është më e rëndësishme për ju dhe pse?

**N**ga përgjigjet e marra në këtë pyetje lehtë mund të arrihet në përfundim se ekziston një ndarje e dukshme e perceptimit në bazë etnike për atë se cilat ngjarje historike vlerësohen si më të rëndësishme. Ky perceptim nuk dallon dukshëm nga komuna në komunë. Kuptohet, përgjigjet e marra nga i ashtuquajtimi “fokus grupi kombëtar”, duke pasur parasysh përbërjen e përzier, jep një ndarje të qartë të përgjigjeve të dy bashkësive etnike më të mëdha.

Bie në sy se pjesëtarët e bashkësisë maqedonase janë përcaktuar kryesisht për tri ngjarje historike: Kryengritja e Ilindenit, ASNOM-i dhe Referendumi për pavarësi në vitin 1991.

Kryengritja e Ilindenit e vitit 1903 theksohet si një ngjarje e madhe historike, kur është bërë kryengritja e popullit maqedonas kundër pushtetit të osmanlinjve dhe është krijuar Republika e Krushevës. Plenumi i parë i ASNOM-it më 2 gusht 1944 perceptohet si një ngjarje në të cilën janë vendosur themelet e shtetit maqedonas. Dalja në referendum më 8 shtator 1991, nga ana e pjesëmarrësve vlerësohet si një datë e rëndësishme e historisë më të re, kur Maqedonia edhe zyrtarisht ndahet nga federata jugosllave dhe ka zgjedhur rrugën e vet të shtetit të pavarur.

Por, krahas këtyre përgjigjeve dominuese, si ngjarje të rëndësishme theksohet edhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001, si një dokument politik me të cilin i është dhënë fund konfliktit luftarak në Maqedoni. Përmenden edhe luftërat e Ballkanit, si dhe ngjarje të cilat kanë ndikuar mbi fatin e mëtejshme të shtetit maqedonas.

Në fokusin e pjesëtarëve të bashkësisë shqiptare të tri komunave, ngjarje kyçe historike është kriza luftarake e vitit 2001, e cila përjetohet si një fazë e re në jetën e shqiptarëve në Maqedoni.

Krahas dilemave rreth terminologjisë, prezent në publik dhe gjatë punës me fokus grupet, ajo qartë definohet si luftë, e shumë më rrallë në përgjigjet si konflikt apo krizë luftarake. Ngjarja e dytë e rëndësishme për shqiptarët është hapja e Universitetit të Tetovës, si realizim i përpjekjeve shumëvjeçare për ekzistimin e një universiteti shtetëror në gjuhën shqipe.

Por, njëkohësisht përmenden edhe ngjarje të cilat kanë një rëndësi më të gjerë për popullin shqiptar dhe kanë të bëjnë me ngjarje në Shqipëri dhe në Kosovë. E tillë është kriza me refugjatët në vitin 1999 dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës.

Në komuna të caktuara vërehen edhe specifika, kështu që ngjarjet e Bit-Pazarit janë prezente në përgjigjet e pjesëmarrësve nga Çairi, ndërsa pavarësia e Shqipërisë dhe alfabeti shqiptar, te ata të Tetovës.

Fokus grupi në nivel kombëtar, si më të rëndësishme i përmendi të gjitha ngjarjet e përmendura më parë, të përmbajtura në përgjigjet e fokus grupeve të tjera: Kryengritja e Ilindenit, AS-NOM-i, Marrëveshja e Ohrit, trazirat në Kosovë dhe kriza me refugjatët.

## Cilët heronj nga historia i kujtoni dhe pse?

**N**ë këtë pyetje, pjesëmarrësit e fokus grupeve kanë dhënë një listë të gjerë me emra të periudhave të ndryshme, të cilët nuk ndalen vetëm në persona të së kaluarës më të largët, por përmendin edhe politikanë aktual dhe të mëparshëm.

Te maqedonasit, tre personat më të përmendur janë: Goce Dellçevi, revolucionar nga koha e Perandorisë Osmane, Metodija Andonov – Çento, kryetari i parë i ASNOM-it, dhe Kiro Gligorovi, babai i shtetit bashkëkohor maqedonas.

Maqedonasit e Komunës Çair janë përcaktuar për Dame Gruevin, Pitu Gulin, Nikolla Karevin, por edhe për Kuzman Josifovski Pitu, Jordan Haxhi Konstantinov Xhinot dhe Gjergj Kastriotin Skënderbeun.

Dellçevi, Gligorovi dhe Çento janë personalitetet më të përmendur edhe nga maqedonasit nga Tetova, por, edhe kryetari i ndjerë Boris Trajkovski, si njeriu i cili ka dhënë shumë kontribut për kthimin e paqes në vitin 2001, si dhe kryeministri i parë në shtetin e ri maqedonas Nikolla Klusevi. Në një pjesë të përgjigjeve takohen edhe persona të lindur në këtë qytet, siç është Kace Stojçevski – Ambarçe dhe Todor Cipovski – Merxhan. Në një përgjigje përmendet emri i këngëtarit të këngëve popullore Aleksandar Sarievski.

Lokal-patriotizmi sidomos vërehet te maqedonasit e Kërçovës, të cilët, krahas personave të përmendur më parë, konsiderojnë se padrejtësisht është harruar bashkëqytetari i tyre, me të cilin posaçërisht krenohen, Vllado Polezhina. Për të thuhet se është doktor i shkencave, një nga pjesëtarët e ASNOM-it, bartës i medaljes partizane dhe i cili ka përfunduar në Goli Otok. Përmenden edhe persona me rëndësi lokale, si kërçovarët Mirko Mileski dhe Ollga Miceska, si dhe përfaqësuesit e bashkësisë rome



Memed Semovski dhe Ramazan Asamovski. Nga politikanët aktual, veçohet kryeministri aktual i qeverisë maqedonase, Nikolla Gruevski.

Te shqiptarët e tri komunave, në krye të listës së personave më të rëndësishëm janë: humanistja me famë botërore me rrënjë shqiptare, Nënë Tereza, si dhe Skënderbeu, i cili definohet si “legjendë e popullit shqiptar, i cili ka punuar për të mirën e të gjithë shqiptarëve”. Por, nuk harrohen as persona të kohës më të re, të cilët, sipas mendimit të tyre, kanë merita për interesat e popullit shqiptar.

Pjesëmarrësit nga Komuna e Çairit, gjatë numërimit, vend të posaçëm u japin komandantëve të UÇK-së, Teli, Adem dhe Ferid Jashari, si dhe Elvis Hoxhës.

Për shqiptarët e Tetovës, për të përmendur janë Isa Boletini dhe Ismail Qemali, të merituar për pavarësinë e Shqipërisë, Lek Dukagjini, si dhe Mujdin Aliu, i cili është vlarë në Kosovë në vitin 1999. Është interesante se në përgjigjet e tyre përmendet edhe ish-presidenti i Shqipërisë, Enver Hoxha, i cili, siç thotë njëri nga të anketuarit – “edhe pse ishte diktator, krijoi histori dhe vendosi rend dhe paqe, gjë që ne na mungon”. Ata e përmendin edhe Aleksandrin e Madh, për të cilin thonë se në mënyrë radikale e ka ndryshuar botën e atëhershme, pastaj Xhemë Gostivarin, luftëtar dhe ballist, si dhe babanë e Turqisë moderne, Kemal Ataturkun.

Për shqiptarët e Kërçovës, personalitete të adhuruar janë Mefaili dhe Sulltana nga Qafa, të cilët i hasim në disa përgjigje. Si heronj të një kohe më të re përmenden komandantët e UÇK-së, Teli, Çakalla dhe Kushtrimi.

Në fokus grupin në nivel kombëtar, lista e personave është e gjatë dhe e shumëllojshme, kështu që përmendet Goce Dellçevi, Dame Gruevi, Pitu Guli, Aleksandar Protugjerov, Metodija Andonov – Çento, Kuzman Josifovski – Pitu, Jordan Konstantinov

– Xhinot, Kiro Gligorovi, Skënderbeu, por edhe Josip Broz Titoja, Hitleri, si dhe atentatorët e Selanikut.

Ajo që i bashkon dy komunitetet, kur bëhet fjalë për vlerësimin e personaliteteve të së kaluarës më të afërt dhe më të largët, është Nënë Tereza, Skënderbeu dhe Josip Broz Titoja. Krahas qëndrimit kritik të shqiptarëve ndaj Titos, megjithatë, ata theksojnë se, edhe pse ka qenë “komunist dhe diktator”, në kohën e tij është bërë jetë më e mirë.

## Çfarë roli kanë bashkësitë etnike të tjera në kujtesën tuaj?

**K**ërkesa që të definohet raporti personal ndaj bashkësive të tjera, hap një sërë çështjesh të anketuarit, por nxjerr në sipërfaqe edhe paragjykime, stereotipa dhe frustrime, të cilat në masë të madhe janë rezultat i ndikimit të politikës.

Krahas vetëdijes se në këto hapësira ekziston një traditë e gjatë e jetesës së përbashkët dhe bashkëjetesës, qartë detektohet se në dhjetë vitet e fundit është rritur etnocentrizmi, si dhe mbyllja në bashkësinë e vet. Kjo, siç theksohet, sidomos vërehet te të rinjtë, ndërsa më të moshuarit vazhdojnë t'i përmbahen traditës dhe respektimit të bashkësive të tjera.

Konflikti ushtarak apo lufta e vitit 2001, duket se është ngjarja kryesore e cila i ngarkon, frustron, por edhe i rëndon marrëdhëniet mes dy bashkësive më të mëdha në vend. Edhe bashkësia maqedonase edhe ajo shqiptare qasen me pabesi, duke u nisur nga qëndrimet e veta, por edhe stereotipat, të cilët janë më të theksuar në qarqet monoetnike, sesa ato etnikisht të përziera.

“Nuk i ndaj në maqedonas dhe shqiptarë, por, më pengon që konsiderojnë se na kanë dhënë të drejta”, thotë një i anketuar shqiptar nga Komuna e Çairit.

Në Çair janë ilustruese edhe deklaratat: "Maqedonasit nuk kanë dokument pronësie mbi shtetin." "Duhet të gjykohen kriminelët, jo bashkësi të tëra." "Mungon komunikimi, nuk njihemi mjaftueshëm." "Nuk kemi mbrojtje nga politikanët shqiptarë në Qeveri."

Shqiptarët e Tetovës, do të konstatojnë: "Pas luftës në vitin 2001 u krijua një atmosferë e rëndë mes maqedonasve, turqve dhe shqiptarëve. Raportet pas vitit 2001 nuk janë të njëjtë si para kësaj. Ka dallim të madh." "Raportet mes maqedonasve dhe shqiptarëve me fjalë janë shumë të mira, por në vepra janë shumë të këqija." "Pas konfliktit është një fazë tjetër. Ndonjëherë mendojmë se jemi të zotit e vet, por, megjithatë, nuk jemi të barabartë me ta (maqedonasit)."

Rezervat janë të pranishme edhe në një pjesë të përgjigjeve të pjesëtarëve të bashkësisë shqiptare nga Kërçova, të cilat ndonjëherë janë rigide: "Maqedonasit kanë një rol më negativ se turqit dhe romët." Gjithashtu të pranishëm janë edhe qëndrimet: "Maqedonasit i diskriminojnë shqiptarët." "Edhe pse me maqedonasit jetojmë së bashku, ata janë armiqtë tanë më të mëdhenj."

Maqedonasit, nga ana tjetër, sikur janë më të përmbajtur në përgjigjet dhe e theksojnë jetesën e përbashkët me bashkësitë e tjera, e cila, e pranojnë ata, kohën e fundit është e "kontaminuar" nga politika: "Ndajmë fatin e njëjtë. Ndikimin më shumë e kisha vënë mbi lojërat politike në bazë etnike", thotë një maqedonas nga fokus grupi i Tetovës.

"Tani në Tetovë, shqiptarët dhe maqedonasit jetojnë më në harmoni se kudo tjetër. Fatkeqësisht, një pjesë e vogël e politikanëve shohin këtë ta kthejnë në dobi të vet dhe të krijojnë moskuptim." "Ne më të vjetrit kemi ndonjë bashkëjetesë dhe e respektojmë njëri-tjetrin, por më të rinjtë nuk e kanë këtë".

Përgjigjet e fokus grupit në nivel kombëtar janë mjaft të rezer-

vuara dhe në to u largohen kualifikimeve të drejtpërdrejta sa u përket bashkësive të tjera, që me siguri është rezultat i përbërjes së përzier dhe nevojës për të qenë "politikisht korrekt". Ndoshta prandaj përgjigjet janë mjaft afirmative dhe kryesisht shprehin shembuj të mirë, si për shembull:

"Kryengritja e Ohrit dhe Dibrës është një shembull i mirë për bashkëpunimin e VMRO-DPMNE-së dhe shqiptarët."

"Mes dy luftërave botërore ekzistonte një bashkësi e fuqishme 'belogardiane'. Emigrantët rusë kanë meritë për formimin e fakulteteve të para." "Shqiptarët dhe vllehtë kishin një rol të rëndësishëm në Kryengritjen e Krushevës."

Një pjesë e përgjigjeve janë mjaft të papërcaktuara dhe pa referenca, si kjo, për shembull:

"Kemi njohuri të vogla për bashkësitë e tjera."

## A kanë bashkësitë e ndryshme kujtesa të ndryshme?

**C**donjëri i shikon dhe i interpreton ngjarjet historike nga pikëpamja e vet dhe nëpër prizmin e etnikumit të vet. Ekziston një lexim paralel i historisë, si dhe kremtimi dhe ngjarja e heronjve të vet. Relacionet e ndërsjella janë të komplikuara dhe përplot mosbesim dhe mosnjohje të "të tjerëve". Por, më shumë mes maqedonasve dhe shqiptarëve, sesa mes këtyre dy komuniteteve me turqit apo romët.

Bashkësitë më të vogla theksojnë se kanë pasur pritje më të mëdha nga Marrëveshja Kornizë, për të cilën mendojnë se i ka vënë në pozitë të marginalizuar përballë bashkësisë shqiptare dhe asaj maqedonase. Këto janë vlerësimet e përgjithshme të cilat mund të nxirren nga përgjigjet e marra për këtë pyetje nga

fokus grupet e ndryshme.

“Maqedonasit kanë frikë prej nesh, mendojnë se do krijojmë Shqipëri të Madhe”, konstatoi një anëtar i fokus grupit nga Çairi, i bashkësisë shqiptare.

“Për maqedonasit, ende shqiptari i vdekur është shqiptar i mirë”, konstatoi një shqiptar nga Kërçova.

“Kurrë maqedonasit nuk kanë parë ndonjë të keqe nga shqiptarët. Maqedonasit kanë probleme me vetveten, me identitetin e tyre.”

“Maqedonasit nuk na duan, kanë urrejtje të madhe ndaj nesh. Me turqit na lidh feja.”

Maqedonasit dhe shqiptarët nga Tetova konstatojnë se “gjeneratat më të vjetra kanë kujtime të mira për bashkëjetesën, por, gjeneratat më të reja nuk janë aq të interesuara për ngjarjet që ndodhin. Kanë botëkuptime dhe shikime të ndryshme nga ne.”

Kërçovarët do të shprehen: “Nuk përzihemi me vetiniciativë, përveç nëse për ndonjë rast na jepet urdhër nga pushteti lokal se sa veta të mblidhen. Festat i festojmë vetë, të ndarë”.

Në përgjigjet bëhet përpjekje për t’u dhënë shpjegime se ku qëndrojnë problemet për antagonizmat, por edhe për pozicionimin e grupeve të ndryshme etnike nga një vizurë gjeografike.

Njëra nga përgjigjet e mundshme të cilat ofrohen ishte ajo se “shqiptarët nga Tetova dhe Gostivari kanë më pak kontakte me maqedonasit dhe kjo vlen edhe për maqedonasit nga Maqedonia lindore”.

“Turqit nga Kërçova janë më të afërt me maqedonasit, ndërsa turqit nga Shkupi, Tetova dhe Gostivari me shqiptarët.”

Përgjigjet e fokus grupeve në nivel kombëtar janë në drejtim të asaj se ekzistojnë histori paralele, të cilat bashkësitë e ndryshme i shikojnë dhe “i lexojnë” nëpër një “prizmi etnik”.

## A mendoni për bashkësi të tjera kur shënoni ndonjë ngjarje e cila është e rëndësishme për bashkësinë tuaj?

**D**eklarativisht, shumica konsideron se festat shtetërore dhe fetare u takojnë të gjithëve dhe se respektohen festat e bashkësive të tjera.

Megjithatë, përkushtim dhe kujdes më i madh u dedikohet kremtimeve të veta, madje edhe atëherë kur mbisundon vetëdija se disa aktivitete të caktuara nuk u pëlqejnë bashkësive të tjera.

Maqedonasit nga Komuna e Çairit, për shembull, thonë se Dita e Pavarësisë, 8 Shtatori, duhet të jetë festë e të gjithëve. Shqiptarët nga kjo komunë pohojnë se e dinë se maqedonasve nuk u ka pëlqyer kremtimi i 100-vjetorit të flamurit shqiptar, madje edhe se ekziston një lloj revanshizmi. Janë të vetëdijshëm se paraqet një traditë të keqe gjuajtja me armë zjarri, që në mënyrë plotësuese nxit nervozë dhe shqetësim te të tjerët.

Praktika e urimit të festës një anëtar të bashkësisë tjetër kryesisht ka të bëjë me festimin e festave fetare, në frymën e traditës së vjetër, shkojnë mysafirë gjatë Kërshëndellave dhe Bajramit.

Një maqedonas nga Tetova përgjigjet se "kur bëhet fjalë për një festë shtetërore, si për shembull pavarësia e Maqedonisë, dalin vetëm maqedonasit. Nëse është ndonjë festë që ka të bëjë me bashkësinë shqiptare, kjo për ne nuk vlen dhe nuk dalim ta festojmë".

Besohet se pjesa më e madhe e festave janë të lidhura me identitetin kombëtar maqedonas dhe prandaj bashkësitë e tjera nuk kanë pikë bashkimi me to.

Kur bëhet fjalë për Kryengritjen e Ilindenit, edhe maqedonasit edhe shqiptarët e dinë mirë se Manifesti i Krushevës është një dokument i cili e shpreh bashkimin dhe e shpreh luftën e për-

bashkët në këto hapësira. Megjithatë, një shqiptar nga Tetova do të vërejë se kjo festë festohet si kryengritje maqedonase. "Tani për tani nuk na shkon në mend, por, në të ardhmen, në një Maqedoni e cila është shumetnike, do të ishte mirë që këto festa të jenë për të gjithë", tha ai.

Ndarje ekziston edhe gjatë shënimit të datave historike.

"Nëse një shkollë mban emrin e ndonjë heroi, e në atë shkollë mësojnë shqiptarë dhe maqedonas, vetëm maqedonasit e respektojnë dhe e shënojnë. E njëjta gjë vlen edhe kur mban emrin e ndonjë heroi shqiptar. Maqedonasit nuk e respektojnë dhe nuk e shënojnë", shton njëri nga i njëjti fokus grup.

Por, mund të takohen edhe mendime pragmatike, në të cilat tregohet mirëkuptim për kontekstin shoqëror dhe realitetin.

"Sikur të mundesha unë ta shkruaj historinë, do të gjeja pikë të përbashkëta, të cilat i lidhin bashkësitë e ndryshme etnike. Mendoj se historia duhet të shkruhet ashtu që do ta pasqyrojë gjendjen reale, për të pasur bashkëjetesë me të gjitha bashkësitë të cilat jetojnë këtu", konstatoi një nga pjesëmarrësit e fokus grupeve.

Mendime të ngjashme takohen edhe te pjesëmarrësit e fokus grupeve nga Komuna e Kërçovës, ku nënvizohet: "As ata mendojnë për ne, as ne për ta. Bashkë jemi kur ka ndonjë manifestim i organizuar nga komuna".

Edhe në këtë pyetje, përgjigjet e marra nga fokus grupi kombëtar janë mjaft afirmative dhe në drejtim të asaj se duhet të kultivohet dhe të respektohet e ndryshmja. Qëndrimi i këtillë pasqyrohet më së miri në përgjigjen në vijim:

"Maqedonia është një mozaik, i përbërë nga më shumë gurrëza. Në rast se ndryshojmë pozitën e disa gurrëzave, do të priset e tërë figura.

## Roli i gruas në histori?

**P**othuajse nuk ekziston dallim në qëndrimet rreth kësaj çështjeje, as sa i përket pjesëmarrjes etnike dhe gjinore, e as sa i përket vendbanimit. Është mendim i pandarë se gruaja nëpër histori më së shpeshti ka qenë e marginalizuar, pamjaftueshëm e pranuar dhe se ka vepruar më shumë nga "prapavija". Pjesëmarrësit në fokus grupet janë të bindur se në kohën më të re ka lëvizje, sepse gratë janë më të arsimuara dhe i janë përkushtuar karrierës.

Në përgjigjet theksohet se krahas asaj që historia kujton gra të cilat kanë qenë shembull i heroizmit, megjithatë, roli i tyre ka qenë më i madh në shtëpi, në edukimin e fëmijëve dhe përkujdesjen në familje. Sidomos theksohet veprimtaria e saj gjatë LNÇ, posaçërisht në sigurimin e ushqimit dhe fshehjes së partizanëve.

Në përgjigjet mund të takohet edhe pozicionimi i gruas, si rasti me përfaqësuesin e fokus grupit të maqedonasve etnik nga Komuna e Çairit, i cili gruan e shikon si një zbatuese të vullnetit të burrave, duke e përmendur rolin e Mara Bunevas. Ndërsa si shembull për heroizëm dhe viktimë, përmendet Vera Jociq.

Pjesëmarrësit shqiptarë nga kjo komunë do të theksojnë se gratë më parë s'kanë pasur të drejta, por se pas luftës në vitin 2001, ato më shumë dalin publikisht, kanë jetë sociale dhe arsimohen. Si raste pozitive përmenden Nënë Tereza dhe Ibe Palikuqi. Krahas qëndrimit të qartë se nuk do të arrihet një barazi gjinore, megjithatë, e pranojnë këtë: "kur konsultohet gruaja për diçka, nuk bëhet gabim".

Maqedonasit etnik nga fokus grupi në Tetovë thonë se jetojmë në një shoqëri tradicionale, ku burri është kryefamiljar. Në pyetjen se kënd do ta kishin përmendur si rast pozitiv, veçohen Kërstena Menada, Ibe Palikuqi dhe Mara Buneva, ndërsa nga



koha më e re Dosta Dimovska dhe ministria aktuale e punëve të brendshme, Gordana Jankullovska, si një grua e cila punon në një "resor meshkujsh".

Ngjashëm mendojnë edhe bashkëqytetarët e tyre të bashkësisë shqiptare. Ata mendojnë se gruaja nëpër histori ka qenë e diskriminuar, e papranuar në shoqëri, s'ka pasur rol kyç. "Mendoj se duhet të jetë më shumë e kyçur në institucionet shtetërore dhe në shoqëri, Gruaja mendon me më shumë mençuri dhe është më e ndërgjegjshme sesa burri. Sikur të kishim gra lidere në të kaluarën, do të kishim më pak luftëra", thonë ata.

Kërçovarët, pa dallim të përkatësisë etnike, e vlerësojnë posaçërisht rolin e gruas në LNÇ. Ajo, siç thonë ata, "i përgatiste të gjitha punët e shtëpisë që partizanët të vijnë në këtë terren, sepse rajoni i Kërçovës u shndërrua në një strehimore e të gjithë luftëtarëve nga e tërë Maqedonia".

Nuk ka dallime të mëdha në përgjigjet as në fokus grupin kombëtar, ku Mara Buneva përmendet si shembull i një gruaje zbatuese, ndërsa Nënë Tereza si humaniste.

Është interesante përgjigjja e njërit nga të anketuarit, i cili citon një fjalë të vjetër popullore: "Nëse arsimon burrin, ke arsimuar një njeri. Nëse arsimon gruan, ke arsimuar tërë kombin".

# Cilat persona apo grupe janë të rëndësishëm për kujtimin e të kaluarës?

**L**ideri i UÇK-së dhe i BDI-së, Ali Ahmeti, edhe më tej e gëzon përkrahjen më të madhe të shumicës së shqiptarëve të cilët morën pjesë në fokus grupet. Ata e paraqesin si figurë qendrore të korpusit të tyre politik. Kjo në masë të madhe është meritë e “kredisë” të cilën vazhdon ta “shpenzojë” nga konflikti ushtarak i vitit 2001, si një person i cili i ka sjellë ndryshimet më të mëdha për shqiptarët. Glorifikimi i konfliktit i 2001-shit sjellë deri te ajo që në një pjesë të përgjigjeve t’i shmanget personalizimi dhe paraqitja e një njeriu konkret, kështu që insistohet mbi rëndësinë e “tërë UÇK-së, nga ushtarët deri te gjeneralët”. Me besim shikohet edhe ish-kryetari i Gostivarit, Rufi Osmani.

Edhe pse popullariteti i Ahmetit është i padyshimtë, sidomos në Kërçovë dhe Tetovë, megjithatë, në Komunën e Çairit rëndësi u jepet edhe Adem Demaçit, Arbën Xhaferit dhe Titos. Krahas Ahmetit, si një aktor vendas në skenën politike, përmenden edhe aktorë “të jashtëm”, si ish-euro ambasadori në Maqedoni, Ervan Fuere, si dhe kancelarja aktuale gjermane Angela Merkel, si dy figura të rëndësishme në rrugën e Maqedonisë drejt BE-së dhe NATO-s, por, edhe për të drejtat e bashkësive etnike në vendin tonë.

Te maqedonasit sikur ekziston një ngopje dhe dëshpërim nga politikanët, kështu që pjesëmarrësit e fokus grupeve nuk deshën të paraqesin persona konkret, me shpjegimin se nuk shohin të tillë të cilët ia vlen të përmenden. Fokus grupi i përbërë nga maqedonasit nga Çairi, përparësi u jep politikanëve nga koha më e re. Ata veçojnë Kiro Gligorovin, Branko Cërvenkovskin, Radmila Shekerinskën, Boris Trajkovskin, Gjorgje Ivanovin dhe Nikolla Gruevskin.

Dëshpërimi te tetovarët shihet edhe nga ky qëndrim: "Për mua ekzistojnë persona dhe grupe të cilët do të mbahen mend, por në një konotacion negativ. Ndoshta shoqatat joqeveritare do të mbahen mend për nga lufta e tyre për demokraci, por edhe ato janë të ngulfatur në veprimin e tyre nga politika e cila udhëhiqet tani". Si njeri i cili do të mund të ndikonte në afirmimin e Maqedonisë përmendet regjisori Milço Mançevski.

Defetizmi shikohet edhe nëpërmjet prizmës se mendimit se "politika ndikon mbi pamjen e shtetit. Çdo ditë ndërrohet historia. Të rinjtë nesër do të rrëfejnë për barokun në Shkup, anijet në Vardar, si pjesë e ngjarjeve historike".

Njeriu më dominues në përzgjedhjen e personave të fokus grupeve në nivel kombëtar është kryetari i parë maqedonas Kiro Gligorov, por përmenden edhe Branko Červenkovski, Nikolla Gruevski, Lubčo Georgievski, Stojan Andovi, Ali Ahmeti, Arbën Xhaferi dhe Boris Trajkovski.

## Kush i shpall festat dhe i ndërton përmendoret?

**E**patejkalueshme është përshtypja se pothuajse të gjithë përfaqësuesve në fokus grupet, pa dallim se nga vijnë dhe cilës bashkësi etnike i përkasin, janë mirë të informuar rreth procedurave dhe proceseve të sjelljes së vendimeve. Kjo do të thotë se saktësisht e dinë se cila është korniza institucionale e sjelljes së vendimeve për shpalljen e festave apo ndërtimin e përmendoreve. Bëhet një përkufizim i qartë se pushteti lokal i vendos përmendoret, ndërsa pushteti qendror monumentet. Gjithashtu, nuk ka ngatërresa rreth asaj se kush i shpall festat dhe se kjo duhet të kalojë në një procedurë në Kuvendin e Re-

publikës së Maqedonisë. Por, megjithatë, në përgjigjet sikur paraqitet një rezignim ndaj veprimit të partive në pushtet, të cilat udhëhiqen nga qëllimet partiake dhe se ekziston një disproporcion në numrin e festave dhe përmendoreve.

Me një observim shumë kritik qaset ndaj përmendoreve, sidomos sa i përket numrit të tyre, si dhe çmimit dhe se me to “elitët politike shërojnë frustrimet”. Por, nuk kursehet as lista e gjatë e festave, për të cilat mendohet se disa janë të panevojshme, madje edhe politikisht të motivuara.

Në një përgjigje të një maqedonasi në fokus grupin nga Komuna e Çairit, do të konstatohet se “disa përmendore nuk i kanë kriteret themelore për vlerë estetike” dhe se “partia aktuale në pushtet i përdor për grumbullimin e pikëve politike”.

“Qeveria ndërton, jo populli”, konstaton një përfaqësues i bashkësisë shqiptare nga fokus grupi i Çairit. Projekti “Shkupi 2014” cilësohet si i panevojshëm dhe diskriminues. Krahas asaj që bëhet një distinkcion i qartë se ky projekt nuk është drejtuar posaçërisht kundër shqiptarëve, vërehet se nuk ka nevojë për kaq përmendore dhe se ai u bën dëm edhe maqedonasve, nga të cilët një numër i madh nuk e duan.

Maqedonasit nga Komuna e Tetovës janë të pakënaqur nga ajo që askush nuk i pyet qytetarët dhe se politikanët vetë vendosin për gjithçka. U pengon edhe ajo se rrënohen përmendoret e vjetra nga LNÇ dhe askush nuk ndërmerr gjë për t’i kthyer.

Bashkëqytetarët e tyre të bashkësisë shqiptare, në përgjithësi konsiderojnë se ka punë shumë më të rëndësishme të cilave duhet t’u përkushtohet pushteti, sesa ndërtimi i përmendoreve. Si shembull merret se prioritet është përmirësimi i ekonomisë dhe punësimi.

Shqiptarët shohin pabarazi edhe në shpalljen e festave, sepse vërejnë se maqedonasit kanë një numër më të madh të datave

historike dhe festave fetare për shënim. Sipas mendimit të tyre, mungojnë përmendore të shqiptarëve të spikatur.

Shqiptarët e Kërçovës komentojnë se “qeveria shpall festa dhe ndërton përmendore edhe me paratë e tyre”. Fajin për përmendoret e shohin edhe te ata “të cilët i sollëm në pushtet”.

Në fokus grupin kombëtar konsiderojnë se “përmendoret u shërbejnë elitave politike për shërimin e frustrimeve kombëtare”.

## Nga merren informatat për ngjarjet historike?

**M**e numërimin e burimeve të mundshme për informim rreth ngjarjeve historike, arrihet deri te njohuria dëshpëruese se shumë më shumë përdoren mënyra alternative për të arritur deri te e vërteta për atë që ka ndodhur në të kaluarën, sesa përdorimi i mjeteve tradicionale, arsimore, në rend të parë librat e historisë. Nxirret përfundimi se nuk bëhet fjalë vetëm për kërshtëri dhe nevojë për mbindërtimin e diturisë, por shumë më shumë për mosbesimin në përmbajtjet arsimore zyrtare, që është pasojë e politizimit të shkencës.

Mundësi plotësuese apo alternative për marrjen e informatave dhe diturisë japin teknologjitë bashkëkohore informatike. Përfshirja e gjerë e internetit jep më shumë mundësi, por fsheh edhe kurthe për t’u futur në forume me polemika dhe burime të cilat, të liruar nga obligimi për të respektuar standardet, shpeshherë janë një hapësirë për përhapje të urrejtjes dhe të padurimit fetar dhe kombëtar. Baza për konkluzionet e këtilla mund të nxirret nga më shumë përgjigje të pjesëmarrësve në fokus grupet.

“Pak nga shkolla, më shumë nga historianët, nëpërmjet leximit

të librave dhe shikimit të filmave dokumentar, nga pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të ngjarjeve dhe, kohët e fundit, nga interneti”, thotë një maqedonas nga fokus grupi i Çairit.

“Historinë e mësonim nga skripte, në libra nuk kishte asgjë për shqiptarët”, vëren një anëtar i bashkësisë shqiptare nga e njëjta komunë dhe shton: “Kudo që të shkoni, flitet për histori”.

Maqedonasit nga fokus grupi i Tetovës thonë se më së shumti informohen nga “gjeneratat më të vjetra dhe nga gojëdhënat”, por edhe nga interneti, librat dhe familja.

Krahas asaj se disa shqiptarë të fokus grupit të Tetovës konstatojnë se “të rinjtë nuk i intereson historia”, megjithatë, del se kjo është pjesërisht e saktë, sepse pjesa më e madhe e tyre interesohet për ngjarjet historike dhe informohet nga familja dhe nga mediat.

Interneti gjithnjë e më shumë imponohet si një burim kryesor për informim, por, është prezent edhe vetëdija se “ekzistojnë shumë debate në rrjetet sociale të cilat janë përplot urrejtje”.

S’mund t’u besoni librave të historisë, thotë njëri nga të anketuarve, sepse nëse janë të shkruar në Maqedoni, favorizohen maqedonasit, nëse janë nga Turqia, atëherë favorizohen turqit.

Janë të ndarë mendimet në fokus grupin në nivel kombëtar rreth mënyrës tradicionale të mësimin të historisë. Përderisa disa vazhdojnë të konsiderojnë se librat e historisë janë burimi kryesor nga i cili fitojnë dituri, një pjesë e tyre këtë e mohon, duke u mbështetur në burime të tjera, para së gjithash në internetin.

## A kanë kujtesë të ndryshme gratë dhe burrat?

**N**ë këtë pyetje ka shtresim në përgjigjet, por, kryesisht përgjigjet se s'duhet të bëhet ndarja gjinore. Kjo, megjithatë, çon drejt mungesës së vetëdijes për dallimet në perceptimin, të cilat janë imanente në sferën e raporteve gjinore. Kjo vërtetohet edhe me qëndrimet se "gratë janë më emotive, ndërsa burrat më të frustruar" në shpjegimin dhe pranimin e proceseve dhe ngjarjeve historike.

Në dobi të kësaj është edhe qëndrimi i parashtruar i një pjesëmarrëse në fokus grupin e shqiptarëve etnik në Komunën e Çairit, se "pa dallim të asaj se nga cila bashkësi etnike vijnë, burrat luftën e shohin si një akt heroik, ndërsa gratë e përfjethojnë si një tragjedi, njëjtë për të gjitha bashkësitë".

## Pse është me rëndësi të kujtohet?

**S**'ka dallim në mendimet rreth asaj se pse është me rëndësi të mbahet mend ajo që ka ndodhur në të kaluarën. Poenta kryesore është se kjo nevojitet për të mos u përsëritur gabimet nga e kaluara, sepse "historia është mësuese e jetës".

Me një dozë të vogël të vetëkritikës, njëri nga bashkëbiseduesit e fokus grupit nga Komuna e Çairit thotë: "Ne shqiptarët i lartësojmë arritjet tona dhe, ndonjëherë, punët e mira i harrojmë, ndërsa të këqijat i kujtojmë".

Ekziston një konsensus edhe rreth asaj se duhet t'u jepet mirënjohje dhe rëndësi atyre të cilët kanë lënë shenjë në histori dhe kanë luftuar për disa të drejta. Nuk harrojnë të theksojnë se "historia është një mjet i njerëzimit nëpërmjet të cilit mësohen gabimet e së kaluarës".

Jo vetëm punët e mira, por duhet të mbahen mend edhe marrëzitë historike, vëren në mënyrë lucide njëri nga pjesëmarrësit, sepse “çdo marrëzi e cila nuk është mësuar nga e kaluara sjell një të re, e cila nuk i ngjan të vjetrës”.

Tërhiqet vëmendja edhe për një aspekt tjetër të qenies njerëzore, e cila “gjithmonë duhet të pyes, hulumton, se pse, si dhe me çfarë qëllimi ka ndodhur diçka dhe, në fund të fundit, a është kjo e vërtetë”.

Është interesant edhe qëndrimi se “patjetër duhet të kujtojmë, madje edhe ta rishikojmë në rast se diçka s’ka qenë ashtu, por ka ndodhur ndryshe. I mençuri mëson në gabimet e tjetrit, ndërsa i marri në gabimet e veta”, është njëra nga përgjigjet.

Në shumë përgjigje të marra, të cilat dëshirojnë më nga afër të hyjnë në thelb, se pse s’duhet të harrohet, është edhe ai se ky është në fakt një investim në të ardhmen dhe për gjeneratat e ardhshme. “Për t’u ndërtuar e ardhmja, nuk duhet harruar e kaluara”. Ose, edhe më saktë, nga e kaluara mësojmë për atë se ç’është humbja, e ç’është përfitimi.



## A ka ndonjë ngjarje të harruar apo diçka që duhet fshirë?

**N**ga përgjigjet e marra në këtë pyetje, del se festimet etnocentrike në mënyrë të barabartë u pengojnë edhe maqedonasve edhe shqiptarëve, sepse në to shohin manipulim politik. Sidomos theksohet festimi i 23 Tetorit (Dita e Luftës Revolucionare Maqedonase), i cili njihet si dita e VMRO-DPMNE-së dhe i jepet një ngjyrë partiake-politike. Qëndrim kritik ekziston edhe sa i përket asaj se festat fetare janë shpallur për shtetërore. Një pjesë e maqedonasve ka qëndrim negativ edhe rreth festës së flamurit shqiptar, e cila përjetohet si festë e një shteti tjetër. Rikujtojnë se Maqedonia është një shtet shumetnik, kështu që mungojnë festa të përbashkëta, të cilat do të jenë urë lidhëse mes bashkësive.

“I pakuptimtë për mua është 23 Tetori. Kjo është një festë e elitës politike të sotme. Dhe, duhet të gjithë ta festojmë”, thuhet në një përgjigje.

“Perceptimi i njeriut të sotëm për 23 Tetorin lidhet me partinë politike në pushtet. Nuk shikohet si një festë e identitetit. Nuk është kjo festë e tërë popullit”, është qëndrimi i një bashkëbiseduesi tjetër, i cili shpjegon se pse e konsideron si të panevojshëm këtë festë.

“23 Tetorin unë kurrë s’do ta festoja. Ajo është festë shtetërore, por vetëm për një grup konkret të njerëzve. Unë e kisha fshirë si festë, sepse nxit mostolerancë kombëtare. Mara Buneva, Todor Aleksandrov dhe të ngjashmit me ta, nuk i ndjej si mbrojtës të identitetit maqedonas”, është edhe një qëndrim në këtë temë.

“Unë e kisha zëvendësuar festën e VMRO-së me festë për të gjithë të rinjtë në Maqedoni. Të ketë një Ditë të Hapur, ku të rinjtë do të jenë të pranishëm me aktivitete të ndryshme”, është propozimi i një pjesëmarrësi.

Me një dozë nostalgjie kujtohet se më parë ka pasur më pak festa, por, shënoheshin në mënyrë më cilësore.

“Gjithnjë e më pak shënohet 19 Nëntori, Dita e Çlirimit të Tetovës. Fëmijët sot nuk e din se ç’përfaqëson ai. Personalisht më pengon kur më 28 Nëntor shënohet Dita e Flamurit Shqiptar, sidomos në Tetovë. Nuk është e logjikshme, vjen si imponim, si festë e një shteti tjetër”, ankohet një pjesëtar i fokus grupit të maqedonasve.

Acarimi nga projekti “Shkupi 2014” është i pranishëm gjatë tërë hulumtimit, si edhe në një pjesë të përgjigjeve të kësaj pyetje, kështu që dëgjohen edhe qëndrime radikale, siç është ai i një maqedonasi nga fokus grupi kombëtar, i cili thotë: I kisha rrëzuar të gjitha urat, përveç Urës së Gurit”. Një tjetër, pjesëtar i bashkësisë shqiptare, thotë: “I kisha ndërruar përmendoret e 2014, i kisha rrëzuar. Njerëzit kanë nevojë për bukë, jo për përmendore”.

Propozimet rreth asaj se cila festë do të duhej të gjendet në listë apo është harruar në mënyrë të padrejtë dhe meriton një mirënjohje shoqërore më të madhe, janë të shumëllojshme dhe, kohë pas kohe, të kushtëzuara nga motive etnike. Kështu, përmenden personalitete si Aleksandar Protugjerov, Josip Broz Tito, Metodija Andonov Çento, Nikolla Klusev, deri te autori i abetares së parë rome, Shaik Juzum, apo pavarësia e Kosovës.

**Biljana Jordanovska**  
në bashkëpunim me  
**Sasho Talevskin,**  
**Arbana Qerimin**

Intervista me

përfaqësues të aktoreëve

dhe të palëve të interesit

Vllado Popovski, historian:

## Historiografia e Maqedonisë është përjashtuese

**P**rofesori Vllado Popovski e lidhë historinë e Maqedonisë me historiografinë e cila si domosdoshmëri paraqitet me krijimin e shtetit maqedonas, gjegjësisht pas ASNOM-it. Burimet për krijimin e “Historisë së Maqedonisë” në tre vëllime janë nga arkivat e vendeve të tjera. Historinë e parë të Maqedonisë e kanë shkruar historianë nga perëndimi, të cilët janë specializuar në Institutin për Histori Kombëtare të Maqedonisë. Megjithatë, burimet dhe dokumentet të cilët e përbëjnë këtë histori janë zgjedhur në mënyrë selektive. E përfshin vetëm atë që është karakteristike për Maqedoninë. Historia në tre vëllime të vitit 1960, e përfshin periudhën nga Antika deri te ASNOM-i.

Pasi kjo histori e parë është shkruar vetëm nga aspekti i maqedonasve dhe identiteti i tyre, nevojitet një botim i ri, i cili do ta mbajë titullin Historia e popullit në Maqedoni dhe do t’i përfshijë të gjitha segmentet e historisë maqedonase, të të gjithë popujve, ndërsa kishte qenë mirë të inkuadrohen edhe historianë të bashkësive etnike të tjera – rekomandon profesori Popovski. Sot, sipas tij, realizohet politizimi i historisë nga ana e shtetit dhe kjo ndikon mbi të gjitha historiografitë. Kjo është e njëjtë siç ka qenë në periudhën e Jugosllavisë në vitet 1970-1990, ku historinë e kanë shkruar historianë liferantë, duke krijuar një histori ideologjikisht të ngjyrosur, e cila i ka konvencuar pushtetit të atëhershëm, gjegjësisht Titos. Vërejtja dhe nevoja që një histori të shikohet si e falsifikuar e gjen në vet riemërimet e atyre pjesëve të historiografisë ku shkruan Bullgarë dhe riemërohen në Maqedonas. Për të qenë të dhënat valide, Popovski konsideron

se duhet të shpjegohet nga vjen kjo e shprehur dhe jo të bëhen ndryshime. Por, Ballkani nëpër histori gjithmonë është varur nga ndonjë politikë, e cila ia ka krijuar historinë. Ndikimi dhe presioni në këtë kuptim janë të shumtë për çdo gjeneratë e ardhshme e krijuesve të historisë. Pas prishjes së Jugosllavisë, më parë vdekja e Titos, është krijuar nevoja për largim nga kjo ideologji dhe shpjegim dhe arsyetim i politikës së deriatëhershme nga pala maqedonase. Edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë mes historianit dhe politikanit, ndikimi i njërit ndaj tjetrit është i madh dhe e drejton historianin në autocensurë. Nga pozita e këtyllë historiani konsideron se i mbron interesat e partisë, politikës apo, thjesht, e kultivon deri në fund traditën e historiografisë së deritanishme.

Pas pavarësimit të Maqedonisë, në botim të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (AShAM) del "Enciklopedia e Maqedonisë" dhe "Historia e Maqedonisë" nga Mitko Panovi, në të cilën paraqitet teza, e cila sot përhapet masovikisht, se jemi drejtpërdrejtë të lidhur me maqedonasit antik. Çasti i popullimit dhe asimilimit i popullatës vendore nga ana e sllavëve marginalizohet dhe shpjegohet ndryshe. Mënyra e këtyllë e prezantimit të historisë nuk e paraqet përbërjen e saj heterogjene. "Në krijimin e historisë politike, gjegjësisht të memories kolektive, politika e bën këtë në mënyrë tejet ekskluzive dhe në kuadër të njohurive të veta, të cilat mund të mos jenë identike me të vërtetat shkencore. Është e habitshme se kjo madje nuk i intereson", thotë profesor Popovski.

Oasja e këtyllë mund të sjellë deri te incidentet dhe kundërthëniet. Heterogjenia është kyçe për historinë maqedonase dhe kjo nuk mund të mohohet. Të injorohet ekzistimi dhe pjesëmarrja në rrjedhat historike të një populli i cili realisht ka ekzistuar në këto hapësira dhe sot ekziston në një përqindje të madhe, vetëm do ta rrisë mosbesimin dhe, sipas profesor Popovskit, do të krijojë simbole të zonësimit. Ky proces është në rritje e sipër, nëpërm-

jet përmendoreve. Politikanët vendosin vetë për bashkëpunimin me shkencën dhe pa sens për mendimin publik më të gjerë. "Ka pozita të papastruara deri në fund të personave të caktuar, të cilët janë tejet prezent me përmendore dhe janë në diskrepancë me rolet e të tjerëve, që gjithashtu krijon ndarje mes pjesës maqedonase të popullatës. Në këtë mënyrë cilësohen tradhtarë dhe patriotë", thotë profesor Popovski dhe e thekson shembullin me ASNOM-in dhe Ilindenin, ku përcaktohet pjesëmarrja e një partie të caktuar dhe, varësisht nga kjo, rritet apo ulet vlera. ASNOM-i sikur i takon LSDM-së, ndërsa Ilindenin VMRO-së. Këto dy ngjarje historikisht plotësohen. Gjatë kohës së Jugosllavisë, është favorizuar ASNOM-i, ndërsa tani, në llogari të tij, favorizohet Ilindenin.

Në pyetjen se a ka mundësi për pranimin e mendimeve dhe shpjegimeve të ndryshme të historisë, profesor Popovski përgjigjet: "Në Maqedoni ekzistojnë edhe faktorë të tjerë të pengimit të arritjes së besimit të ndërsjellë maksimal. Maqedonasit dyshojnë në lojalitetin e shqiptarëve dhe mendojnë se ata vazhdimisht punojnë për Shqipëri të Madhe, ndërsa shqiptarët dyshojnë në sinqeritetin e maqedonasve se dëshirojnë të sigurojnë një trajtim të barabartë për të gjithë dhe nga kjo, politika maqedonase anon drejt afektimit dhe rritjes, që memoria kolektive të lidhet vetëm me segmentin maqedonas nga tezat e mëparshme, ndërsa shqiptarët mbeten me idenë e shqiptarizmit dhe bashkimit". Ato çaste që na bashkojnë, duhet të kenë interpretim historik të njëjtë për të gjithë, ndërsa ngjarjet tjera të lajmërohen si fakte historike.

Për të arritur një sukses në mirëkuptimin e ndërsjellë dhe në këtë drejtim pajtim me veten dhe me historinë e tillë siç është, duhet të hapet një komunikim masovik mes gjeneratave dhe bartëse e temave të jetë shoqëria civile dhe individë. Duhet çështja të hapet publikisht. Shteti dhe politika e saj të jenë transparent dhe të hapur ndaj asaj pjese të politikës historike, e cila e shpreh karak-

terin heterogjen të historisë maqedonase.

“E ndjej se maqedonasit janë konservativ në vijë kombëtare, ndërsa pjesa shqiptare në masë të madhe është ekstreme në kërkesat. E ndryshmja është pasuri nëse përkufizohet në kulturë, tradita dhe fe, por, në rast se sigurohet një barazi reale në sferën e politikës dhe ekonomisë. Atëherë, çdo kombësi është resurs, gjegjësisht potencial i shtetit. Këtë çështje fare se kemi prekur”, konstaton Popovski.

Sofija Kunovska, aktore:

## **Kultura, historia dhe kujtesa janë nën kontrollin e partive politike në pushtet**

**V**ërejtja më e madhe e Sofija Kunovskës, sa i përket kontributit të vetadministrimit lokal për praktikimin e kulturës, ruajtjen e përmendoreve dhe kremtimin e ngjarjeve historike më të rëndësishme në Maqedoni, i drejtohet elitës politike, e cila sjellë vendime për të gjitha këto çështje. Ajo konsideron se në këtë mënyrë jo vetëm se vetadministrimi lokal është i kufizuar në veprimin e tij, por varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pushteti. Sipas saj, rregullorja ligjore keqpërdoret. Ligji në mënyrë të qartë e cakton se kush për çfarë është kompetent, por, ai nuk respektohet.

Shembull për këtë është projekti Shkupi 2014. “Shkupi 2014 kaloi në Komunën Qendër kur me të sundonte VMRO-DPMNE, ndërsa tani, kur Komuna Qendër nuk udhëhiqet nga ata, të gjitha kompetencat ndryshuan dhe i mori Qyteti i Shkupit. Por, edhe Qyteti i Shkupit nuk është kompetent ta bëjë këtë”, thotë

Kunovska. Relacioni me historianët është e qartë se nuk është i mirë. Nëse ata duhet ta vlerësojnë se cili person apo ngjarje e historisë do të memorializohet, praktika tregon se ekspertiza dhe qëndrimet e tyre nuk respektohen.

Si një vend shumëtnik, Shkupi i nënshtrohet ndikimit të madh politik në të gjitha sferat. Prodhohet një shumicë historie dhe në vend që të shihet e ardhmja, mbetemi të robëruar në të kaluarën. Sipas Kunovskës, më parë ndikimi politik së paku është përpjekur të sigurojë kujtesë e cila për të gjithë do të paraqesë një dritë pozitive për të kaluarën, një themel të shëndoshë, mbi të cilin do të ndërtohet ardhmëria. Kjo duhet të shërbejë si shembull për elitat politike të tashme, nëse duan një pozitë të bukur dhe progresive për të ardhmen. Ajo që bëhet tani sa i përket asaj se çfarë historie plasohet në publik, lë hapësirë për dyshim, ndërsa çdo grup etnik të mendojë dhe ta pranojë ndryshe historinë.

“Konsideroj se në llogari të historive të pasuksesshme nga Maqedonia, të cilat ky pushtet përpiqet t’i vendosë në historinë tonë, e harrojmë episodin e vetëm të vlefshëm historik për Republikën e Maqedonisë, e ky është bashkimi i të gjitha kombësive në luftën kundër fashizmit. Ne kemi një histori të përbashkët aq të bukur, e cila historikisht u tregua si e saktë, si një histori e anës së mirë”, thotë Kunovska. Nga ky aksion paushall, i cili udhëhiqet për nevojat e elitave politike, vuajnë të gjithë qytetarët në Maqedoni.

“Kjo nuk është histori, kjo është njëfarë rrëfimi të cilin e predikojnë politikanët të cilët kanë nevojë të na kthejnë në historinë prapa, sepse e tashmja nuk mund të ofrojë asgjë ose nuk mund të ofrojë mjaftueshëm për t’u marrë me të. Kthimi në histori është dëshmi se ekziston krizë e të tashmes”, konkludon Kunovska.

Për atë se ç’mban mend nga historia Shkupi si qytet dhe si i kultivon këto kujtime, Kunovska thotë: “Krahas asaj se janë lënë pas dore heronjtë e Luftës Nacional Çlirimtare (LNÇ), këto ditë



jemi dëshmitarë se propozimet për personat të cilët duhet të kujtohen dhe të kremtohen, i marrim nga Shoqata për Bashkim Shpirtëror nga Setinci, Popadinci dhe Krushoradi të Janinës, me seli në Shkup, në seancën e fundit të Qytetit të Shkupit. Kjo është njëfarë shoqate, mezi e mbajtëm mend emrin, e cila kinse do të japë në formë donacioni pesë përmendore në Shkup. Kryetari i komunës as që dinte se kush janë ata përmendoret e të cilëve do të vendosen, e as ku do të vendosen”.

Personi më i rëndësishëm për Shkupin, i cili duhet në çfarë do mënyrë të shënohet dhe kremtohet, e nuk është e sigurt se a ekziston fare në memorien e shkupjanëve, është Josif Mihajloviqi. Ajo thotë, nëse e pyetni se kush është Mihajloviqi, kryetari i komunës nuk do të dijë dhe nuk do të përgjigjet. Mihajloviqi, sipas saj, është kryetari i komunës i pari i cili nga një kasaba fshati, Shkupin e ka bërë qytet, në vetëm dy mandate. Në llogari të kësaj, imponohet pjesa antike e historisë së Maqedonisë, e cila është në dëm të identitetit maqedonas dhe krijon armiq.

Në pyetjen se si gratë kujtohen në histori dhe a ka heroína mes tyre, ajo përgjigjet: “Grua heroinë është çdo grua e cila ia arrin të ballafaqohet me të gjitha sfidat e kësaj jetese bashkëkohore. Do t’i veçoja gratë artiste, të cilat e shënuan shekullin e kaluar: Milka Eftimova, Milica Stojanovska, Nada Geshovska... Nga koha e LNÇ-së, do ta veçoja Vera Hristova Jociqin, bartëse e urdhrin partizan”.

Sreten Koceski, Instituti për Zhvillimin e Bashkësisë – Tetovë:

# Shoqëria civile është pjesëmarrëse e rëndësishme

## në proceset shoqërore

**M**arrëdhëniet ndëretnike janë prioriteti kryesor i IZhb-së, gjegjësisht krijimit të shoqërisë funksionale shumetnike në Maqedoni.

Në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me kujtesën mbi historinë dhe prezantimin e saj, ai, mes tjerash, konsideron se bashkëjete-sa mes bashkësive etnike është e mundur nëse përmirësohet ekonomia. Me stabilizimin e saj, do të stabilizohen edhe tensionet dhe nëpërmjet bashkëpunimit në biznes, do të fitohet mundësia për një komunikim normal mes maqedonasve dhe etniteteve të tjera. Politika ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi atë se kush sa do të fitojë në këtë pikëpamje, por, sa i përket përvojës historike dhe mënyrës së interpretimit të saj në publik dhe në shkollë, politika nuk është e përzier.

Koceski beson se interesi i cili ka ekzistuar për njohjen e njërës palë për palën tjetër është shtrembëruar me theksimin e organizatave joqeveritare për dallimet të cilat i ndajnë bashkësitë etnike. Prandaj, shqiptarët e rinj sot nuk dinë maqedonisht. Gjuha shqipe përdoret gjithandej: në institucione, shkolla, media, ndërsa fondi i orëve për gjuhën maqedonase gjatë arsimit është ulur. Humbet interesi dhe nevoja për përdorimin e gjuhës zyrtare, kur gjuhën shqipe mund ta përdorin në të njëjtën mënyrë, thotë Koceski. Nuk ekziston përkufizimi mes përdorimit të

gjuhëve, prandaj shqiptarët nuk mund të jenë anëtarë produktiv të shtetit në tërësi. Nga kjo dalin konflikte, tensione, mosrespektim i ndërsjellë dhe dhunë.

Një çast i përbashkët për të gjitha bashkësitë etnike të cilat ekzistojnë në Maqedoni është Jugosllavia – thekson Koceski. Mendimi i pranuar gjithandej, se nën sundimin e Jugosllavisë në Maqedoni është jetuar në harmoni – nuk është i saktë. Maqedonasit kurrë nuk do t’ua pranojnë shqiptarëve se në atë periudhë në territorin e Maqedonisë kanë qenë të shtypur, të burgosur dhe se nuk i kanë pasur të njëjtat të drejta si ata. Prandaj edhe ekzistojnë histori paralele, ndërsa shoqëria ndahet. Vërejtje ka për bashkësitë e vogla etnike, të cilat nuk paraqesin interes të mjaftueshëm për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Disa punë janë imponuar me ligj dhe prandaj nuk ka mirëbesim nga asnjë palë.

Nga historia më e re, viti 2001 është viti kur Maqedonia u sulmua, ndërsa Tetova më fuqishëm: kidnapime, vrasje të civilëve dhe formacione ushtarake nga të gjitha anët – kujtohet Koceski. Shqiptarët paraqiteshin si mbrojtës, gjegjësisht të sulmuar. Kompromisi me Marrëveshjen e Ohrit nuk ka efekt në praktikë. Sidomos në nivel lokal. Bashkësitë më të vogla etnike injorohen, edhe pse janë të përfshirë në këtë marrëveshje. Fajin ia hedhin mospërfshirjes së tyre në vetë procesin.

Se si është zhvilluar politika për të ardhur deri te çasti i konfliktit, kanë ndikuar edhe trazirat e vitit 1999, gjegjësisht kriza me refugjatët nga Kosova, thotë Koceski. Në nivel lokal, në kohën më të re, ndikim më i madh u bë me Ligjin për vetadministrim lokal dhe decentralizim. Ndarja territoriale nuk u realizua deri në fund, sepse nuk ka ndihmë financiare.

Sipas Koceskit, nga historia duhet të mësohet se ç’është e mirë dhe ç’është e gabuar. Ajo duhet të paraqesë shtytje për t’u bërë diçka e re, e jo të përsëriten gabimet e vjetra. Ai personalisht hi-

storinë e ka mësuar nga i ati, i cili ka qenë profesor i historisë. Historia të cilën e ka ligjësuar i ati, nuk ka korresponduar me historinë e vërtetë. Për ngjarje të caktuara në atë kohë komuniste ka qenë më mirë të mos flitet, sepse kanë pasuar sanksione dhe pasoja të rënda.

Kur flet për heronjtë, Koceski përqendrohet në persona lokal të historisë, në rajonin e Tetovës. Për të, këta janë Goce Stojçevski – Ambarçe dhe Todor Cipovski – Merxhan. E përmend edhe Çakallovin, për të cilin për herë të parë ka dëgjuar në një emision informativ në televizion. Gra heroina apo luftëtare figurojnë vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në ditë të sotme nuk mund të veçojë dikë, sepse do të duhet t'i kërkojë në kuadër të politikës. Për të, politika sot është vetëm marketing dhe asgjë tjetër. Në këtë drejtim, në të ardhmen nuk do të ketë heronj nga asnjëra gjini, sepse jetojmë në një shoqëri mashkullore. Roli i gruas, si më parë, ashtu edhe tani, është të jetë amvise. Nëse duhet historia të mbajë mend dhe të kremtojë dikë, së pari niset nga vetvetja dhe funksioni të cilin e kryen. Ai konsideron se si organizatë, IZHB ka kontribuar shumë për komunitetin dhe se kjo do të mbetet në memorien historike. E veçon edhe historianin Brane Svetozareviq, për shkak të përshkrimit të tij ilustrativ dhe arsimor të zhvillimit të Tetovës gjatë historisë.

Vendimi i nivelit lokal për mënyrën e kujtesës së historisë në Tetovë nëpërmjet përmendoreve e sjellë Komuna e Tetovës. Ka problem me përmendoret e LNÇ-së, të cilat hiqen për t'u vendosur të tjera. Edhe pse qytetarët kanë reaguar, përmendoret nuk janë kthyer, prandaj maqedonasit janë të revoltuar. Përmendoret e reja janë të personave të historisë shqiptare. Sa i përket kremtimit dhe shënimit të ngjarjeve historike, Koceski është i rezervuar. Nuk kremton ndonjë festë konkrete, por edhe nuk ka vërejtje për numrin e tyre gjatë vitit. Nga festat të cilat janë kremtuar me të madhe, e tani janë lënë anash, e ndan 1 Majin. Sipas Koceskit, mungojnë sindikatat dhe punëtorët të dalin me

problemet e veta publikisht dhe në këtë mënyrë ta shënojnë festën. Arsyen për pasivitetin e tyre e sheh në varësinë ekonomike nga shteti dhe frika për t'i humbur privilegjet e përkrahjes shtetërore.

Amdi Emini, Shoqata "Gajret",  
Kërçovë:

## Turqit mes maqedonasve dhe shqiptarëve

**S**hoqata është krijuar në vitin 2003, së pari si këshill prindëror dhe pastaj e organizuar si shoqatë joqeveritare. Ka 240 anëtarë, nga të cilët gra janë 30-40 për qind. Ka edhe këshill rinor. Të gjithë janë vullnetarë. "Gajret" bashkëpunon me të gjitha OJQ-të në Kërçovë, shqiptare, maqedonase dhe rome.

Si shoqatë kanë bashkëpunim të jashtëm me Turqinë dhe me OJQ-të e atjeshme. Kanë bashkëpunim me TIKa dhe me Lidhjen e OJQ-ve Turke në Maqedoni. Bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale kontribuon për ndërtimin e përmendoreve historike dhe ndihmë në arsimin dhe kulturën e turqve në Maqedoni.

Bashkëpunojnë me bashkësitë etnike të tjera. Më 21 Dhjetor, ditën e alfabetit turk, ditën e gruas turke, për Bajram dhe festat e tjera fetare, i ftojnë të gjitha bashkësitë etnike. Me delegacion të vet marrin pjesë edhe në festat e bashkësive etnike të tjera, si gjatë festave shtetërore. Konteksti politik ka ndikim të madh për relacionet e tyre gjatë zgjedhjeve. Gjithmonë ka hidhërim nga të dy palët se kush do t'i marrë votat e bashkësisë turke. Pas zgjedhjeve, sikur asgjë s'ka ndodhur.

Nga përvoja personale, socializmin e veçon si një nga çastet më

të rëndësishme historike të Maqedonisë. Atëherë ka ekzistuar pakënaqësi, s'ka qenë ideale, por s'ka pasur moskuptime etnike. Sot të rinjtë e shohin historinë nga viti 2001 e këtej dhe e interpretojnë në kontekst politik. Për atë që ka ndodhur para vitit 2001 nuk ka interes. Më parë historia e turqve është përcjellë nga brezi në brez. Tani bëhen përpjekje kjo histori të përcillet edhe nëpërmjet arsimit, por, problemi nuk është vetëm te të rinjtë, të cilët nuk kanë interes, por edhe tek arsimtarët, të cilët janë të ngjyrosur me ngjyra partiake. Autoriteti për çështje historike është te brezat më të vjetër, të cilët e kanë përjetuar historinë. Në shkolla edhe më parë edhe sot mësohet histori e gabuar. Amdi Emini thotë se jo vetëm që historinë e shkruan fituesi, por këtë histori të shkruar e interpreton kujt si i konvenon.

Turqit kanë qenë nën presione të ndryshme. Dikur quhen shqiptarë, dikur turq. Maqedonasit pas konfliktit të vitit 2001 kanë antipati ndaj shqiptarëve, ndërsa në masë më të vogël edhe ndaj turqve. Në kuadër të strukturave në pushtet, përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme etnike bashkëpunojnë, por nuk e durojnë njëri-tjetrin. Nacionalizmi është problemi më i madh në Maqedoni. Me Marrëveshjen e Ohrit, bashkësitë etnike më të vogla fituan më shumë të drejta në të gjitha sferat.

Personalitete të historisë, nga të cilët duhet të mësohet, janë Goce Dellçevi dhe Titoja. Ata kanë qenë strategët më të mëdhenj. Kiro Gligorovi është më i merituari për pavarësinë e Maqedonisë. Sot nuk ekzistojnë njerëz të tillë, të cilët do të mbeleshin në kujtesë si heronj. Meritë gjatë socializmit kanë pasur edhe shqiptarët edhe turqit, por, edhe në historinë më të re. Historia duhet të shoqërohet me memorializim, për t'ua mësuar të rinjve, por, ajo e vërteta, jo historitë e modifikuara. Duhet të potencohet edhe nevoja për të mësuar njëri për tjetrin dhe t'u kujtohet se si kanë mundur më parë të jetojnë bashkë. Të rinjtë e të gjitha bashkësive etnike të mësojnë të bashkëpunojnë dhe të komunikojnë dhe të jetojnë së bashku më mirë sesa më parë.

Gruaja turke nuk mund të gjendet në rrëfimet historike nga e kaluara. Ajo ka qenë në shtëpi. Sot ajo është bashkëkohore dhe e emancipuar, e cila në mënyrë aktive merr pjesë në të gjitha sferat në të cilat më parë kanë qenë vetëm burrat.

Vase Ognenov, pensionist nga Çairi:

## Kujtimi i Luftës Qytetare në Greqi

**V**ase Ognenovi është pensionist i cili jeton në shtëpinë e azilit në Çair dhe është me prejardhje nga Maqedonia e Egjeut. Ai personalisht e ka përjetuar Luftën Civile në Greqi dhe shpërnguljen e popullatës maqedonase. Me prejardhje është nga fshati Babçevë (Bapçor), i cili nuk ekziston më, përveç kishës, e cila ka mbetur në fshat. Rrëfimi i tij fillon me largimin nga fshati në moshën 7-vjeçare, kur partizanët e kryeshtabit të PDG-së (Partia Demokratike e Greqisë) kanë dhënë urdhër fëmijët të largohen nga fshati gjatë natës, sepse do të ketë bombardime. Kanë kaluar nëpër Maqedoni rrugës për në Poloni. Pas shtatë vjet të kaluara në Poloni, kthehet në Maqedoni dhe mbetet këtu, sepse pas përfundimit të luftës, maqedonase u është lejuar të vijnë këtu.

Çasti më i rëndësishëm i historisë për bashkëbiseduesin tonë është eksodi. Sipas tij, politika të cilën e udhëheqë Greqia nga ai çast historik, kur, me ndihmën e Amerikës dhe Anglisë, e fituan Maqedoninë e Egjeut, është e pafalshme. "Greku nuk e ndërron mendimin... Politika mbetet e njëjtë" – thotë gjyshi Vase, duke shtuar se kontesti rreth emrit nuk do të zgjidhet kurrë.

Me nostalgji i kujton prindërit e vet partizanë, të cilët kanë luftuar për çlirimin e Maqedonisë, si dhe për jetën në Jugosllavinë feudale. Megjithatë, procesi i pavarësisë së Maqedonisë dhe 8 Shtatori, Dita e Paravësisë, janë më të rëndësishmit për të, ndërsa Kiro Gligorovi është më i merituari për ndarjen e qetë nga federata e dikurshme. Atëherë u është liruar rruga për të shkuar në Greqi dhe në vende të tjera jashtë Maqedonisë, pa i maltretuar. Nga historia më e re, si çast historik e veçon konfliktin e vitit 2001. Thotë se konflikti u imponua nga jashtë dhe ka kontribuar, nëpërmjet Marrëveshjes së Ohrit, për t'u dhënë të drejta më të mëdha bashkësive etnike sesa i kanë vetë Maqedonasit në vendin e vet. Prandaj, nuk shihet arsyeja për ankesën e vazhdueshme dhe pakënaqësinë nga ana e tyre. "Luftëtarët e tyre nuk janë heronj" – thotë ai, duke menduar për luftëtarët e UÇK-së. Ata kanë luftuar kundër vendit, jo për vendin. Nikolla Gruevski është hero, sepse i pari e ka prekur çështjen e "egej-cave" dhe kthimin në pronat e tyre. Tani për Maqedoninë më e rëndësishme është hyrja në NATO dhe BE.

Sipas Vase Ognenovit, kontributi i bashkësive etnike gjatë historisë është arsyeja pse vazhdon të jetohet së bashku. Ai është maqedonas dhe i pengon etiketa "egejcat", të cilët i bën sikur janë një etnikum i veçantë. Faji për trazirat dhe tensionet është i bashkësive etnike të tjera. Ata tërhiqen nga jeta e përbashkët. Politika sot ndikon se si do të jetohet me tjetrin. Më parë ka pasur barazi, klasë të mesme dhe liri të shoqërimit dhe komunikimit.

Pas vitit 2001 punët ndryshuan dhe rreziku ndjehet që nga pragu i shtëpisë. Nëse lihen anash shqiptarët, romët në Maqedoni janë ata të cilët kanë më së shumti të drejta në gjithë botën. Festat duhet të jenë në kuadër të historisë së shtetit. Skënderbeu mund të festohet, por grusht-shteti i vitit 2001 nuk duhet të lejohet të shënohet. Mes festave të lëna pas dore, e përmend 25 Majin, Ditën e Rinisë, në nder të Titos.

"Të mos ishte Titoja, Maqedonia nuk do të njihej. Njëjtë sikur



ne në Greqi, që nuk na njihnin. Unë vuaj pas socializmit” – thotë Vase Ognenovi. 1 dhe 2 Maji tanimë nuk festohen si më parë. E humbin edhe vlerën. Një nga gjërat më të rëndësishme për ‘egejcat’ ishin Takimet e Bahçes, derisa ishin gjallë luftëtarët. Iniciator i takimeve ishte Gjoko Doneski. Pas vdekjes së tij, askush nuk e zëvendësoi, ndërsa shteti nuk është i interesuar për të ndihmuar.

Gratë kurrë s’kanë qenë të përfshira në politikë. Gratë janë nëna, edukatore. Gjatë luftërave kanë qenë edhe luftëtare. Evdokija Foteva – Vera, është shembulli i tij për një grua heroinë, e cila ka prejardhjen nga Maqedonia e Egjeut dhe ka luftuar në luftën civile për çlirimin e saj. Llazo Tërposki është heroi i cili meriton të mbahet mend.

Historinë duhet ta shkruajnë historianët. Historia e vetme valide është ajo e Bllazhe Risteskit. Maqedonisë nuk i duhen shqiptarët t’ia krijojnë historinë. Përmendoret e disa personave janë gabim. Ata të cilët kanë qenë armiq dhe janë deklaruar si bullgarë, tani nderohen dhe kremtohen. Ata nuk duhet të ekzistojnë në historinë maqedonase (shembull: Todor Aleksandrov, Tatarçev).“

**Kreshnik Ajdini**  
në bashkëpunim me  
**Arbana Qerimin,**  
**Biljana Jordanovskan**

Kryetarët e komunave

Çair, Tetovë dhe Kërçovë

Izet Mexhiti, kryetari i komunës së  
Çairit:

## Decentralizimi nuk është zbatuar në mënyrë rrënjësore

“K omuna e Çairit në njëfarë mënyre është Shkupi i vjetër. Këtë e tregon një numër i madh i monumenteve historike. Ata kryesisht janë të periudhës osmane. Si pjesë e vjetër e qytetit, gjithmonë ka nevojë për kultivimin e vlerave të këtilla. Kjo është një gjë pozitive dhe e bën komunën Çair më atraktive me vetë faktin se në Çair është çarshia më e madhe në Ballkan. Ne bëjmë çmos për ta ngjallur dhe për ta bërë vendin më frekuent në qytet” – thotë Izet Mexhiti, kryetari i komunës Çair të Shkupit. Por, nga ana tjetër ankohet për mjetet e kufizuara për komunën – “Ne ballafaqohemi me decentralizimin e obligimeve dhe problemeve, por jo edhe të financave. Kjo paraqet një problem të madh për komunat të cilat kanë dëshirë dhe mundësi. Por, me mungesën e financave nuk mund t’u përgjigjen nevojave në terren, sidomos kur bëhet fjalë për kulturën dhe historinë. Prandaj përpiqemi që nëpërmjet donacioneve të huaja të kontribuojmë për zhvillimin kulturor dhe për turizmin. E tërë kjo shkon në të mirë të zhvillimit ekonomik lokal të komunës së Çairit”.

Në pyetjen se a ndikon dhe sa ndikon konteksti politik mbi kulturën e kujtesës në një mes shumetnik siç është komuna e tij, Mexhiti thotë se ai është kryetari i parë i komunës i cili del si re-

zultat i Marrëveshjes së Ohrit. "Unë jam kryetari i parë shqiptar i komunës së Çairit. Në vitin 2005 u ballafaquam me një administratë e cila nuk korrespondonte me realitetin e komunës. Gjatë viteve dhamë kontributin që administrata, politikat, investimet të jenë realiteti i Çairit dhe të gjithë qytetarët të ndjejnë se është institucioni i tyre, ku mund t'i zgjidhin problemet, t'i parashtrojnë kërkesat e tyre dhe të mund të presin ngritje të standardit të tyre jetësor. Qëllimi ishte që komuna e Çairit të pranohet si institucion i të gjithë qytetarëve të komunës", thotë ai, duke iu përgjigjur në vazhdim më konkretisht pyetjes: "Ndryshime u bënë edhe sa i përket kulturës dhe historisë. Pasi që Shkupi ka qenë i rëndësishëm edhe për shqiptarët nëpër histori, ndërsa disa elemente të Shkupit u eliminuan gjatë kohës së komunizmit dhe pas tij. Ne u përpoqëm të kthejmë diçka, por jo edhe ta teprojmë. I vendosëm vetëm përmendoret e Skënderbeut dhe Hasan Prishtinës. Financiarisht, vendosja e këtyre përmendoreve pjesërisht u mbulua nga buxheti i komunës së Çairit, e pjesa tjetër nga donacione. Politika ditore ndikon, por përpiqemi t'i ruajmë prioritetet e komunës. Domethënë, jo vetëm t'i lëshohemi të kaluarës, pa punuar për të ardhmen".

I pyetur se a mendon se bashkësitë e ndryshme etnike kanë kujtesë të ndryshme, kryetari i komunës së Çairit përgjigjen e lidhë me një temë aktuale të zgjedhjeve të fundit presidenciale, kur partia e tij propozoi që në lojë të hyjë "një kandidat konsensual, i pranueshëm për të gjithë". Sipas tij, kjo është vetëm një simbolikë se në rast se vendimet dhe institucionet në Maqedoni janë sa më shumë konsensual, aq më shumë qytetarët do t'i ndjejnë si të vetat. "Pa dallim të përkatësisë etnike dhe fetare, të tillë siç jemi, të ndryshëm, këto institucione dhe ngjarje do t'i ndiejmë si të përbashkëta. Në të kundërtën, me vendime të njëanshme për disa ngjarje, për flamurin, për emrin, do të kemi pikëpamje të ndryshme dhe do t'i ndiejmë ndryshe. Marrëveshja e Ohrit dha kontribut, jo vetëm për shqiptarët, por edhe për bashkësitë etni-

ke më të vogla të tjera, të ndjehen më të sigurt dhe më lojal ndaj shtetit. Mendoj se do të jetë një fillim i mirë kur vetë maqedonasi do të punojë për implementimin më të madh të Marrëveshjes së Ohrit dhe kur do ta kuptojë se ajo është një vlerë e përbashkët dhe investim për një perspektivë më të mirë të qytetarëve të Maqedonisë. Përderisa marrëveshjen e implementojnë vetëm shqiptarët dhe bashkësitë më të vogla, nuk mundemi këto vlera t'i shohim si një vlerë të përbashkët", thotë ai.

Krahas dy përmendoreve të heronjve shqiptarë, Mexhiti thekson edhe vendosjen e një përmendoreje të një poeti turk dhe një poeti boshnjak, për të cilët kanë dhënë donacione këto dy bashkësi etnike, por kanë marrë ndihmë edhe nga komuna. Ndihma nuk ka qenë e madhe, sepse s'ka dashur të bëjë shkurtime nga buxheti komunal, me të cilën gjë do të shkëpuste nga disa punë që janë të rëndësishme për komunën Çair. Ai këtë e thotë pas pyetjes se cilat raste, persona, ngjarje apo periudhë nga e kaluara, në çfarë mënyre dhe në çfarë lokacione kultivohen në kuadër të kulturës së kujtesës në këtë komunë.

Kryetari i komunës Mexhiti është për atë që historia të mos jetë shumë prezent. I pyetur se a ekziston ndonjë ngjarje historike, kujtesë të ndonjë personi apo festë të cilën e kishte zëvendësuar, nuk e kishte festuar më ose do të fillonte t'i kujtojë dhe t'i festojë, në rast se sot nuk kujtohen dhe nuk festohen, e ai konsideron se duhet, ai përgjigjet: Mendoj se shumë kemi hyrë në histori. Disa gjëra duhet të kthehen, disa të tjera të largohen. Realisht, jo si kryetar komune, por si qytetar, disa festa nuk e di se ç'paraqesin. Shoh përmendore për të cilat jam i bindur se një pjesë e mirë e qytetarëve nuk e di se ç'paraqesin. Mendoj se duhet të respektohet historia. Nuk duhet harruar. Disa punë, megjithatë, duhet të zvogëlohen dhe të mos inkuadrohen të reja. Rastin e Kalasë e kisha ndarë si një sukses në promovimin e diçkaje të përbashkët. Në vend të ndërtimit të kishës, siç ishte e planifikuar, tani do të ndërtohet një muze, i cili do të përfshijë

periudhën osmane, ilire, shqiptare dhe ortodokse”.

Sa i përket kujtesës së grave në histori, ai përgjigjet shkurt: “Një rrugë në Çair e mban emrin e mbretëreshës Teuta. Nëpërmjet saj shihet rëndësia e gruas nëpër histori në këtë nënqiell. Ka edhe të tjera të cilët kanë kontribuar në kulturën në rrethana të tjera”.

Teuta Arifi, kryetare e Komunës së Tetovës:

## Kemi nevojë të madhe për të tashmen

**K**ryetarja e komunës së Tetovës, Teuta Arifi, që në fillim të intervistës u ankua për mungesën e kompetencave të komunës mbi institucionet e kulturës. Institucionet kulturore kryesore në qytet vazhdojnë të jenë nën ombrellën e Qeverisë, e cila përcakton se cili institucion sa mjete do të marrë. “Unë nuk jam e kënaqur nga ajo që institucionet në Tetovë kanë marrë si mjete nga Ministria e Kulturës, sepse janë shumë të pakta dhe nënçmuese në raport me kapacitetin të cilin ne e kemi. Për këto arsye, ne si komunë, me politikat tona fiskale kemi arritur të ndajmë mjete për shumë ngjarje kulturore. Për një vit punë në Komunën e Tetovës ne kemi organizuar ngjarje kulturore, numri i të cilave korrespondon me ngjarjet e organizuara në shtatë vitet e kaluara. Nga viti i kaluar filluam me organizimin e Verës Kulturore të Tetovës. Këtë vit manifestimi do të zgjasë nga 16 deri më 26 qershor. Vetë e mbuluam, pa pjesëmarrje të centralit. Ne do t’i rrisim tendencat për të tërhequr mjete për kulturën në mënyrë të suksesshme, siç i tërheqim për fusha të tjera”, thotë

ajo.

Për ndikimin e kontekstit politik mbi kulturën e kujtesës, Arifi thotë se “ne të gjithë funksionojmë në kuadër të ndonjë konteksti politik, prandaj edhe ndikimi është i madh. Përpjekjet e mia janë që të kemi sa më shumë ngjarje të cilat lidhen me aktualitetin dhe kapacitetin e qytetit. Më shumë është e zhvilluar kultura e cila përfshin tema aktuale, më pak është e zhvilluar kultura e kujtesës. E ndjej se kemi nevojë të madhe për të tashmen”.

A mendoni se bashkësitë etnike të ndryshme kanë kujtesë të ndryshme? – është pyetja e ardhshme, në të cilën kryetarja e komunës së Tetovës përgjigjet: Gjithsesi. Ne u takojmë bashkësive etnike të cilat kanë histori të ndryshme. Prandaj kemi persona të ndryshëm të cilët ju i kujtoni dhe rrallëherë ata janë të përbashkët. Historitë ballkanike varen nga ajo se si interpretohen në të tashmen. Problemi me interpretimin e historisë ndikon mbi mënyrën e kujtesës. Pika e përbashkët ku do të duhej ta kërkojmë lidhjen është periudha e rënies së Perandorisë Osmane. Atëherë shqiptarët dhe maqedonasit kanë aspirata të përbashkëta të defnuara dhe të determinuara për liri. E njëjta gjë vlen edhe për periudhën nga Lufta e Parë Botërore.

Në pyetjen se cilat raste, persona, ngjarje apo periudha nga e kaluara, në çfarë mënyre dhe në çfarë lokacione kultivohen në kuadër të kulturës së kujtesës në këtë komunë, Arifi përgjigjet: “Sa i përket të kaluarës, objekte të rëndësishëm i konsiderojmë Xhaminë e Larme dhe Teqenë si objekte fetare. Si pjesë e historisë, këtu janë ngjarjet e lidhura me figura të Luftës së Dytë Botërore. Tetova është qytet i cili lidhet me familjen Deralla, ministri i parë i mbrojtjes në qeverinë e parë të Shqipërisë në vitin 1912. Ai është pjesë e historisë me të cilën lidhemi. Në afërsi të Tetovës është vendlindja e Kiril Pejçinoviçit. Një pjesë e madhe e shkollave e mbajnë emrin e tij. Më 17 mars e shënojmë ditën e arsimit shqiptar, më 24 maj të arsimit maqedonas. Këto ngjarje organizohen nga komuna. Kultura është një segment ku mund

të bëni shumë sa i përket afrimit të bashkësisë dhe prandaj jam shumë aktive në këtë fushë. Kishim një koncert të Filarmonisë Maqedonase, ku nuk është e rëndësishme se cilët janë artistët, por çfarë prodhojnë ata. Më 22 qershor do të ketë koncert Filarmonia e Kosovës, e cila do të plotësohet me 7 anëtarë të Filarmonisë Maqedonase.

Sa u përket përmendoreve dhe festave, kryetarja e komunës së Tetovës thotë se ata janë përgjegjësi e komunës. "Mirë është së pari t'i zgjidhim ato, e pastaj do të shohim se si do të merremi vesh për të kaluarën", thotë ajo.

Se a kishte ndryshuar diçka sa u përket ngjarjeve historike, kujtesa e ndonjë personi apo feste, Arifi thotë se rrjedhën e historisë dhe të kaluarës nuk mund ta ndryshoni. Sipas saj, ekziston një pjesë e historisë e cila është e ndryshme në vijën etnike. Kjo ka të bëjë me vitin 2001. Ekzistojnë pyetje të cilat i kisha zgjeruar sa i përket vitit 2001, në vend që t'i zëvendësoj. Kjo nuk është temë e cila duhet të diskutohet nesër.

Duket se përgjigje më të drejtpërdrejtë jep në pyetjen e fundit, nëse kujtohen dhe si kujtohen gratë në histori. "Historia i kujton burrat. Historia nuk është mik i madh i grave. Na bën vazhdimisht të kërkojmë përgjigje se pse s'ka më shumë gra shkrimtare, me Çmimin Nobël, pse ende nuk janë prezent në këtë proces. Mendoj se gratë bëjnë pjesë të madhe në këtë proces. Ato kanë qenë themeli i cili e ka zhvilluar dhe e ka përkrahur këtë proces, për shkak të të cilit i kemi të gjitha figurat e mëdha patriarkale, nëpërmjet të cilëve identifikohen popujt në Ballkan. Kanë luajtur një rol të madh, i cili pak pranohet. Gratë duhet të insistojnë në kujtesën e rolit të tyre nëpër histori, e jo në ndonjë figurë. Duke kërkuar persona, do ta humbim betejën. Pse ndodhë kështu? Do ta citoj Virxhinia Vulfin: Gratë s'kanë pasur një dhomë të vet për ta mbyllur dhe 100 funta në muaj për të shkruar libra. Prandaj ka pasur më shumë burra shkrimtarë sesa gra. Prandaj është e rëndësishme ta theksojmë rolin tonë në



tërë këtë sistem, përkundër asaj se sa kemi qenë të diskriminuara në atë sistem. Atëherë mund të flasim për figurat femërore sa i përket kujtesës. Sa i përket historisë sonë, gratë nga natyra e tyre femërore kanë dalë vetëm për të luftuar bashkë me burrat. Si figura do t'i merrja mësueset e para. Kur është dita e komunës, çdo vit japim mirënjohje, sipas vitit të lindjes, një gruaje arsimtare dhe një burri arsimtar në lidhje me kontributin e tyre në arsim. Për figura nga historia politike më e re nuk duhet të flasim ne, por të tjerët duhet të flasin për ne”.

Fatmir Dehari, kryetar i Komunës së Kërçovës:

## **VMRO-DPMNE dhe LSDM u bënë së bashku për të mos lejuar që shqiptari të bëhet kryetar komune**

**F**atmir Dehari është kryetari i parë shqiptar i komunës së Kërçovës. Ai u zgjodh në zgjedhjet vendore të vitit 2013, si kandidat i Bashkimit Demokratik për Integrim. Që një shqiptar të bëhet kryetar komune, u mundësua me marrëveshjen e para më shumë viteve, që komunës së Kërçovës t'i bashkëngjiten edhe disa fshatra të banuar me shqiptarë. Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje anulohet deri në këto zgjedhje. Në zgjedhje ai luftonte me një kandidat të përkrahur nga dy partitë më të mëdha, VMRO-DPMNE dhe LSDM, të cilat, edhe pse kundërshtarë të mëdha, "e kishin patjetër" të bashkohen në Kërçovë dhe në Strugë, "për të mos lejuar që shqiptarë t'i udhëheqin këto dy komuna".

Në intervistën për Civilin, Dehari thotë se komuna e tij për praktikimin e kulturës lokale çdo vit e rrit buxhetin. Ai shpreson se komuna do ta ndihmojë kulturën në nivel lokal. Por, siç thotë, nevojat dhe kërkesat janë gjithmonë të mëdha dhe se shpreson se edhe pushteti qendror, Ministria e Kulturës, do të ndihmojë në realizimin e projekteve të ndryshme në Kërçovë.

Në pyetjen për ndikimin e kontekstit politik mbi politikën e ku-

jtesës në Kërçovën shumetnike, kryetari Dehari përgjigjet: "Deri më tani kemi pasur një situatë të mirë të përditshme ndëretnike dhe unë s'kam vërejtur ndonjë problem në këtë aspekt. Shpresoj se s'do të kemi probleme në të ardhmen. Kultura është një koncept i cili në vete përfshin edukimin, civilizimin, domethënë standardet më të lartë në një shoqëri. Ne të gjithë do të kontribuojmë që politika apo politikanët në çaste të caktuara të mos ndikojnë mbi përkeqësimin e marrëdhënieve, qofshin ndëretnike, apo ndërnjerëzore".

Sa i përket pyetjes se a mendon se bashkësitë e ndryshme etnike kanë kujtesë të ndryshme, ai konsideron se kjo temë është interesante dhe kërkon një qasje studimore. Sipas tij, bashkësitë kanë kujtesë të ndryshme rreth ngjarjeve. "Por, shpeshherë ndodhë njerëzit të kujtojnë ngjarje të njëjta apo të ngjashme dhe kjo është mjaft inspiruese për shoqërinë e re. Unë jam i mendimit se njerëzit kujtojnë ngjarje të njëjta, të përbashkëta, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe kulturën e përbashkët. Në fund të fundit, të gjithë jemi njerëz dhe duhet të mendojmë për tjetrin si për vetveten", thotë politikani Dehari. Në pyetjen konkrete në vijim, se cilat raste, persona, ngjarje apo periudha në të kaluarën, në çfarë mënyre dhe në cilat lokacione kultivohen në kuadër të kulturës së kujtesës në këtë komunë, ai përgjigjet: "Nuk bëjmë ndonjë aktivitet të veçantë për aktivitetet e ndryshme historike, festivale të ndryshme ndërkombëtare apo vendore. Kërçova ka një migracion të shquar, prandaj kemi edhe aktivitete rreth kurbetçinjve shqiptarë. Varësisht nga kërkesat e bashkësive të ndryshme, siç janë romët, turqit, kemi edhe aktivitete, si me rastin e alfabetit turk, Ditën e Romëve etj.".

Është shumë e vështirë të ndikosh mbi ndjenjat e njerëzve, thotë ai, i pyetur se a ekziston një ngjarje historike, kujtesë e ndonjë personi apo festë të cilat i kishte ndryshuar në komunë, do të pushonte së festuari apo do të fillonte t'i kujtojë dhe t'i festojë, në rast se sot nuk kujtohen dhe nuk festohen. Në vazhdim

të përgjigjes, ai konkretisht e përmend vetëm UÇK-në (Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare), e cila filloi një kryengritje të armatosur në vitin 2001 në Maqedoni, e anëtar i së cilës ishte edhe ai vetë. "Unë kam komunikim të shpeshtë me ish-luftëtarët e UÇK-së, të cilët festojnë ngjarje të ndryshme nga ajo periudhë. Pjesa e mbetur e përgjigjes i përngjan një fjalimi të moderuar të një kryetari komune shumetnike: "Pastaj, ka edhe kategori të tjera, duke pasur parasysh edhe moshën. Është fakt se kemi ngjarje historike të cilat nuk janë të rëndësishme në këtë periudhë në të cilën jetojmë, por ka edhe ngjarje historike të cilat janë më të reja dhe mund të organizohet ndonjë manifestim për to. Gjithmonë është e rëndësishme që si një shtet apo komunë shumetnike të jemi të kujdesshëm të mos ndikojmë mbi ndjenjat, qofshin ato të bashkësive etnike apo moshave të ndryshme. Të gjejmë një zgjidhje e cila do të reflektojë dhe shumica që jeton në këtë qytet të jetë e kënaqur".

Pyetjes a kujtohen dhe si kujtohen gratë në histori, ai, krahas vlerësimeve të përgjithshme se duhet t'i përkushtohet më shumë kujdes gruas, përsëri u kthehet marrëdhënieve ndëretnike, gjegjësisht e jep përgjigjen e asaj se pse nuk është shumë konkret në përgjigjet e mëparshme: "Kërçova është specifike për shumë arsye, kemi komunë të re, ka një vit që kur funksionon, domethënë ende jemi të kujdesshëm të mos ndikojmë mbi ndjeshmërinë ndëretnike".

**Biljana Jordanovska**

Muzetë

Kultivimi i kulturës së kujtesës në shkollat në  
Komunën Çair

Biblioteka “Koço Racin” - Tetovë

## Baki Aliu, Muzeu i Lirisë në Çair

**M**uzeu u hap më 28 nëntor 2008, ditën e krijimit të shtetit shqiptar. Përkrahje të madhe ka pasur nga kryetari i Komunës së Çairit Izet Mexhiti dhe kryetari i BDI-së Ali Ahmeti.

“Nëse flasim për kulturën shqiptare dhe vlerat e krijuara në këto hapësira, ku jetojnë etnikume të ndryshme, duhet t’i marrim si vlera të krijuara nga shqiptarët në Maqedoni. Nëse e marrim këtë si pikënisje, interes duhet të ketë edhe nga grupet e ndryshme etnike. Siç na intereson ne Kryengritja e Ilindenit edhe etnikumeve të tjera duhet t’i interesojë historia jonë”.

“Shembull për bashkëpunim mes bashkësive etnike në të kaluarën është ai i Hasan Prishtinës me përfaqësuesit e centralistëve të VMRO-së. Hasan Prishtina dhe Todor Aleksandrovi kanë nënshkruar marrëveshje për të luftuar së bashku për të drejtat e maqedonasve dhe shqiptarëve. Shqiptarët kanë bashkëpunuar me veprimtarë të kauzës maqedonase që së bashku t’i zgjidhin çështjet kombëtare edhe të maqedonasve edhe të shqiptarëve”.

## Aco Nestoroski, Muzeu i LNÇ-së në Kërçovë

**M**uzeu e përfshin periudhën prej vitit 1939 deri në vitin 1945 për ngjarjet nga Lufta e Dytë Botërore, të cilat janë zhvilluar në pjesën perëndimore të Maqedonisë, gjegjësisht në Gostivar, Tetovë, Kërçovë, Dibër dhe Strugë.

Sipas bashkëbiseduesit tonë, puna e muzeut nuk është në tërësi e mëvetësishme. Për ndryshime në punën apo eksponatet duhet të kërkohet leje nga Drejtoria për Mbrojtjen e Përmendoreve.

“Bashkëpunimi është përmirësuar në planin e projekteve humltuese me historianët. Në këtë periudhë, është rritur interesi

për Kryengritjen e Ilindenit. Kur flitet për Kryengritjen e Ilindenit, flitet vetëm për Krushevën, por në atë periudhë janë kryer disa beteja kryengritëse të rëndësishme në Kërçovë, por këto janë të panjohura”, na e zbulon Nestoroski. “Ka pasur bashkëpunim mes shqiptarëve dhe vojvodave dhe këtu nuk kemi probleme sa u përket bashkësive të tjera etnike.”

“Duhet më guximshëm të sillemi, duhet gjithçka të publikohet” – është mendimi i Nestoroskit – “Në histori, për shembull, nuk është Kryengritja e Ohrit, ku bashkohen maqedonasit dhe shqiptarët kundër serbëve. Në kohën e komunizmit kjo gjë nuk u publikua. Tani kishte disa debate, por kjo mbeti jashtë institucioneve. Nga luftërat e Ballkanit deri në Luftën e Parë Botërore ka pasur shumë ngjarje të tilla, të cilat nuk janë interpretuar në tërësi ose janë interpretuar ndryshe në histori. Mendimi im është se historinë e shkruajnë politikanët, jo historianët.”

## Valentina Gavrilovska, Muzeu i Rajonit të Tetovës

**M**uzeu është krijuar në vitin 1950. Është i përbërë nga shtëpia e Goce Stojanovskit, në të cilën është krijuar partia komuniste e RSM, Hamamit dhe Arabati Teqesë. Pas vitit 2001, teqesja iu mor Muzeut nga ana e Bashkësisë Fetare Islame dhe nga bektashinjtë. Pasi kanë arritur të marrin leje për hyrje në të, me ndërmjetësimin e OSBE-së, të punësuarit në muze zbulojnë se të gjitha ekspozitat nga muzeu janë zhdukur.

Muzeu ka status të institutit kombëtar, i cili financohet nga shteti, por bashkëpunon edhe me institucione të tjera, si Ambasada e Holandës. Nga viti 2001 kryesisht punohet me projekte për bashkëjetesë.

Megjithatë, nuk ka sukses të madh. “Më parë vizitohej nga turistë vendas dhe të huaj, por pas vitit 2001 e tërë kjo mori fund.

Pas kësaj edhe shoqërimi mes njerëzve në Tetovë u ndal”, thotë Gavrillovska.

“Sipas të dhënave historike, deri në vitin 1903 ka pasur pak shqiptarë dhe në Tetovë dhe Gostivar është folur vetëm maqedonisht dhe turqisht” – thotë Gavrillovska dhe shton: “Në listën e të vrarëve në LNÇ kemi edhe disa shqiptarë. Emrat e një pjese të të vrarëve në Luftën e Dytë Botërore përfundojnë me iq, sepse në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, mbiemrat e maqedonasve ndryshoheshin në mënyrë intensive dhe si të tillë kanë mbetur në listë.”

Gavrillovska nuk mund të përmend ndonjë politikan apo një individ tjetër i cili kontribuon në afrimin dhe për paqe mes njerëzve në Tetovë. Megjithatë, si maqedonas-shqiptar më të madh e veçon yllin e muzikës Beni Shaqirin. “Gjithsesi se ka disa individë të cilët kanë bërë diçka në këtë plan. Nga politikanët është Mersel Bilalli, nëpërmjet kollumnave të tij, e shoh se ai do të jetojmë së bashku. Unë nuk i ndaj njerëzit sipas përkatësisë kombëtare, për mua ka vetëm njerëz dhe jonjerëz” – konkludon Gavrillovska.



## Kultivimi i kulturës së kujtesës në shkollat në Komunën e Çairit

**E**kipi hulamtues i Civilit vizitoi tri shkolla në Komunën e Çairit, dy fillore dhe një shkollë të mesme. Bëhet fjalë për shkolla etnikisht të përziera. Dy janë tregjuhësore dhe njëra shkollë është dygjuhësore. Në njëërën shkollë fillore dhe në shkollën e mesme drejtorët janë shqiptarë. Në tjetrën shkollë fillore drejtoresha është maqedonase.

Të tre drejtorët u shprehën se e tyre ka qenë iniciativa për komunikim dhe përzjerje të paraleleve. Të gjithë në pozitën e drejtorit kanë ardhur në dy vitet e fundit. Mes bashkëbiseduesve të Civilit ishte edhe një profesoreshë e historisë.

Të gjitha aktivitetet të cilat janë të lidhura me shoqërimin e përbashkët, komunikimin dhe lidhjen e fëmijëve të bashkësive të ndryshme etnike, janë pjesë e ndonjë projekti, i cili është i përkrahur nga USAID apo nga Ministria e Kulturës dhe ajo e Arsimit.

Sipas mendimeve të tyre, ekziston një bashkëpunim i mirë dhe interes për bashkëjetesë dhe edukatë të përbashkët të fëmijëve. Këtë arritje në mënyrë indirekte ia përkushtojnë punës së vet të mirë dhe dëshirës për përparim. Nuk ekzistojnë tensione mes profesorëve, vetëm respekt dhe mirëkuptim. Ky është mësimi i parë të cilin dëshirojnë t'ua transmetojnë nxënësve. Nga përvoja e tyre ta nxjerrin anën pozitive të bashkëjetesës. Kontribut të madh kanë edhe prindërit, të cilët në tërësi i përkrahin shkollat në përpjekjet e tyre për kontribut ndaj shoqërisë për paqe dhe prosperitet në planin etnik. Komunikimi i mirë me prindërit

është, gjithashtu, kontribut i tyre. Tensioni i krijuar nga frika nga bashkimi dhe ndikimi i vendimit të sjellë, drejtorët e kanë qetësuar me arsyetim dhe argumente, duke e shpjeguar nevojën për ndërtimin e marrëdhënieve të mira ndëretnike te fëmijët.

Në komunikimin me profesoreshën e historisë kuptuam se ekziston një pakënaqësi te profesorët maqedonas, e cila ka të bëjë me librat shkollor të historisë, mënyrës dhe materialit të cilin nxënësit duhet ta mësojnë.

“Shumë mësim ka për historinë e popullit shqiptar. Nuk i mësojmë të gjithë. Mësojmë për Skënderbeun, krijimin e familjeve feudale te shqiptarët, për principatat. S’kemi fond të mjaftueshëm të orëve për t’i ligjëruar të gjitha mësimet. Libri i historisë nuk është bërë mirë. Ka gjëra të cilat unë nuk i kam mësuar për historinë shqiptare. Tani duhet së pari unë të mësoj që të mund t’ua ligjëroj fëmijëve. Ka tepër shumë për popullin shqiptar. Të mësosh historinë e një populli është në rregull, por në një masë kaq të madhe, vetëm nëse jeton në Shqipëri.” – na deklaroi profesoresha e historisë në një shkollë fillore.

“Fëmijët tani, për dallim nga gjeneratat më të vjetra, janë më pak të interesuar për historinë. Për historinë maqedonase faktet janë shumë të dendura. Shumë pak mësohet për LNÇ-në dhe për Jugosllavinë. Gjithçka është e thjeshtë. Përpiqem ta zgjas mësimin”, thotë profesoresha e historisë.

**E**kipi hulamtues i Civilit e vizitoi bibliotekën "Koço Racin" në Tetovë. Për arsye hapësinore, nuk janë ndarë sipas fushave. Por, në Kobis Sistemin me të cilin mbahet evidenca e librave, mund të kërkojen më lehtë. Më së shumti lexohet beletristika, por ka interes edhe për libra nga fusha e historisë. Fondi i librave përfshin 140.000 libra, nga të cilët disa nuk janë në dispozicion, sepse nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për t'i vendosur.

Shumica e librave të historisë janë në gjuhën maqedonase – 708 tituj. Në shqip janë 271 tituj. Pastaj, ka tituj edhe në anglisht (18), serbisht (390), sllovenisht (2), boshnjakisht (8), turqisht (8), bullgarisht (2), gjermanisht (2), frëngjisht (5) dhe në gjuhën rome (2).

Libra për historinë e Maqedonisë ka 649:

maqedonisht – 582

shqip – 45

anglisht – 15

gjermanisht – 1

kroatisht – 9

serbisht – 16

rusisht – 3

turqisht – 2

bullgarisht – 2

frëngjisht – 4

në gjuhën rome – 2

Në këtë bibliotekë ka 15 libra, të cilët e përfshijnë Kryengritjen e Ilindenit në titull, Lufta Nacional Çlirimtare është prezent në 16, ndërsa Konflikti i vitit 2001 në 17 tituj të librave me të cilët disponon kjo bibliotekë. Këto të dhëna kanë të bëjnë me libra të ndarë vetëm sipas titujve, por jo edhe sipas përmbajtjes.

Statistika e bibliotekës thotë se qarkullimi mesatar i letërsisë nga fusha e historisë sillet rreth 8 libra në muaj. Në periudhën e përpunimit të temave dhe eseve të maturës, numri i librave të historisë të huazuar sillet 15-16 libra në muaj. Në muajt e tjerë të vitit huazohen mesatarisht gjashtë libra në muaj.

**Pjesa I: Biljana Jordanovska**

**Pjesa II: Sasho Talevski**

**Pjesa III: Arbana Qerimi**

**Pjesa IV: Kreshnik Ajdini**

Pasqyrë e përmbajtjeve të përzgjedhura nga interneti  
dhe të botuara, të përkushtuara ngjarjeve historike të  
përfshira me këtë hulumtim

# Pjesa I

## Kryengritja e Ilindenit

**K**ryengritja e Ilindenit në rajonin e Kërçovës është më pak e eksponuar. Të gjitha faktet e paraqitura çojnë drejt rëndësisë dhe kontributit për luftën për vetëvendosje. Muzeu i Kërçovës me këtë rast ka publikuar dy botime me këtë temë. “Kryengritja e Ilindenit në vitin 1903 – përgatitja ushtarake dhe rrjedha e kryengritjes – rajoni i Kërçovës”, botim i Institutit për Histori Ushtarake; Sofje, 1992. Në gjuhën maqedonase është përkthyer dhe është botuar nga “Muzeu i Rajonit Perëndimor në LNÇ” me titull “Kërçova dhe rajoni i saj gjatë Kryengritjes së Ilindenit”, 2013, Kërçovë.

Në mënyrë krahasuese, faktet përputhen, me disa variacione të vogla. Sa i përket botimit bullgar, vetë autori, historian, ka pasur probleme me materialin të cilin është dashur ta botojë. Prandaj qëndron vetëm vërejtja se të gjitha referencat të cilat kanë të bëjnë me bullgar, bullgare dhe kryengritje bullgare, kanë të bëjnë me maqedonas, maqedonase dhe kryengritje maqedonase. Në fshatrat e Kërçovës, të cilët kanë qenë nën ndikimin e politikës serbe, populli është deklaruar si serb, por, gjatë mobilizimit, kanë qenë të mobilizuar si bullgarë. Kjo konsiderohet si një nga sukseset e Kryengritjes Bullgare (së Ilindenit). Në versionin maqedonas, kjo e dhënë fare nuk figuron. Për këto fshatra thuhet se janë inkuadruar më vonë. Robëria osmane, lufta kundër turqve, në dokumentacionin bullgar janë me një emër: okupatori. Korniza kohore në fillim të kryengritjes është mes mesnatës dhe orës një, por nuk dihet saktë. Në versionin maqedonas qëndron se kryengritja ka filluar saktësisht në mesnatë. Problemi me rrezi-

kun, i cili është pritur nga Shqipëria, është zgjidhur në mënyrë strategjike, me vendosjen e çetave në atë anë, të cilat do të kujdesen për çfarë do depërtimi. Në versionin bullgar, arrihet neutralitet me prijësit shqiptarë. Sa i përket numrit të luftëtarëve nga njëra apo nga ana tjetër, ka dallim. E njëjta gjë vlen edhe për numrin e fshatrave të cilët janë djegur. Beteja më e përgjakshme dhe njëra nga të rrallat të suksesshme, ka ndodhur në Gjurgjejcë. Në dokumentacionin bullgar nuk përmendet.

Kryengritja e Ilindenit, në përgjithësi, për elitat e atëhershme në Greqi, nuk ka rezultuar me befasi. Është pritur që organizata revolucionare maqedonase të organizojë kryengritje. Grekët e kanë konsideruar si organizatë bullgare. Vetë qeveria greke dhe shoqata të ndryshme në Greqi kanë punuar kundër kryengritjes, sipas burimeve në gjuhën maqedonase. (Përmbledhja vjetore, Fakulteti Filozofik; Reaksionet greke për Kryengritjen e Ilindenit; Dalibor Jovanovski)

Lidhja me popullatën shqiptare në Maqedoni kundër pushtetit turk i ka kontradiktat e veta dhe jo vetëm nga ana e interpretimit maqedonas për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre, por edhe në rrethet shqiptare historiane. Ekzistojnë definicione dhe interpretime të ndryshme të Kryengritjes së Ilindenit. Sipas profesorit Halim Purelku, vetë historiografia shqiptare ka lëshime. Është pranuar historiografia maqedonase për përfshirjen e drejtpërdrejtë apo për rolin pasiv të shqiptarëve në kryengritje, pa qëndrim kritik. Askund nuk përmendet kërkesa e një pjese të popullatës në Shqipëri për inkuadrimin vullnetar në luftën kundër pushtetit turk dhe as që përmenden shqiptarët të cilët në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në shuarjen e kryengritjes.

Historiani Zejni Mazllami ka një pikëpamje tjetër. Ai e thekson barazinë e shqiptarëve me maqedonasit dhe vllëhtë në atë periudhë. Lufta kundër osmanlinjve si një kauzë e përbashkët, ka kontribuar për trajtimin e njëjtë e të gjithë popujve. Më të spikatur kanë qenë shqiptarët nga radhët e bektashinjve. Ka ekzis-

tuar një bashkëpunim mes agallarëve shqiptarë me revolucionarët maqedonas. Mazllami e thekson bashkëpunimin e Pitu Gulit me Themistokli Gërmenjin. Shqiptarët janë ata të cilët e kanë dhënë kontributin më të madh në furnizimin e kryengritësve me armë. Sipas Mazllamit, arma ka ardhur nga vende të ndryshme, sidomos të njohura janë vijat e furnizimit Ohër-Pogradec dhe Tetovë-Kërçovë. Kontribut të madh kanë dhënë shqiptarët nga fshatrat Eleovë, Negovan, Balkamen dhe Kotori i Poshtëm, rajoni i Janinës, si dhe fshatarët e Zhitoshës, Nerovës dhe Aldaçit, të rrethit të Prilepit.

Mazllami u ndërlidhet fakteve të cilat janë të njohur në historiografinë maqedonase për raportet mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Përveç se është i përbashkët qëndrimi për furnizimin me armë, historia maqedonase – albanologe dr. Katerina Todoroska, i thekson lidhjet individuale tradicionale të cilat i lidhin këta dy popuj. Megjithatë, arrihet deri te përfundimi se nuk kanë qenë mjaftueshëm të forta, sa për të mundur të përfitojnë së bashku dhe t'u kundërvihen interesave të huaja. Në periudhën e organizimit të kryengritjes, revolucionarët maqedonas kanë pasur problem me tërheqjen e shqiptarëve. Pengesa më e madhe kanë qenë dallimet fetare dhe roli të cilin ata e kanë pasur në Perandorinë Osmane. Megjithatë, duke u thirrur në lidhjet familjare dhe miqësore, ia kanë dalë të tërheqin një numër të madh prej tyre. Madje, kanë marrë informata nga shqiptarët të cilët kanë punuar në administratën osmane. Dr. Todoroska si më të dalluar mes shqiptarëve e veçon Bilal Arif Naxhakun, i cili ka bërë pjesë në më shumë luftime dhe është plagosur dy herë. Për kontributin e tij gjatë luftës, Presidiumi Kombëtar Maqedonas i Republikës Popullore të Maqedonisë i jep çmimin Dekorata e Ilindenit dhe pension.

Bashkësia ndërkombëtare, nga ana tjetër, e interpreton këtë kryengritje nga një pikëpamje tjetër. Në disa raste përmendet Boris Sarafovi, si kreator i kryengritjes. Qëllimi ka qenë interven-



im ndërkombëtar pas masakrës nga ana e turqve, siç është parashikuar në rast se realizohet kryengritja. Megjithatë, sado që kjo iniciativë të ketë qenë serioze, në shumë gazeta nga ajo periudhë kanë shkruar me përbuzje. Deviza e Sarafov it "intervenim ose revolucion" ka kontribuar vetëm për monitorim të gjendjes në rajon. Qëndrimin e Britanisë së Madhe e shpreh kryeministri i atëhershëm Balfur, në Odën e Poshtme të Parlamentit. Sipas fjalëve të tij, kriminaliteti më shumë është i përfshirë te revolucionarët sesa te pushteti turk. Nëse qëllimi përfundimtar i Maqedonisë është me çmimin e paqes së përgjithshme të krijojë një gjendje të padurueshme në rajon, që të intervenojë Rusia apo Austria, Britania e Madhe do të tërhiqet nga politika e tillë. Në artikullin e titulluar "Masakra e patejkalueshme" thuhet se qeveria turke në ditën e katërt të Republikës së Krushevës vendos ta shuajë revolucionin me masa ekstreme. Qëndrimi i Britanisë mbetet se turqit duhet t'i qetësojnë trazirat në Portë (Perandori) dhe se revolucioni nuk do të dalë nga kontrolli, sepse nuk ka mjete për t'u mbajtur.

Në atë kohë New York Times del me një artikull, në të cilin thuhet: "Në asnjë mënyrë ata të cilët veten e quajnë maqedonas – pasardhës të fiseve të degjeneruara sllave dhe endacakët të cilët i ndiqnin luftërat e para kryqtare të krishtera – nuk meritojnë asnjë keqardhje". Ndaj kësaj, sekretari i komitetit maqedonas në Amerikë, Vlladimir Andreev Canov, u përgjigj: "Të hënën shkruanit për revolucionin maqedonas, por nuk kuptoni se kjo është përsëritje e ngjarjeve të vitit 1776, me një përjashtim – revolucioni në Maqedoni nuk është si revolucioni në Amerikë, sepse nuk luftojnë njerëz me ngjyra të ndryshme të lëkurës, por evropianë të barabartë".

Me interes më të madh për vendet e Ballkanit kanë qenë Gjermanët. Për shkak të raporteve të mira me Perandorinë Osmane dhe interesat e përbashkëta, dy vendet kanë lidhur marrëveshje për ndërmarrjen e një iniciative të përbashkët për përmirësimin

e gjendjes së popullatës në Maqedoni. Edhe pse kanë arritur deri te kompromisi edhe sa i përket reformimit të administratës, gjyqësisë dhe resorëve të tjerë, turqit qëmoti kanë qenë të vendosur t'i sabotojnë këto reforma. Bëhet fjalë për të ashtuquajturat Reforma të Mircshtegut të dhëna me propozim të qeverisë angleze dhe të marra vesh së bashku me Rusinë dhe Austro-Hungarinë. Plani për vendosjen e kufijve të reja në Ballkan mund të shihet nga shënimet e grofit fon Bilov, kancelarit shtetëror të atëhershëm të Gjermanisë:

"...tha ministri (ministri i jashtëm Grofi Goluhovski) se nuk do t'i hyjë punës për autonominë e Maqedonisë. Ai kurrë nuk do të lejonte formimin e Serbisë së madhe apo Malit të Zi të madh, siç nuk vjen parasysh Carigradi t'i takojë Ruisë apo mes Adriatikut dhe Danubit të krijohet një shtet i madh sllav... Grofi Gohulovski vazhdimisht i kthehej asaj se do të përpiqet sa të jetë e mundur të ruajë një status-kuo dhe çështja e lindjes mund të zgjidhet më vonë në etapa. Ideali i tij është që pushtimin turk ta zëvendësojë me një shtet autonom dhe, sipas mundësive, krijimin e Greqisë së madhe, Rumanisë së madhe, Bullgarisë së madhe, Serbi të dobët, Mal të Zi të vogël dhe, në fund, të krijojë Shqipëri të pavarur."

Në pyetjen se si sot shënohet viti 1903 dhe Kryengritja e Ilindenit, përgjigjet një artikull në gazetën Nova Makedonija, me titull "Maqedonasit vetë e retushojnë Kryengritjen e Ilindenit", në të cilin thuhet se në vetëdijen e maqedonasve, Kryengritja e Ilindenit përmbledhet në 10 ditët e Republikës së Krushevës. Kryepersonazhe janë Nikolla Karevi dhe Pitu Guli. Boris Sarafov, Anastas Lozançev, Jane Sandanski, Gjorçe Petrov dhe Vasil Çakaparov janë vetëm një pjesë e emrave të cilët jo vetëm që janë harruar, por, në disa raste, edhe janë kontestuar. Sipas autorit të artikullit, populli maqedonas ose nuk di, ose e pranon të mos di se epopeja e Krushevës është vetëm një nga episodet e Kryengritjes së Ilindenit. Ajo shuhet më 13 gusht, në kohën kur

në një pjesë të Maqedonisë sapo kishin filluar betejat. Lista me të ndaluar plotësohet me Slavejko Arsovin nga Resnja, i cili me kryengritësit e vet ka luftuar tërë shtatorin. Kur e ka parë se lufta është e pashpresë, ka ikur me kryengritësit e vet në Bullgari. Pando Kloshevi nga Kosturi, në dëshminë e vet tregon se nga 17 shtatori deri më 17 tetor kanë qenë të ndjekur pamëshirshëm nga turqit. Luka Xherovi, vojvoda i cili i ka prirë sulmit të pasuksesshëm të Kërçovës, më 3 gusht ka shkruar se më 10 tetor zyrtarisht i jepet fund kryengritjes. Pyetja e autorit është se nëse nga viti 1945 deri në vitin 1990 është dashur që kjo pjesë e historisë të mos evidentohet në memorien kolektive të popullit maqedonas, cila është arsyeja që kjo traditë të vazhdojë deri më sot?

## Miti për Jugosllavinë e Titos

**T**aki Fiti, profesor universitar, konsideron se kontributi të cilin e ka Jugosllavia e Titos, që sot të gjithë të thonë se atëherë është jetuar më mirë dhe ka mundur të planifikohet ardhmëria, është sistemi ekonomik. Siç thotë profesori, rritja ekonomike deri në 11 për qind në vitet gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjeta ka kontribuar për popullarizimin e ideologjisë komuniste. Fillimi i viteve të tetëdhjeta u reduktua në një “kufizim të butë buxhetor”.

“Paratë në buxhet vinin nga kompanitë e suksesshme, kështu që ato bëheshin nënmesatare. Kështu u godit efikasiteti ekonomik, pa të cilin nuk mund të ekzistojë asnjë sistem, prandaj edhe dështoi socializmi” – thotë profesor Taki Fiti.

Ajo që më vonë vazhdoi si një rregull i zhytjes ekonomike, profesor Risteski arsyen e sheh në luftërat, shkatërrimet dhe mbylljen e tregjeve. Në të kundërtën, shtetet të cilët dolën nga prishja e Jugosllavisë, do të vazhdonin me zhvillimin. Ai e merr si shembull

Suedinë, si një vend i cili është zhvilluar si vend socialist paralelisht me Jugosllavinë, por, më mirë i ka bashkuar zhvillimin demografik dhe ekonomik.

Nga një perspektivë pak më të ndryshme, këtë gjendje të verbërisë e shpjegon Loreta Jakovleva – Georgievska, profesoreshë universitare nga Instituti i Letërsisë.

“Është fakt se në rrëfimin e Jugosllavisë së Titos shumëkush besonte. Ky rrëfim, në një farë mënyre, u rrit në një mit. Por, sikur një kohë e caktuar i nënshtrohet mitologjizimit, kështu vjen edhe koha kur mitet rrënohen, demitologjohen. Humbet besimi në rrëfimin, ajo nuk duket më e vërtetë. Dhe, si në çdo mit, kemi heronj dhe viktimë. Ndoshta për heronjtë dhe ata që u kanë besuar, Jugosllavia e Titos është një utopi pozitive, për viktimat – negative – thotë Jakovleva – Georgievska.

Kur bëhet fjalë për shpëtimin e Maqedonisë me inkuadrimit në Jugosllavinë Federale, vihet në pikëpyetje ideja e ilindenasve, të cilët bashkimin me Jugosllavinë nuk e kanë parë nëpër prizmen e unitarizimit. Prandaj edhe theksohet ndryshimi i përbërjes etnike në Maqedoni, shfaqja e problemeve etnike në Maqedoni dhe roli shkatërrues i ideologjisë komuniste mbi kulturën dhe artin. Fakti se vetëm çastet e mira nga ajo kohë mbahen mend, të këqijat janë lënë diku anash në memorien kolektive, tregon se sa Maqedonia ka qenë e pavarur. Terrori shtetëror mbi të gjithë kundërshtarët e regjimit, vetëm e dëshmon këtë tezë. Nga konkluzionet e ueb portalit Kombi Maqedonas hapet çështja e rolit të VMRO-së së Vanço Mihajlovit në atë periudhë, gjegjësisht heshtja sa u përket akuzave dhe lidhja me të burgosurit politik dhe thirrja për një organizatë terroriste. Qëllimi ka qenë ndërprerja e kujtesës, domethënia dhe idealet e VMRO-së. Pse kanë heshtur? Si shembull për represionin e regjimit, i njëjti burim e paraqet këtë të dhënë: Sipas të dhënave jozyrtare, në periudhën 1949-1951 janë mbyllur 7.330 gjimnazistë, ndërsa vetëm në burgun e Idrizovës ka patur 2.500 të burgosur politik.

## Vërhovistët

**P**ër nga definicioni, vërhovizmi e shënon zbatimin bullgar të politikës ndaj Maqedonisë dhe çështjen maqedonase. Vërhovistët vijnë nga vijat e mbështetësve të Ivan Conçevit (organizator i Kryengritjes së Xhumajës së Epërme dhe pjesëmarrës në Kryengritjen e Ilindenit). Vërhovistët kanë konsideruar se Maqedonia dhe Odrini mund të lirohen vetëm nga Bullgarët. Të gjithë të cilët në çfarë do mënyre e zbatojnë politikën e Bullgarisë ndaj Maqedonisë, quhen vërhovistë.

Duke filluar nga vetë formimi i VMRO-së dhe parapraakisht TMORO-së, ekzistojnë kontroverse për ideologjinë për të cilën kanë luftuar. Është e pakontestueshme se emëruesi i përbashkët i tyre është lufta për një Maqedoni të mëvetësishme dhe të pavarur, por VMRO-ja ka qenë në favorin e të qenit në kuadër të Bullgarisë. Kthimi në skenë i disa personave të cilët janë cilësuar si bullgarofilë, vërhovistë dhe tradhtarë, e rishqyrton qëndrimin e VMRO-DPMNE-së në pushtet dhe krijimin e saj politik të historisë. Se duhet të mësohet për ta, kjo nuk është e kontestueshme, por, duhet të cilësohet roli i tyre i tillë çfarë ka qenë, pozitiv apo negativ. Sipas më shumë faqeve dhe forumeve të internetit, Vanço Mihajlovi e ka shndërruar VMRO-në në një organizatë terroriste, kur vjen në krye të kësaj organizate në vitin 1928.

# Pjesa II

*Duke i praktikuar parimet e metodologjisë së hulumtimit veprues, konkluzionet të cilat pasojnë në vazhdim, dalin nga marrja krahasuese me aspektet e kulturave lokale të kujtesës së ngjarjeve dhe personave historik në Maqedoni, me përpunim empirik dhe analizë të tezave të parashtruara në artikuj të botuar në media, mendime individuale të shprehura dhe polemika në forume të ndryshme, analiza shkencore të ekspozuara në mënyrë sistematike në vepra të botuara, si dhe nga bisedat e bëra me historianë, politikanë dhe ekspertë të tjerë dhe aktivistë shoqëror.*

*Materiali i këtillë pastaj duhet të shërbejë si një bazë pikënisëse njohëse nga e cila duhet të ndërtohen koncepte të ardhshme "paqësore" të veprimit, në drejtim të pajtimit të palëve në konflikt (ndëretnike, ndërpartiake, ndërkulturore etj.), që e tërheq nevojën për t'u parashtruar dhe përshkruar arsyet dhe rrethanat nga të cilat dalin konfliktet e tilla, duke e ndjekur metodologjinë e njëjtë të hulumtimit.*

## Institucionalizim mjaft i vonuar i historiografisë

**P**ër një histori maqedonase të institucionalizuar mund të flitet vetëm pas formimit të shtetit të parë bashkëkohor në vitin 1944 dhe hapjen e mundësive pjesërisht të shfrytëzohen arkivat e vendeve fqinje. (**Darinka Petreska dhe Violeta Açkoska – "Njohja e historisë"**)

Deri atëherë, por edhe më vonë, burime të krijimit të memories kolektive kryesisht mbeten gojëdhënat e drejtpërdrejta, të cilat transmetohen me gjenerata, pa verifikimin shkencor plotësues,

analiza pjesërisht të ngarkuara dhe anësim të kuptueshëm, për shkak të ndjenjës së pjesëmarrjes në bashkësinë e vet, dhe me ndërthurje të vazhdueshme të fakteve me mitet dhe legjendat.

Vepra e parë më voluminoze e cila ka dalë është Historia e popullit maqedonas në tre vëllime, në vitin 1962.

## Lënia anash e konceptit heterogjen e historisë dhe e vendosjes së përmendoreve

**N**garkimi i parë të cilin e sjellë historiografia në vetë fillimet është që krahas konceptit qytetar të deklaruar në lëvizjet revolucionare të maqedonasve nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, pastaj edhe në Deklaratën e ASNOM-it gjatë krijimit të shtetit bashkëkohor maqedonas në vitin 1944, është se mungon koncepti heterogjen i Historisë së parë të Maqedonisë. Arsyetimi i historianëve është se identiteti i maqedonasve është më së shumti i shtypur, ndërsa historia e tyre është interpretuar në mënyrë kontradiktore në historitë e shteteve përreth.

Politika sot vetë vendos edhe për vendosjen e përmendoreve dhe shquan persona të caktuar. Gjithçka shkon në mënyrë pretencioze, nuk niset nga realiteti i cili 6-7 shekuj është e vërteta për Maqedoninë, e kjo është heterogjenia e popullatës, e kulturave, feve, traditave etj. Kjo mund të rezultojë me një zonësim në terren me shënimin me përmendore, siç bëhej, praktikisht, deri më tani me minaret dhe kishat, gjegjësisht me objektet fetare.  
**(Vllado Popovski në intervistë për Civilin)**

Pesë vëllime të reja të edicionit kapital "Sfidat maqedonase" sot u promovuan në portën "Maqedonia". Këto botime u janë dedikuar personave dhe ngjarjeve historike, të cilat kanë lënë shenjë të thellë në historinë maqedonase, Goce Dellçevit, Va-

sil Çakallarovit, Todor Aleksandrovit, Risto Shishkovit dhe Luftërave Ballkanike. Në promovim morën pjesë kryeministri Nikolla Gruevski, ministrja e kulturës Elizabeta Kançeska – Milevska dhe kryeredaktori dhe redaktori përgjegjës i projektit “Sfidat maqedonase” Rade Siljan... Ministrja Kançeska – Milevska theksoi se ky edicion ofron fakte, argumente dhe interpretime shkencërisht të justifikuara, të cilat flasin për historinë e gjatë të luftës maqedonase për shtetësi dhe vetëvendosje... Nëpërmjet këtij edicioni, qytetarët e Republikës së Maqedonisë mund të fitojnë dituri të shumta për rajonet e njohura dhe të panjohura nga e kaluara jonë, për dukuritë dhe proceset më të rëndësishme në historinë më të re të Maqedonisë, për kodin luftarak të popullit maqedonas dhe për fuqinë revolucionare dhe shpirtërore në realizimin e qëllimeve shtetërore, tha Kançeska – Milevska. Projekti “Sfidat maqedonase” parasheh botimin e 25 publikimeve ekskluzive, të cilat janë të pasuruara me filma dokumentar, e deri më tani janë promovuar nëntë botime. **(Ministria e Kulturës e RM-së)**

Deputeti i PDSH-së Bekim Fazliu, e shkoqi propozimin e Programit për shënimin e ngjarjeve jubilarë dhe personave të rëndësishëm për vitin 2013 dhe e hodhi në drejtim të kryetarit të Kuvendit, Trajko Veljanovski. Një pjesë të tij hodhi edhe drejt sallës, duke shikuar në drejtim të radhëve të BDI-së. Sipas Fazliut, PDSH është e pakënaqur nga zgjedhja, por edhe nga ngjarjet kulturore të cilat janë paraparë për shqiptarët e Maqedonisë dhe e akuzoi BDI-në për atë se nuk janë përfshirë datat e rëndësishme të shqiptarëve. **(MK News – Fazliu e shkoqi programin për jubile dhe e hodhi drejt Veljanovskit)**



## Ngjyrosje ideologjike e historisë në federatën komuniste jugosllave

**N**ë periudhën nga konstituimi i shtetit bashkëkohor maqedonas në kuadër të federatës jugosllave në vitin 1944, deri në pavarësimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 1991, historiografia maqedonase zhvillohej në kuadër të amzës tradicionale gjithëjugosllave, gjegjësisht në kuadër të federatës jugosllave, shtetit me proveniencë komuniste. Në interpretimin e historisë, gjegjësisht në instrumentalizimin e historisë në krah të ideologjisë komuniste... u inkuadruan edhe ata intelektualë, politikanë dhe publicistë, madje edhe revolucionarë dhe kadro partiak, të cilën jo vetëm që nuk ishin historianë për nga profesioni, por disa prej tyre mezi kishin arsim solid të mesëm ose fare s'e kishin, por ishin vetëm kadro partiake me një arsimim komunist-partiak, pa përgatitje teoretike dhe metodologjike nga fusha e shkencës historike. Ata morën për detyrë ta interpretojnë historinë në pajtim me teorinë e imponuar marksiste-leniniste dhe të patriotizmit gjithëjugosllav. ***(Darinka Petreska dhe Violeta Açkoska – Njohja e historisë)***

Kjo është koha e historiografisë ideologjike të ngjyrosur e gjeneratës së mesme, 1970-1990, kur historia bëhet e padrueshme. ***(Vllado Popovski në intervistë për Civilin)***

## Ngjyrosje ideologjike e historisë edhe pas pavarësimit

**E**dhe pse me pavarësimin u hap rruga e “demokratizimit” gradual të historisë dhe u vendos nevoja e rileximit të historisë, disa pasues të ideologjisë së mëparshme dhe të së majtës historiografike iu kundërvunë tendencave të tilla. Kjo polemikë e ashpër zhvillohej në mediat “Puls” dhe “Nova Makedonija”. Vazhdon deri më sot të qëndrojë diku në ajër interpretimi “korrekt” i historisë sa u përket popujve të ish-Jugosllavisë, e vazhdon të “kultivohet” disponimi antishqiptar, antibullgar dhe antigrek.

U vendosën kualifikimet “patriotë” dhe “tradhtarë” mes historikanëve maqedonas, varësisht nga qasja historiografike.

Edhe pas vitit 1991 mbetën disa momente ideologjike. Do ta përmend Enciklopedinë e Maqedonisë në dy vëllime, të cilën e botoi AShAM. Enciklopedia e sforcon linjën e Maqedonisë Antike dhe nuk e paraqet në mënyrë korrekte përbërjen heterogjene. **(Vllado Popovski, në intervistë për Civilin)**

## Seleksionim dhe falsifikim

**N**ë interpretimin e të dhënave historiografike dhe përzgjedhjen e fakteve historike, bëhet seleksionimi i fakteve, ngjarjeve dhe personave historik, i cili bëhet në dy drejtime. Siç është seleksionimi i jashtëm, i cili do të thotë përjashtimin e elementeve historike të huaja, pa dallim të relevancës së tyre në prodhimin e proceseve historike dhe përjashtimin dhe seleksionimin sa i përket elementeve historik të veta. Seleksionimi i këtillë është i motivuar në mënyrë të barabartë për arsye ideologjike, politike, fetare, tradicionale dhe të tjera. **(Strashko Stojanovski – Roli i historisë nacionale në ndërtimin e memories kolektive)**

Kufizimi edhe i historianëve të mirë madje ishte se, për shembull, Orde Ivanovski, për Dimo Haxhi-Dimovin askund nuk përmend se lufton për një Maqedoni autonome të pavarur dhe të bashkuar, por se ndjehet si bullgar. Katarxhievi në një intervistë thotë se Goce Dellçevi ka quajtur veten bullgar dhe se kurrë s'ka konsideruar se Maqedonia duhet t'i bashkohet Bullgarisë, e disa historianë këtë e konsiderojnë si shpifje. *(Vllado Popovski, në intervistë për Civilin)*

Kryengritja e Ohrit shumëkush nuk e di se fare ka ndodhur. VMRO, në bashkëpunim me shqiptarët e armatosur të Maqedonisë fillojnë një kryengritje kundër ushtrisë serbe, të ashtuquajturën Kryengritje e Ohrit dhe Dibrës në pjesën jug-perëndimore të Maqedonisë, në shtator të vitit 1913, një muaj pas Marrëveshjes së Bukureshtit. Kryengritja e Tikveshit fillon 3 muaj më parë. Për arsye politike dhe ideologjike, këto kryengritje kanë qenë të ndaluara dhe të dënuara me haresë. ***(Lupço Zoreski – Kryengritja e Ohrit dhe Dibrës 1913)***

Heshtet fakti se një pjesë e VMRO-së ka qenë për bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë, ndërsa termet të krishterë, greko-ortodoks dhe bullgaro-patriarkistë, zëvendësohen me maqedonas. ***(Strashko Stojanovski – Roli i historisë kombëtare në ndërtimin e memories kolektive)***

Me metoda të ndryshme të represionit, agjitimit, interpretimeve të njëanshme, kontrollit mbi historianët etj., në kuadër të historiografisë zyrtare maqedonase damkoseshin ose largoheshin nga memoria kolektive e popullit maqedonas shumë veprimtarë, revolucionarë, persona të rëndësishëm për kombin, por joadekuat për ideologjinë. ***(Violeta Ačkoska – Paradokse historike dhe bashkëkohore maqedonase dhe rasti me Venko Markovskin)***

Arsyeja për tabuizimin e Njësisë Partizane të Shkupit është e lidhur me rolin e Shatorovit në lëvizjen komuniste dhe kombëtare

të Maqedonisë dhe përplasja e tij me kreun e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, gjegjësisht ngritjen e Kolishevskit. Harresa e rolit të Njësisë është pjesë e përplasjes mes Titos dhe Sharlos, ndërsa përpjekjet për fshirjen e Sharlos nga historia është në të njëjtën mënyrë si dhe përpjekja për fshirjen e Pavel Shatevit, Çentos, Panko Brashnarovit etj. Heroina kombëtare Vera Aceva në një letër drejtuar Tempos, thotë: "Shpejt pas çlirimit, në një mbledhje më të gjerë të KO të PKM, Kemal Sejfulla, i cili ishte luftëtar i Njësisë së Parë Partizane të Shkupit, u ngrit dhe pyeti se pse kësaj njësie nuk i shënohet përvjetori? Atëherë, në befasi të madhe, para të pranishmëve është drejtuar Kolishevski dhe ka filluar të bëjë me dije se Njësia e Parë Partizane e Shkupit nuk ka ekzistuar. (*Ego – Fakte dhe falsifikate*)

## Partizimi i festave, gjegjësisht i ngjarjeve dhe personave historik

**M**argjinalizohet ASNOM-i. E tërë lëvizja partizane u nis nga tradita e Ilindenit. Në vend që të lidhen, shtyhet në plan të parë Ilindenit, e lihet anash gjenerata e cila e krijoi këtë shtet. Ky është një moment ideologjik, me të cilin partizohet historia, partizohen kujtimet dhe përmendoret. Sikur ASNOM-i të jetë i LSDM-së, ndërsa Ilindenit sikur është i VMRO-DPMNE-së. (*Vllado Popovski, në intervistë për Civilin*)

Për 23 Tetorin, Gordan Georgievi i LSDM-së thotë: "As që e kemi festuar, as që kemi ndërmend ta festojmë këtë festë, sepse mendojmë se ajo është vendosur vetëm për të bërë manipulim partiak-politik mbi qytetarët. Më së miri do të ishte që partia VMRO-DPMNE ta ndërrojë emrin vetëm në DPMNE dhe të tregojë se trashëgimie e VMRO-së historike u takon të gjithë qytetarëve, jo vetëm një partie. Atëherë të gjithë së bashku do ta festojmë këtë festë". (*Utrinski vesnik*)

Silvana Boneva nga VMRO-DPMNE, nga ana tjetër, konsideron se nuk mund të barazohet festa partiake me festën shtetërore të Luftës Revolucionare Maqedonase, prandaj është e paarsyeshme mungesa e LSDM-së. “Kjo është ditë e Luftës Revolucionare Maqedonase, e cila u kushtohet viktimave për lirinë e sotme, Maqedonisë së mëvetësishme dhe të pavarur, nuk është festë e partisë VMRO-DPMNE dhe s’duhet në këtë mënyrë të nënçmohet festa. ***(Utrinski vesnik)***”

“Ideja për Maqedoninë e bashkuar dhe të mëvetësishme nuk mund të partizohet, sepse ajo ekziston, para së gjithash te populli. Lufta për shtet të pavarur i bashkoi të gjitha opsionet të cilat u paraqitën në periudhën e kaluar – nga viti 1893 dhe formimi i VMRO-së, deri në ASNOM të vitit 1944. Prandaj, në plenumin e tij janë prezent Metodija Andonov Çento, Panko Brashnarov, Pavel Shatev, por i keni edhe komunistët”. Kjo është përgjigjja e historianit Todor Çepreganov në pyetjen se a u paraqitën në rrugën drejt shtetit të mëvetësishëm ndarjet aktuale partiake-mediale, se Ilindeni i dytë është pjesë e antifashistëve të komunistët dhe se pavarësia është ide vetëm e VMRO-DPMNE-së dhe prandaj 8 tetori nuk është motiv për bashkimin e të gjithë qytetarëve? ***(Aleksandar Çomovski – Maqedonia e pavarur – historia në lëvizje)***”

## Ndryshimi i emrave të rrugëve dhe shënimi i vendeve më përmendore – objektivizim i historisë

**N**dodhë një ndryshim masovik i emrave të rrugëve me propozim të partisë në pushtet VMRO-DPMNE, që nxiti reaksion te qytetarët dhe te partia opozitare LSDM.

Dritare të thyera, tension, nervozizëm dhe akuza për tradhti kishte para Kuvendit të Qytetit të Shkupit, pasi disa dhjetëra, kryesisht simpatizantë të LSDM-së, u përpoqën të hyjnë në seancën për riemërimin e rrugëve. "Sot nga historia jonë fshihet Stiv Naumovi, heroi vetëflijues për Maqedoninë e lirë dhe të pavarur, e në vend të tij, vendoset gjakatarin më i madh i popullit maqedonas, Todor Aleksandrov", akuzoi LSDM-ja. (*Grid*)

Nga ana tjetër, historiani Vllado Popovski e arsyetoi aktin e riemërimit të rrugëve, si një objektivizim i domosdoshëm i historisë. "Ka emra të cilët në tërësi e humbën rëndësinë për Qytetin e Shkupit dhe, në kuadër të kësaj dhe në mënyrë kumulative edhe për Maqedoninë, të cilët ishin emra të partizanëve pak të njohur, komunistë në lëvizjen komuniste apo në lëvizjen partizane në republika të tjera, një pjesë e të cilëve në republikat ku kanë lindur tanimë nuk janë në sistemin e rrugëve... Do të ketë emërim të rrugëve të revolucionarëve të spikatur të VMRO-së, të cilët për arsye ideologjike gjatë sistemit të kaluar fare nuk janë përmendur. (*Vllado Popovski – MIA*)

Rrugët Millan Millutinoviq, Kumrovec – vendlindja e Josip Broz Titos, Vasilie Gjuroviq, 7 Korriku – dita e kryengritjes serbe, Rudo (qytezë në BeH, ku është formuar ish-APJ), Agimi Socialist – gazeta socialiste, Nadezhda Krupskaja – bashkëshortja e Leninit, Ho Shi Min, Boris Kidriç, Shtatë Skoecat, AVNOJ... duhet të shkojnë në histori dhe të zëvendësohen me revolucionarët maqedonas dhe persona dhe ngjarje të cilat kanë dhënë kon-

tribut për shtetin maqedonas, konsiderojnë historianët. Meritat e tyre do të mbeten të shënuara në histori, por s'ka nevojë sipas tyre të emërohen rrugë në Shkup dhe në Maqedoni – thotë historiani Gjorgji Çakarjanovski nga Instituti për Histori Kombëtare. Debati për atë se a është i nevojshëm zëvendësimi i emrave të rrugëve, shesheve, bulevarëve dhe urave në metropol. **(Mariela Trajkovska – Sugjerime nga historianët për emrat e rrugëve në Shkup)**

Domethënë, për këtë profil të personave historik lidhur me identifikimin kombëtar apo kauzën e Maqedonisë, të cilët nuk kanë qenë komunistë dhe disa komunistë të cilët gjithashtu në mënyrë të theksuar e kanë kultivuar vijën kombëtare, siç është Kuzman Josifovski Pitu, për shembull, Mihajlo Apostolski më vonë... përmendore të tilla sigurisht se mungojnë... Do të kishte argumentim se nuk bëhen përmendore në kushte të krizës në të cilën mund të zhytemi më tej, apo nëse tregohet fatale për tërë këtë, por unë nuk besoj në këtë. Kritikët me këtë tezë jo vetëm që nuk kanë ndërtuar përmendore, por edhe shumë gjëra të tjera, ndërsa buxhetet në periudhë prej 12-13 vjet janë harxhuar deri në denarin e fundit. **(Vllado Popovski për BBC)**

# Interpretim i ndryshëm i domethënies së RSFJ, AVNOJ dhe ASNOM

**P**eriodha e RSFJ-së interpretohet në mënyrë të ndryshme nga dy partitë më të mëdha. Nga njëra anë, e majta vazhdon ta ngritë domethënien e RSFJ-së për Maqedoninë, ndërsa e djathta historiografike këtë periudhë e cilëson si represive për idenë e pavarësisë së Maqedonisë dhe si periudhë në të cilën nën tururën ideologjike të Partisë Komuniste, shumë maqedonas janë dënuar me robëri dhe kanë qenë të persekutuar për shkak të konceptit të tyre kombëtar.

E ndryshme është ndjenja ndaj kësaj periudhe edhe mes qytetarëve.

Edhe 70 vjet pas formimit të RSFJ-së, shtrohet pyetja për karakterin ekonomiko-politik dhe kulturor në bashkësinë e dikurshme jugosllave, që bazohet në jugonostalgjinë disadekadashe (***A jeton miti për Jugosllavinë e Titos – Telegraf MK***)

Gjenerata ime dhe ato afër simes me nostalgji e kujtojnë skenën artistike të përbashkët jugosllave, të aktivizmit artistik dhe të rrjedhës së papenguar të informacioneve. Por, kujtojnë edhe depërtimin e vogël të artistëve maqedonas në këtë skenë ( me disa përjashtime, në memorie më kanë mbetur shpërblimet nga Sterijino Pozorje të tandemit Unkovski-Stefanovski) – **thotë kulturologia Loreta Jakovleva – Georgievska. (për Telegraf MK)**

29 Nëntori është festë kombëtare e vërtetë në Maqedoni. Atëherë është krijuar shteti maqedonas. Dy Gushti është vetëm një vërtetim i vendimit të AVNOJ-it. Nëse në plenumin e AVNOJ-it është vendosur që Maqedonia të jetë Kraina e Vardarit, edhe më tej s'do të kishim shtet, si Shumadia dhe Dalmacia. (***Koment i një lexuesi në Utrinski vesnik***)

A keni pyetur veten pse pikërisht më 2 gusht është plenumi i ASNOM-it. Edhe atëherë është kërkuar kontinuitet. Nderime për



Titon, mirëpo me këtë përçmohen njerëzit të cilët kanë dhënë jetën për Maqedoninë. **(Koment i një lexuesi në Utrinski vesnik)**

29 Nëntorin (2011), ditën e dikurshme të Republikës, askush nuk e shënoi në Shtip. Askush as që rikujtoi për vlerën dhe rolin e Plenumit të Dytë të AVNOJ-it. Harresa e shpejtë e datave dhe ngjarjeve të rëndësishme për popullin maqedonas flasin se mosrespektimi i të kaluarës është mosrespektim i të ardhmes. **(Radio Shtip)**

Në janar të vitit 1945, me një mision special, të fshehtë, për izolim përfundimtar dhe largim të kryetarit të Presidiumit të ASNOM-it, Metodija Andonov Çento, në Shkup vjen dr. Darko Çernej, kryeshef i njësisë për ndërtimin e pushtetit popullor pranë NKOJ. Gjatë bisedës me anëtarët e Drejtorisë për ndërtimin e pushtetit popullor dhe me kryetarin e Presidiumit të ASNOM-it, Llazar Kolishevski, Çernaj ka propozuar që të bëhet një ndarje e re administrative e Maqedonisë. Deklaratë e Aleksandar Rankoviçit: "Çento e shfrytëzon çdo situatë kundër partisë. Në Maqedoni vazhdimisht duhet të kemi një shok të sigurt. Pastaj, në këtë kontekst, Rankoviç konkludon: "Lazo është shoku më i mirë, më pozitiv". **(Bllazhe Minevski – Si Titoja i bëri puç Presidiumit të ASNOM-it)**

Do të ishte gjë e dëmshme dhe e pashembullt që Jugosllavia të hidhet në plehrat e historisë. Vetë historia do ta dënojë atë që do të përpiqet. **(Predrag Matveviç – Jugosllavia nuk do të përfundojë në mbeturinat e historisë)**

**Te maqedonasit mbisundojnë këto dy qëndrime:**

1. Pa Titon Maqedonia do të kishte më shumë sesa ka tani.
2. Pa Titon Maqedonia nuk do ta kishte as këtë që ka tani.

Kundërshtarët e Titos i përmendin represionet më të ashpra mbi kundërshtarët e Jugosllavisë, mbi mbështetësit e idesë për një shtet të pavarur maqedonas. Sipas të dhënave jozyrtare, në peri-

udhën 1949-1951 janë mbyllur 7.330 gjimnazistë dhe vetëm në burgun e Idrizovës ka pasur 2.500 të burgosur politik. Për numrin e të përndjekurve, të burgosurve dhe të dënuarve me bindje të ndryshme politike nga regjimi ekzistues komunist, mjaft flasin 14.000 dosjet politike të cilat i ka përpunuar Shërbimi për Siguri Kombëtare në kuadër të MPB-së dhe 22.000 dosjet e të burgosurve politik në burgun e Idrizovës, apo gjithsej 36.000 dosje. Udhëheqësit e lindenit të dytë maqedonas në asnjë rast nuk e kanë paramendur Jugosllavinë si një bashkësi unitare, por si një shtet në krijim, në të cilin Maqedonia në masë të madhe do të jetë e pavarur. (*Makedonska nacija*)

Kuzman Josifovski Pitu, Mihajlo Apostollski, Metodij Shatorov Sharlo, si persona të cilët me veprat e veta e shënuan epopenë heroike katërvjeçare, të cilët u inkuadruan thellë në LNÇ, por vepra e të cilëve, siç duket, ende nuk është hulumtuar në mënyrë të mjaftueshme dhe as që është shënuar në mënyrë dinjitoze. (*Branko Gjorgjevski – "Tito dhe Tempo i shfarosën heronjtë maqedonas"*)

## Persona kontrovers

**E**kzekutimi politik i Metodija Andonov Çento ka qenë proces në të cilin kanë qenë të përfshirë disa veta, por figura kyçe në të me siguri ka qenë L Lazar Kolishevski, e Kardeli është njëri nga urdhëruesit kryesor. Si person më i rëndësishëm në atë periudhë, Kolishevski patjetër ka pasur fjalën kryesore rreth arrestimit të Çentos, konsideron luftëtari Pero Ivanovski – Tikvar. (Branko Gjorgjevski – "Lazar Kolishevski ka dhënë aminin për eliminimin e Çentos?")

A do të rishqyrtohet një pjesë e historisë për trajtimin e Metodija Shatorov – Sharlos, për të cilin kemi mësuar se është armik i popullit maqedonas? Pas shkarkimit nga funksioni udhëheqës i

PK-së dhe largimit nga partia, Sharlo ka kërkuar të dalë me partizanët për të luftuar kundër fashistëve, por kryesia e re e partisë nuk i ka lejuar. Është vrarë më 4 shtator 1944 te Pazarxhiku. Vdekja e tij ende është e paqartë. **(Viktor Cvetanovski – "Sharlo apo Lazo – tabuja e fundit e komunizmit")**

Llazar Kolishevski, pasardhësi i tij në funksionin e sekretarit të Komitetit Krahinor të PKJ-së për Maqedoni, në veprën "Aspekte të çështjes maqedonase", të gjitha dobësitë e organizatës partiake në Maqedoni i shpjegon me "politikën kriminale të Sharlos", për shkak të "tendencave të tija të pakapërcyeshme autonome... për krijimin e njëfarë Maqedonie 'të mëvetësishme' dhe 'të pavarur'". **(Metodija Shatorov – Sharlo – "Dokumente dhe materiale" Arkivi Shtetëror i RM-së)**

Metodija Shatorov Sharlo është një person i jashtëzakonshëm në historinë maqedonase dhe për mua personalisht është në nivel më të lartë se Titoja, por Sharlo më shumë se 50 vjet është në margjinat e historisë maqedonase vetëm për shkak se nga ana e Titos dhe Kominternës, për shkak të pabindshmërisë, ka qenë i shpallur si tradhtar dhe kundërrevolucionar. **(Prof. Dr. Çepreganov, në një tribunë shkencore për Metodija Shatorov – Sharlon)**

Deri më dje të gjitha zbulimet historike tregojnë se Aleksandrovi ka qenë një agjent bullgar dhe spiun i pallatit mbretëror, ndërsa tani paraqitet si një nga revolucionarët më të mëdhenj. Pak është e shpejtuar kjo. Bëhet fjalë për një person kontrovers, i cili ngrit shumë polemika edhe në rrethet shkencore. Historia e deritanishme Aleksandrovit e ka paraqitur si bugarofil, si bashkëpunëtor i pallatit mbretëror bullgar dhe si ekzekutor i shumë revolucionarëve dhe veprimtarëve maqedonas për Maqedoni të lirë dhe të pavarur. **(Prof. Novica Veljanovski, për MKD)**

Zbulimet më të reja tregojnë se Todor Aleksandrovi ka qenë njëri nga revolucionarët dhe luftëtarët më të mëdhenj për pavarësi dhe liri. "Ndoshta deri më tani ai konsiderohej si një person

kontrovers, por tani, pas zbulimit të një numri të madh dokumentesh, shihet se Aleksandrovi është njëri nga revolucionarët dhe luftëtarët më të mëdhenj për Maqedoninë e pavarur dhe të lirë. Ekzistojnë dokumente, shënime, të cilët tregojnë se ai është përpjekur për bashkimin e të gjitha forcave në luftën për Maqedoni të pavarur dhe dokumente që tregojnë se ai e sulmon politikën e Bullgarisë ndaj Maqedonisë. **(Zoran Todorovski, drejtor i Arkivit Shtetëror të Maqedonisë, për MKD)**

Bëhet fjalë për atentatin të cilin e kanë kryer pjesëtarë të VMRO-së autonomiste mbi gazetarin manastiras Spasoe Haxhi Popoviqin dhe përzierjen në këtë atentat të vojvodës së vjetër të komitëve, Kërsto Londev. Bëhet një analizë detajore e ngjarjeve lidhur me këtë atentat, e hulumtimit policor, e arsyeve të cilat pushtetin okupator serb e ka shtyrë të konstruktojë një rekonstruktion, në të cilin është arrestuar dhe vrarë Kërsto Londevi. **(Dr. Aleksandar Litovski – “Kërsto Londevi dhe vrasja e Spasoe Haxhi Popoviqit në Manastir”)**

Përmendorja e Kolishevskit i ndau qytetarët e Sveti Nikollës. Disa e mbrojnë dhe e lartësojnë emrin e tij, e të tjerë konsiderojnë se përmendorja është “turp për popullin maqedonas”. Kolishevski personalisht është përgjegjës për arrestime, përndjekje dhe vrasje të njerëzve të pafajshëm, deklarojnë nga VMRO-DPMNE. “Ai është një person i shquar në historinë maqedonase dhe luftëtar për liri. Ishte kryetari i parë i Qeverisë së Republikës Popullore të Maqedonisë dhe kryetar i kuvendit popullor, si dhe anëtar i kryesisë së RSFJ-së. Është shpallur hero i popullit”, deklarojnë në Lidhjen e Luftëtarëve.

Venko Markovski dhe Metodi Andonov Çento kanë qenë shumë të afërt, ndërsa një periudhë të caktuar Venkoja ka pasur marrëdhënie të mira edhe me Mihajlo Apostolskin, si dhe me një grup të tërë në të cilin kanë bërë pjesë Bogoja Fotev, Petre Piruze, Panko Brashnarov, Pavell Shatev dhe Dimitar Vllahov. Ky grup i kundërvihet serbizimit të Maqedonisë të kryer nga L Lazar

Kolishevski, Vidoje Smilevski, deri atëherë i panjohur për këdo, Cvetko Uzunovski – Abaz dhe të tjerë. UDB-ja u ballafaqua me çdonjërin prej tyre. I pari u dënua Çento me 11 vjet burg; Shatevi dhe Brashnarovi u shkarkuan dhe më vonë u dënuan. ***(Bllazhe Minevski – "Venkoja refuzoi të shkruajë se është me Titon dhe Kolishevski e dërgoi në Goli Otok")***

Vetë fakti se një udhëheqës popullor i paplotësuar i yni (Vanço Mihajlovi) më shumë se shtatëdhjetë vjet do të shëtisë nëpër vendet e afërta e të largëta, për ta ndërtuar jashtë Maqedonisë ëndrrën e lumturisë maqedonase, nuk ka asnjë bazë praktike. ***(Gane Todorovski, në parafjalën e librit "E tashmja njëqindvjeçare" e Verolub Andonovskit)***

Është fakt se lufta revolucionare për Maqedoni ka dy lloj revolucionarësh, një pjesë e cila i ka takuar organizatës revolucionare me emrin TMORO, me qëllim përfundimtar – autonomi, Maqedoni të pavarur, me ndjenjë kombëtare maqedonase, dhe pjesa tjetër e cila i ka takuar Komitetit Suprem Maqedonas nga Sofja, më vonë i quajtur VMRO, me qëllimin përfundimtar të luftës së tyre revolucionare – Maqedoni autonome, në kuadër të shtetit të Bullgarisë, duke u ndjerë si pjesëtarë të këtij populli. Për këto arsye, është e palogjikshme të përdoret termi konflikte vëllavrasëse. Të përbashkët e kanë pasur atë se të dy palët kanë luftuar për Maqedoninë, por qëllimet e tyre kanë qenë diametralisht të kundërt. ***(Koment i një lexuesi në Utrinski vesnik)***

Vanço Mihajlovi megjithatë është pjesë e luftës historike revolucionare e Maqedonisë dhe rolin e tij historik nuk mund ta mohojmë. Ai është organizator i atentatit më të njohur në gjysmën e parë të shekullit XX – atentatin mbi mbretin Aleksandar, absolutist i njohur, i cili dëshironte ta asimilojë dhe ta serbizojë popullatën maqedonase. Ai dha publicitet në publik e përgjithshëm botëror për VMRO-në dhe Maqedoninë. ***(Koment i një lexuesi në Utrinski vesnik)***

Atentati i Mara Bunevës mbi nëpunësin serb Velimir Preliq është një pjesë e strategjisë terroriste e VMRO-së së Mihajlovit. Për këtë vepër është përgatitur në Sofje. Në Maqedoni është kthyer në maj 1926, ndërsa nga vendlindja e saj Tetova, është shpërngulur në Shkup me qëllim për të vvarë ndonjë udhëheqës të pushtetit serb. Është punësuar në një dyqan rrobaqepësie dhe ka qepur veshje për gratë e politikanëve të njohur serb. Ka jetuar me qira te një familje fqinje me të vvarin Preliq. Tre plumba ka krisur mbi Preliqin dhe një mbi veten. Të plagosur rëndë e kanë dërguar në spital. Ka vdekur ditën e ardhshme. Policia e ka varrosur në vend të fshehtë, kështu që sot askush nuk e di varrin e saj. **(Maqedonia është gjithçka)**

Mes maqedonasve të cilët kanë qenë të arrestuar në Goli Otok, më të njohur janë: Panko Brashnarov, Venko Markovski, Petre Piruze, Bogoja Fotev, Vladimir Polezhanovski e të tjerë. **(Kombi maqedonas)**

Në vitin 1991, rekrutët tanë janë mobilizuar në masë të madhe për një Vukovar, për disa për interesa të huaja, ndërsa njeriu ynë i parë i atëhershëm (Kiro Gligorovi) (së bashku me partinë e tij) ka marrë një pozitë pat. As këndeje, as andej... Dhe, për ndryshimin e kushtetutës, emrit, flamurit, as mos flasim. Ai është njeriu i cili e ka vënë nënshkrimin e fundit për çfytirizimin e tërë shtetit dhe kombit maqedonas. **(Koment i një lexuesi në Veçer)**

**Kishim dy probleme të mëdha:** njëri ishte lidhur me nevojën e Maqedonisë për ta mbijetuar krizën jugosllave, pa hyrë në luftë. Sepse kjo ishte periudhë e luftërave të përgjakshme në territoret e tjera në Jugosllavinë e atëhershme. Sfida tjetër ishte që në një mënyrë bashkëkohore, demokratike dhe të civilizuar ta ndryshojmë sistemin shoqëror. E kryem me sukses rolin tonë dhe kjo gjithsesi është meritë e Gligorovit, sepse ai kishte rol kyç në shtet. Për Gligorovin duhet të thuhet edhe diçka, e kjo është se nga të gjithë që morëm pjesë në vitin 1991 në krijimin e pavarësisë, është i vetmi i cili mori pjesë edhe në ASNOM në vitin

1944, kur faktikisht u krijua shteti ynë, në atë kohë si republikë federale në Jugosllavinë e atëhershme. **(deklaratë e Stojan An-dovit për Veçer)**

“Unë nuk e di nga kush të ruhem? Nga pushteti serb, i cili vazhdimisht po më ndjek, apo nga komunistët në Maqedoni, të cilët më vënë kurthe të ndryshme dinake. Mbeta pa punë, me ditë s’kisha për bukë. Lutja këta, lutja ata, kërkoja punë gjithandej. Nuk mund të duroja më dhe pas lutjeve të gjata, fitova një vend në bibliotekën e Shkupit. A kam faj që duhej të jetoj prej diçkaje?” – Kosta Racin. Përgjegjësit në parti kanë konsideruar se Racini e ka përçmuar partinë se si anëtar i saj, ka kërkuar punë te Bani. **(Bllazhe Minevski – “Koço Racini dhe Kole Nedellkovski do të vriteshin së bashku në Sofje?!”)**

Emrat dhe veprat e Pavell Shatevit, Panko Brashnarovit, Vlladimir Polezhanovskit, Vasill Antevskit – Dren, Alekso Demnijevskit – Bauman, Dimitar Vllahovit, Mirçe Acevit, Strasho Pinxhurit, Cvetan Dimovit, Orce Nikollovit, Vera Cirivirit – Trena, Geras Cunevit, Petre Piruzes – Majski... edhe pse deri më tani kanë qenë të shënuar në mënyra të ndryshme edhe në vendlindjet e tyre, janë një pjesë e makinerisë e cila duhet të fitojë vlera më të mëdha sesa deri më tani. Heronjtë të cilët me vepra të veta e shënuan epopenë katërvjeçare me të cilën populli maqedonas i vuri themelet e shtetit të vet, u përfshinë thellë në LNÇ, por vepra e tyre vazhdon të mos hulumtohet mjaftueshëm e as të shënohet në mënyrë dinjitoze. **(Branko Gjorgjevski – “Tito dhe Tempo i shfarosën heronjtë maqedonas”)**

Dhjetëra mijëra maqedonas u tubuan në kryeqytetin e Shkupit për t’ia shprehur mirëseardhjen ish-pjesëtarit të policisë Johan Tarçullovski, i cili kaloi tetë vjet burg për krime lufte, të kryera gjatë konfliktit të vitit 2001, të shkaktuar nga grupet militante shqiptare – transmetoi Washington Post – Johan Tarçullovski u prit në aeroportin e Shkupit nga ana e kryeministrit konservativ Nikolla Gruevski dhe përfaqësues të qeverisë, ndërsa kthimi

i tij transmetohej drejtpërdrejt në disa televizione. Tarçullovski 39-vjeçar u dënua nga tribunali në vitin 2008 për vrasjen e tre civilëve shqiptarë dhe për shkatërrimin e 12 shtëpive gjatë akcionit policor.

Analisti politik shqiptar Albert Musliu deklaroi se pritja ka rezultuar me dëshpërim të pakica shqiptare. "Do ta kuptoja që kthimi i tij të festohej nga ana e familjes së tij, miqtë dhe të tjerët, të cilët kanë bërë pjesë në anën e tij gjatë konfliktit të vitit 2001. Por, mbetet e hapur çështja se a meritonte kjo gjë festë kaq të madhe dhe prezencë të përfaqësuesve të qeverisë. Unë jam i dëshpëruar që u mbajt ky manifestim për një njeri i cili është dënuar për krime lufte në vendin e vet". (***Uashington Post: "I dënuari për krime lufte i pritur si hero në Maqedoni"***)

Me thyerjen e pllakave përkujtimore dhe busteve, disa përpiqen ta rishqyrtojnë pjesën e historisë e cila nuk u pëlqen, të tjerë për ta mbuluar paditurinë, të tretët ta plotësojnë hapësirën e zbrazët të cilën e ka lënë shteti, konsiderojnë historianët. Sipas "rregullës", rregullisht thuhet pllaka përkujtimore të cilën e vendosin për nder të Mara Bunevës në Shkup, ndërsa bustet e luftëtarëve të LNÇ-së rrokullisen të rrëzuar nga postamentet nëpër parqet lokale, deri te plehërishtat me hekur të vjetër. Ka ardhur koha organet kompetente maqedonase t'i ndërtojnë një përmendore Mara Bunevës, e një i tillë ka ekzistuar deri në vitin 1944, sepse ajo ka dhënë jetën për Maqedoninë e lirë", thotë Zoran Todorovski, drejtor i Arkivit Shtetëror të Maqedonisë. Me vlerësime të ngjashme, më konkretisht për "serbizimin" e politikës maqedonase, dolën edhe shoqata joqeveritare shqiptare, pas vendosjes së përmendores së Car Dushanit serb, në qendër të Shkupit. (***Dojçe Vele***)

Ndarja e Maqedonisë (ndjenja e viktimës) dhe tendenca për bashkim (***ambicie për shtet të madh: Maqedonia e Bashkuar***)

Nga Kongresi i Berlinit deri në Luftën e Parë Botërore, çështja



maqedonase ka paraqitur një problem më të rëndë, më të komplikuar dhe më afatgjatë, me të cilin është ballafaquar Perandoria Osmane dhe fuqitë e mëdha. Është krijuar atëherë kur fuqitë e mëdha janë përpjekur t'i realizojnë interesat e veta në Ballkan, ndërsa vendet fqinje ta pushtojnë Maqedoninë.

Një faksimile e faqes së parë të marrëveshjes antidemokratike të Bukureshtit: ka pasur për qëllim ta shkatërrojë ndërgjegjen e popullit maqedonas për mëvetësinë e tij kombëtare. **(Sitel)**

Dodunovska Makedonija: Maqedonasit kanë pasur pushtet në erën e vjetër dhe të re mbi Gadishullin Ballkanik. Kanë qenë Filipi dhe Aleksandri i Madh, që ka vazhduar edhe në erën e re, kur pushtetin e Perandorisë Romake e marrin mbretërit me prejardhje nga Maqedonia si Gadishull Maqedonas, e vetëm nga viti 1809, kur Cojne e inkuadruar shprehjen Ballkan... Në shumë harta Maqedonia ka qenë deri te Danubi. **(Dr. Risto Ivanovski – "Shqiptarët dykontinental dhe dyracor i ashtuquajtur popull")**

Para një qind vjet, të tre shtetet ballkanik, fqinj të Maqedonisë – Serbia, Greqia dhe Bullgaria – hynë në luftë kundër turqve, jo vetëm për t'i larguar osmanlinjtë nga Ballkani, por, njëkohësisht, për ta okupuar dhe për ta ndarë Maqedoninë, sipas një plani për të cilin paraprakisht janë marrë vesh. Kuptohet, ky plan menjëherë u realizua në terren, gjegjësisht çdo njëra prej tyre i mori ato pjesë të cilat i dëshiroi si një pre lufte. **(Bllazhe Minevski – "Luftërat Ballkanike i rivendosën kufijtë historik të Maqedonisë")**

Me Marrëveshjen e Bukureshtit, për shkak të apetiteve të pangopura të borgjezisë rumune, bullgare dhe serbe, u nda dhe u vodh edhe Maqedonia, pa u pyetur maqedonasit dhe vllëhtë, të cilët ishin një popullatë dominuese në këto hapësira. Për shkak të sipërpërmendurës, Bashkësia për Kulturë e Vllëhëve nga Maqedonia para publikut ndërkombëtar demokratik dhe të civilizuar, nga fuqitë e mëdha – anëtare të Këshillit të Sigurimit

të KB-ve dhe Gjermanisë, nga Bashkimi Evropian, nga Këshilli i Evropës, OSBE-së, Paktit për Stabilitet dhe Bashkëpun i Evropës Juglindore, Grupit Ndërkombëtar të Krizës dhe të gjitha institucioneve dhe personave me ndikim nga Evropa dhe bota, del me kërkesën në vijim: Marrëveshja Paqësore e Bukureshtit të anulohet, ndërsa konkluzionet të shpallen si tragjedi i shekulit XX për Ballkanin, sidomos për popullin vllah dhe maqedonas, e me këtë të anulohen të gjitha mbetjet e dëmshme ndaj kësaj hapësire. **(Dimo N. Dimçev – “Marrëveshja e Bukureshtit është asgjësuese”)**

Fuqitë e mëdha dhe vendet fqinje, shumë herë në të kaluarën çështjen maqedonase janë përpjekur ta zgjidhin në pajtim me interesat e veta. Të njëjtat fuqi të cilat me Marrëveshjen e Bukureshtit në vitin 1913 dhe Marrëveshjen e Versajës në vitin 1919 e ndanë Maqedoninë, e pastaj u përpoqën në vitin 1944/45 ta pengojnë krijimin e shtetit maqedonas, duke i anuluar gjatë kësaj arritjet e popullit maqedonas në luftën nacionalçlirimtare katërvjeçare dhe të drejtën për vetëvendosje, bashkim dhe krijim të shtetit të mëvetësishëm maqedonas, sot përsëri përpiquen nëpërmjet kontestit me emrin ta kontestojnë edhe të drejtën për mbijetesë të vendit. **(Makedonska nacija)**

Nuk jeni maqedonas të vërtetë nëse nuk ëndërroni për këtë Maqedoni (të bashkuar) – shtet kombëtar i popullit maqedonas me gjuhë maqedonase zyrtare, valutë stater. Atyre që nuk janë maqedonas, do t’u shkruajmë shenja udhëzuese për “jashtë”. **(Forum Kajgana)**

Pero Antiqi me përshëndetjen “Maqedoni e bashkuar”: Treshen e parë në NBA ligë e shënoi me përshëndetjen “Maqedoni e bashkuar” me dorën e majtë. **(Kurir)**

Komitët përбетohen për “Maqedoni të bashkuar”: Komitët edhe në raundin e parë pranveror krijuan një atmosferë të shkëlqyer në arenën “Filipi i Dytë”, në përballjen me Rabotniçkin. Kishin

koreografi të përgatitur dhe u përbetuan për "Maqedoni të bashkuar". Në tribunën perëndimore u vendos transparenti "Të përbetohem se do të jesh e bashkuar 1913-2013". (*Ekipa*)

Afise me hartën gjeografike të Maqedonisë së madhe u gjetën nëpër makina në Qendrën e Shkupit. Krahas hartave, në gjashtë faqe ka edhe tekste të fjalorëve në të cilët përshkruhet Ballkani dhe përhapja historike e shtetit bullgar dhe grek, në llogari të Maqedonisë. (*Forum Vodenica*)

Porta e Gruevskit me hartën e Maqedonisë së madhe: Porta Maqedonia përmban reliefë të cilët interpretohen si pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje. Ajo është pjesë e projektit "Shkupi 2014". Dilemat juridike vijnë nga mesazhet në Portën "Maqedonia", ku ka harta problematike, të cilat e paraqesin Maqedoninë me territore të Greqisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë së sotme. (*Utrinski vesnik*)

## Ambicie për një shtet të madh: Shqipëria e madhe

Një hartë provokuese e Shqipërisë së Madhe u paraqit në facebook profilin e kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame në vend, reis ul ulemasë Sulejman Rexhepi. Fotografia me një titull bombastik "Shtetet e Bashkuara të Shqipërisë", në të cilën janë paraqitur "territore shqiptare etnike", të cilët hyjnë thellë në kufijtë e Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi, është vendosur në profilin e tij nga një person tjetër, të quajtur Adelina Sufi. "Bashkësia e shteteve shqiptare është vullnet i Zotit, njëjtë sikur bashkimi nën një flamur dhe në të njëjtin vend ku Zoti i cakton kufijtë. Ne kemi për obligim t'i kthejmë ashtu siç kanë qenë më parë. Bashkimi i forcave i popullit shqiptar në të gjitha nivelet do të bëhet realitet, ndërsa Shqipëria do të ketë një kufi të vetme, atë që e ka krijuar Zoti. BFI me të gjithë kapacitetet e veta është

e gatshme të kontribuojë për kauzën kombëtare dhe t'i përgjigjet çdo thirrjeje në drejtim të bashkimit të të gjithë shqiptarëve" – ka deklaruar në një intervistë Sulejman Rexhepi. (**Dnevnik**)

Para selisë së Parlamentit Evropian në Bruksel u promovua harta e Shqipërisë së Madhe. Zonat e kuqe janë Shqipëria dhe Kosova, e me ngjyrë hyri janë territoret të cilat duhet të jenë në kuadër të Shqipërisë. Maqedonia perëndimore, duke inkuadruar Shkupin, Tetovën, Gostivarin, Dibrenë, Strugën, Ohrin, Manastirin, pjesën jugore të Malit të Zi, pjesën jug-perëndimore të Serbisë në drejtim të Bullgarisë. Harta është prezantuar para selisë së Parlamentit Evropian nga ana e një përkrahësi të protestave kundër vendimit në rastin "Monstra". (**Infomaks**).

Nëse më pyetni mua personalisht, edhe unë si çdo shqiptar tjetër shpresoj në bashkimin, dua bashkim, ëndërroj për bashkimin e të gjithë shqiptarëve, por, pyetja është se si të bëhet kjo? A ekziston një platformë për këtë – manifest, ndonjë dokument? Kjo është e para. Tjetër gjë që dua të them është se si realisht mund të bëhet kjo – thotë Ermira Mehmeti – Devaja, për televizionin tiranas Klan. (**Fama**)

Një grafit për Shqipërinë e madhe shkruar në gjuhën shqipe u shkrua në murin e madh mbështetës në dalje të Tetovës drejt Shkupit dje, përderisa shqiptarët në Maqedoni dhe në tërë rajonin e festonin Ditën e Shqipërisë dhe Ditën e Flamurit Shqiptar. (**Utrinski vesnik**)

"Galup", në bashkëpunim me "Fondin Evropian për Ballkanin", realizoi një anketë sipas së cilës pjesa më e madhe e shqiptarëve të anketuar nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e përkrah krijimin e 'Shqipërisë së Madhe'. Sipas kësaj ankete, 62 për qind të shqiptarëve në shtetin amë, 81 për qind të shqiptarëve në Kosovë dhe më shumë se gjysma e të anketuarve nga Maqedonia, gjegjësisht 51,5 për qind e përkrahin idenë për krijimin e 'Shqipërisë së Madhe'". (**Ohrid.on**)

Me mesazhe të ndryshme, sot demonstruesit protestonin pa shami, pa gurë, pa simbole fundamentaliste, pa thirrjen e Allahut, por, me thirrje 'UÇK', 'Shqipëria e Madhe', 'Ali tradhtari', 'Heshtja është tradhti'". (MKD)

## Interpretim kontrovers i çështjes shqiptare

**E**ashtuquajtur histori shqiptare: "Problemi i etnogjenezës i popullit shqiptar nuk është lehtë të zgjidhet... Ekzistojnë mendime të ndryshme për prejardhjen e shqiptarëve... Vërtetohet se gjuha shqipe ka qenë një përzierje e 'romakëve, sllavëve dhe grekëve', si dhe të shqiptarëve kaukazë-detzinj – arnautë. Pason një gjuhë shqipe triracore. Shqipëria ka qenë maqedonase – e Ohrit... Ilirë kanë qenë vetëm dalmatinasit... Banorëve të provincës së Ilirisë gjuhë e popullit ka qenë vetëm e ashtuquajtura gjuhë sllave. Pastaj, në provincën Iliri kurrë s'ka qenë Shqipëria.. Pra, historia shqiptare është vetëm falsifikat. (Dr. Risto Ivanovski – – "Shqiptarët dykontinental dhe dyracor i ashtuquajtur popull")

## Historia e përbashkët e maqedonasve dhe shqiptarëve

**P**as luftës ruso-turke në vitin 1878, e cila përfundon me Marrëveshjen Paqësore të Berlinit, në kuadër të perandorisë turke nga territoret ballkanike mbetën vetëm edhe Maqedonia dhe Shqipëria. Bëhet fjalë për dy popuj të cilët kurrë në histori (me përjashtim të kryengritjeve sporadike) nuk kanë pasur pavarësi të vet, por përfundimisht kanë pasur mëvetësi kombëtare nga popujt e tjerë të Ballkanit. Përfitimi më i madh dhe me siguri

të vetëm për maqedonasit dhe shqiptarët nga Kongresi i Berlinit është pikërisht pranimi i kësaj mëvetësie kombëtare. Pra, nga viti 1878, maqedonasit dhe shqiptarët paralelisht e çojnë luftën e vet për pavarësi kombëtare, pasojat e së cilës do të ndjehen në periudhën kritike të viteve 1912-1913... Hasan Prishtina arriti të përfitojë autonomi në Parlamentin turk, Jane Sandanski nuk arriti. ***(Dejan Azeski – "Si Shqipëria arriti, e Maqedonia jo, të fitojë pavarësi në Bukuresht?")***

Kuvendi dhe Qeveria e Përkohshme e Republikës së Krushevës: Pas çlirimit të Krushevës, më 4 gusht 1903, është thirrur Kuvendi i Qytetit, i cili ka mbajtur seancë në të cilën është sjellë vendimi për formimin e Qeverisë së Përkohshme, gjegjësisht Këshillin Ekzekutiv të Përkohshëm. Për anëtarë të Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm janë zgjedhur: Dinu Vangel, Nikolaki Balu, Gjorgji Çaçe, Teohar Neshkov, Dimitar Sekullov dhe Hristo Qurqiev. Si-pas etnikumit dhe fesë, në qeveri kanë bërë pjesë: një vllah-patriarkist, një shqiptar-patriarkist, një vllah-nacionalist dhe tre ekzarkistë. Prandaj, Dimitar Sekullovi ka theksuar se ekzarkistët janë të gatshëm të lirojnë dy vende: një turku dhe një pomaku, nëse në të ardhmen do të ketë nevojë për këtë. ***(Republika e Krushevës 1903)***

Të gjendet një emër i përbashkët për Kryengritjen e Ohrit-Dibrës të vitit 1913 kanë propozuar historianët maqedonas dhe shqiptarë, të cilët dje morën pjesë në konferencën e organizuar nga Instituti për Histori Kombëtare në Ohër. Ata dje për herë të parë kuvendonin për këtë kryengritje, të cilën e kanë ngritur maqedonasit dhe shqiptarët kundër pushtetit serb. "Suksesi për t'u ulur në të njëjtën tavolinë është një tregues shumë i madh se mund të merremi vesh dhe në emër të një gjëje që na ka ndarë deri më tani, e bëhet fjalë për një gjë që na ka ndodhur bashkërisht" – tha Katerina Todorovska nga Instituti për Histori Kombëtare. Mes biseduesve të tjerë, Husamedin Alili bën përmbledhje të jehonës së kësaj kryengritjeje në historiografinë shqiptare, Pavle Mitrev-

ski foli për bashkëpunimin e çetave maqedonase dhe shqiptare, e drejtori i Shoqatës së Historianëve Shqiptarë në Maqedoni foli për dhunën e ushtrisë serbe mbi popullatën shqiptare në vitet 1912-1913. Sipas organizatorëve, njëri nga qëllimet e konferencës është që të propozohet ndërtimi i një përmendoreje të përbashkët të kryengritësve maqedonas dhe shqiptarë, të cilët së bashku kanë marrë pjesë në një pjesë të madhe të përballjeve me ushtrinë serbe. ***(Igor K. Ilievski – "Takim i parë i historianëve maqedonas dhe shqiptarë – Do të kërkohet emri i përbashkët për Kryengritjen e Ohrit")***

Domethënë nën presion e pranoni se kryengritja ka qenë edhe shqiptare, e ku janë kryengritjet e tjera: çlirimi i Shkupit nga Hasan Prishtina, Kryengritja e Krushevës, Brigada Maqedonase-Kosovare... për krijimin e këtij shteti kanë meritë pikërisht shqiptarët, të pranuar nga historia bashkëkohore. ***(Koment i një lexuesi në Dnevnik)***

Në të kaluarën, edhe popullata maqedonase edhe ajo shqiptare kanë qenë nën pushtetin e dikujt, gjithmonë janë bashkuar dhe së bashku kanë luftuar për çlirimin nga "i treti". Por, sapo është shpallur pavarësia e shtetit shqiptar, punët kanë filluar të ndryshojnë. Ajo që ka paraqitur rrezik për marrëdhëniet e ndërsjella, ka qenë "protezhimi" i huaj për njërin anë. Si tregues për këtë do të përmend disa aksione të përbashkëta: 1. Stojan Vezenkovi (1828-1897) ka qenë njëri nga ata veprimtarë i cili e ka vënë peng anën e tij morale, shoqërore dhe emotive, në ndërtimin dhe përforcimin e miqësisë shqiptare-maqedonase, në afrimin, lidhjen dhe bashkëpunimin e sigurtë të dy popujve fqinj, i cili ka përdorur edhe një emër konspirativ shqiptar Zeka Bisov. 2. Miqësinë dhe lidhjen maqedonase-shqiptare ka kultivuar edhe Isaija Radev Mazhovski, i cili ka folur mirë shqip dhe ka pasur kontakte miqësore të përhershme me patriotë shqiptarë. 3. Në vitin 1888 është krijuar një këshill shqiptar-maqedonas, me qëllim së bashku të luftojnë për realizimin e aspiratave çlirimtare. 4.

Më 25.12.1892 (06.01.1893) në Bukuresht (Rumani), emigracioni maqedonas-shqiptar e ka botuar numrin e parë të gazetës "Albano-Maqedonia". 5. Në Londër, në vitet 1893/94 ka pasur një përpjekje për formimin e ligës së përbashkët, e cila ka paraqitur një moment të ri në zhvillimin e lidhjeve maqedonase-shqiptare, është quajtur "Liga Kombëtare-Qendrore Shqiptare-Maqedonase". 6. Nga fundi i vitit 1898 në Athinë është krijuar shoqata "Silogosi Shqiptar-Maqedonas". 7. Bashkëpunimi maqedonas-shqiptar në Sofje ka qenë më intensiv, e nga ai ka dalë një propozim-projekt për autonominë e Maqedonisë dhe të Shqipërisë nga 23 shkurti 1899, i përbërë prej 23 pikëve. Në vitin 1902 "Liga Kombëtare Maqedonase-Shqiptare" nga Londra e zmadhon punën e vet, kur Komiteti Ekzekutiv i saj ka lëshuar një thirrje apo apel, i cili nga aktivitetet e Ligës – Stevan Damçev dhe Jashar Beu, është shpërndarë në vende të populluara me shqiptarë dhe maqedonas. Liga ka përgatitur një projekt për autonominë e Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë së Vjetër dhe Odrinit, të përbërë prej 12 anëtarëve. Më 10 maj 1902 ka dalë numri i parë i organit "L'Auotonomie", nga i cili kanë dalë pesë numra. Gazeta ka dalë dy herë në muaj, me moton Maqedonia maqedonasve, Shqipëria shqiptarëve. Sipas programit, "Qëllimi ynë, idetë tona janë marrja e autonomisë edhe për Shqipërinë edhe për Maqedoninë". 10. Nga fundi i shekullit XIX në Maqedoni me një frymë të madhe janë krijuar komitete revolucionare. Këta komitete, nëpërmjet udhëheqësve të tyre, komitët Petre Çaulev, Rinko Xhambazovski, Kosta Leshtar e të tjerë, kanë mbajtur lidhje me patriotë shqiptarë nga Pogradeci. Gjatë një qëndrimi në Shqipëri janë vendosur lidhje me çetën shqiptare të kapitenit Kajo Babiena. Revolucionarët maqedonas kanë pasur baza të veta në shtëpitë e shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë, si Koci Spiri, Naki Tiars, Kolë Tala, Asllan Minarolli, Riza Minarolli, Kosu Orhan Beu e të tjerë. 11. Shefqet Agolli në vitin 1901 ka shkruar: Në atë kohë në zonën e Prespës nuk kishte çeta shqiptare të cilat luftonin për ta rrëzuar robërinë, prandaj kërko-



va që të hyj në çetat maqedonase. Miho Laho më lidhi me një çetë maqedonase, ku edhe ai vetë ishte komitë. 12. Krahas lidhjeve miqësore, janë krijuar edhe lidhje bashkëshortore. Kështu, shqiptari Koli Todi, dhëndër i peshkatarit Kosta Kanevçe, pastaj Koci Spiri, kushëri i mësuesit Kosta Leshtari nga Pogradeci, Tomaqi, kunati i Marko Tomçes dhe të tjerë, kanë kryer shërbime të ndryshme dhe kanë furnizuar armë për Organizatën. 13. Shqiptarët, si furnizues me armë, kanë qenë shumë të besueshëm dhe parimorë. Ata kanë qenë aktiv në rajonin e Gostivarit, Tetovës, Dibrës, Ohrit, Strugës, Kosturit, Janinës etj. 14. Si aktivist i daluar në punën e Organizatës në rajonin e Ohrit është konsideruar Belul Arif Hasaku, i cili për aktivitetin e tij revolucionar, nga këshilli për ndarjen e pensioneve të Ilindenit, në kuadër të Kuvendit Popullor të RPM, ka marrë pension ilindenit. 15. Vazhdim i bashkëpunimit maqedonas-shqiptar mes emigrantëve shënojme në vitin 1904, kur në Vjenë është krijuar Shoqata Humanitare Shqiptare-Maqedonase. Komiteti është udhëhequr nga persona me ndikim, siç kanë qenë profi Aleksandar Ikonov dhe Gjergj Pekmezi. 17. Para fillimit të Luftës së Dytë Ballkanike, në korrik të vitit 1913, Jane Sandanski, së bashku me Stoju Haxhiev, kanë shkuar me mision në Shqipëri, me urdhër të Ferdinandit. Detyra e tyre ka qenë të negociojnë me udhëheqësit shqiptarë për veprim të përbashkët të Bullgarisë dhe Shqipërisë, në rast të një lufte të re. ***(Intervistë me prof. Katerina Todoroska, bashkëpunëtore e lartë shkencore në Institutin për Histori Kombëtare, për Republika)***

Maqedonasit nuk janë në rrezik nga shqiptarët në këtë kuptim të rrezikshmërisë ndaj identitetit. Faktor i dytë i mirë për fillim për ne është historia. S'ka "kujtesa për gjak" serioze mes maqedonasve dhe shqiptarëve. Në fakt, historia deri në vitin 1945 është histori e bashkëpunimit intensiv të VMRO-së historike dhe lëvizjet nacionalçlirimtare të shqiptarëve nga Maqedonia dhe rajoni. Kjo histori, edhe pse për ne maqedonasit është "e fshe-

hur" dhe vazhdon të mos mësohet nëpër libra (për shkak të sindromit të ndikimit serb të Jugosllavive), është histori e lëvizjeve kombëtare. (**Lubomir Danaillov Fërçkovski – "Maqedonasit dhe shqiptarët"**)

Paraqitja e islamit dhe përhapja e tij, kryengritja e Skënderbeut, pashallëqet shqiptare, krijimi i komitetit për lirinë e Shqipërisë, pozita e shqiptarëve në Mbretërinë SKS, Çamëria dhe sjellja e pushtetit grek... Këto janë vetëm një pjesë e mësimeve në pjesën e historisë kombëtare shqiptare në shkollat fillore. Mësimet plotësuese për historinë kombëtare shqiptare do të mësohen nga klasa e gjashtë deri në klasën e tetë. Në librat për klasën e pestë, përmbajtjet janë të njëjta për maqedonasit dhe shqiptarët. Në Byronë për zhvillimin e arsimit thonë se nxënësit maqedonas në shkollat fillore mund të mësojnë sipas zgjedhjes për historinë shqiptare dhe anasjelltas, shqiptarët sipas dëshirës së vet të njihen me historinë maqedonase. Se sa nxënësit shqiptarë dhe maqedonas do të mësojnë për historinë e kombësisë tjetër, do të varet nga arsimtarët. (**Dnevník – "Librat e historisë shkuan në histori"**)

Publiku në Maqedoni vrullshëm reagoi ndaj përpjekjes së arsimtarëve të historisë maqedonas dhe shqiptarë të arrijnë deri te versioni i përbashkët për konfliktin e vitit 2001, kur guerilët shqiptarë nga rajonet veriore dhe veri-perëndimore luftonin kundër policisë dhe armatës maqedonase. Projektin "Të kuptuarit e historisë së tanishme" e realizoi Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konflikteve, në kuadër të Institutit për Hulumtime Sociologjike dhe Politike-Juridike, në bashkëpunimin e Komitetit të Helsinkit. Autorët thonë se ky projekt paraqet një përpjekje thelbësore për tejkalimin e "leximit" historik të njëanshëm, duke u dhënë të rinjve përgjigje për pyetjet e tyre legjitime. Skender Asani, historian me prejardhje etnike shqiptare, i cili merre pjesë në projekt, thotë se kjo paraqet vetëm fillimin. "Filluam me mendime diametralisht të kundërta mes maqedonasve dhe

shqiptarëve. Por, me tolerancë, megjithatë, e filluam rrugën e gjatë të zbutjes së qëndrimeve, për t'u krijuar një pasqyrë reale bashkërisht të pranueshme për ngjarjet. **(Ivan Bllazhevski – "Maqedonia: Leksioni historik i rishikuar e ngacmoi publikun")**

## Kontroverset

**N**ë Maqedoni lugatërohet neovërhovizmi! Maqedonizmi si ideologji kombëtare është i rrezikuar nga brenda, sepse u shtuan vërhovistët e brendshëm. Në kohën kur bëhen patriotë, e në realitet shesin patriotizëm të rrejshëm, maqedonizmi si paraqitje kombëtare është rrezikuar nga brenda. Jo vetëm nga jashtë, armiqtë e jashtëm i dimë, problemi është se tani u shtuan vërhovistët e brendshëm. Vërhovizmi është një paraqitje maqedonase në interesa të huaja. Disa punë, siç është revizionizmi në historiografi, shkojnë në interes të shteteve të huaja, e jo në interes të Maqedonisë. **(Forum Vodenica – "Lustrohen akademikët Tome Serfimovski dhe Bozhin Pavlovski")**

"Ilindenasit luftuan në LNÇ – VMRO ishte me fashistët!" **(reaksion i gjeneralit Todor Atanasovski)**

Pyetja e vërtet nga Lufta e Dytë Botërore, për të cilën ende s'kemi marrë shpjegim, sipas meje, është kjo: Pse komunistët maqedonas, menjëherë pas okupimit bullgar, njëzëri u larguan nga PKJ dhe u bashkuan me PKB? A ishte ky vendim personal dhe privat i kryetarit Metodija Shatorov – Sharlo apo ishte ky vendim i njëzëshëm? Pse lëvizja partizane maqedonase ishte më e dobta në krahasim me të gjitha republikat socialiste të Jugosllavisë... Kësaj teme mund t'ia bashkoj edhe pyetjen: pse në Luftën e Parë Botërore e tërë e majta maqedonase vullnetarisht u bashkua në përkrahjen e okupimit bullgar të Maqedonisë? Për shembull, Gjorçe Petrovi u emërua kryetar komune bullgar në Prilep, ndërsa Dimitar Vllahovi si kryetar komune bullgar në

Prizren. ***(Lubço Georgievski – "Polemika: Pyetja e vërtetë nga Lufta e Dytë Botërore")***

Deri më sot në mënyrë historike-shkencore nuk janë përcaktuar të gjitha detajet e rëndësishme për atë se si erdhi deri te vendimi për ndarjen e Komitetit Krahinor të Maqedonisë nga KQ i PK të Jugosllavisë dhe "bashkimin" e tij me KQ të PK të Bullgarisë. ***(Antun Kolendiq – "Njollat e bardha të historisë maqedonase")***

"Nga fundi i prillit dhe fillimi i majit 1941, Shatorovi ia doli të vendosë lidhje me udhëheqësinë e vet dhe ta marrë pajtimin e udhëheqësisë së vet, deri në sqarimin e situatës, organizata maqedonase të vendoset nën udhëheqje të Komitetit Qendror tonë (bullgar)... Ne menjëherë, me një letër të datës 10 maj 1941, të redaktuar nga Trajço Kostovi dhe Anton Ivanovi (sekretari politik dhe organizativ i KQ i PKB – A.K.), ia paraqitëm Komitetit të Tejkufirit (gjegjësisht Politbyrosë së KQ të PKB, në Moskë – A.K) siç vijon: 'Tanimë vendosëm lidhje me Komitetin Rajonal maqedonas, i cili, në pajtim me PKJ, kalon nën udhëheqjen tonë.'" ***(Cola Dragojçeva – "funksionarja e dalluar e komunistëve bullgarë")***

Intervista e Vera Acevas dhe publikimi i "Ietrës Svetozar Vukmanoviq – Tempos" e saj, edhe pse dukshëm e shkurtuar, krijoi sensacion, jo vetëm te historianët. Në fakt, Aceva, heroinë kombëtare dhe anëtare për shumë vitesh e KQ të Jugosllavisë dhe KQ të Maqedonisë, në mënyrë të ashpër dhe të drejtpërdrejtë e hapi çështjen e riparimit, gjegjësisht të përcaktimit shkencor të historisë së vërtetë në periudhën më të rëndësishme të zhvillimit të formimit shtetëror të Maqedonisë, atë nga viti 1941 deri në vitin 1945! ***(Antun Kolendiq – "Njollat e bardha të historisë maqedonase")***

Udhëheqja e UÇK-së, punëtorët e ndërtimtarisë të "Mavrovës", penda e Likovës dhe varri në Neproshten, janë katër rastet e Hagës në Maqedoni, të cilët u mbyllën, falë Ligjit për amnisti të vitit 2002, si dhe vendimi i Kuvendit për interpretim autentik

të amnistisë nga viti 2011. Ekspertë juridik për "Dnevnik" kohë më parë vlerësuan se krimet e luftës dhe kundër njerëzimit kur-  
rë nuk vjetërsohen, ata nuk mund të amnistohen dhe shteti në  
çdo çast mund të nisë një proces gjyqësor, sepse për këtë s'ka  
pengesë juridike. Për këto vepra, sipas tyre, Prokuroria Publike  
mund të ngrejë një proces edhe pse pas vendimit të Kuvendit  
për interpretimin autentik të amnistisë, me të cilin janë përfshirë  
katër lëndët, Prokuroria i ka vënë lëndët ad akta. Në raportin e  
vitet të kaluar për Maqedoninë, të komisarit për të drejtat e nje-  
riut të Këshillit të Evropës, Nils Muizhnieks, vlerësohet se Ligji  
për amnisti është problematik, sepse u jep amnisti personave të  
cilët seriozisht i kanë shkelë të drejtat e njeriut. Thekson se për  
krimet e luftës s'ka amnisti dhe me të drejtën ndërkombëtare  
ajo konsiderohet e ndaluar. Konkluzioni i Gjyqit Evropian: Është  
jashtëzakonisht e rëndësishme që gjykimi dhe aktvendimi të  
mos kufizohen me dispozita, si për shembull me ligj për amnisti,  
në raste të krimeve më të rënda dhe në këto raste pajtim apo  
amnisti të mos lejohet. ***(Zhana Bozhinovska – "Rastet maqedo-  
nase mbetën të mbyllura me interpretimin autentik")***

Lideri i PDSH-së Arbën Xhaferi deklaroi se i përkrah masat e  
pushtetit zyrtar për zgjidhjen e gjendjes në pjesën veriore të ku-  
firit, sepse pjesa më e madhe është kryer me metoda politike  
dhe diplomatike. Xhaferi theksoi se ka për qëllim të bisedojë me  
të gjitha partitë politike në Maqedoni për nevojën e ndryshimit  
të Kushtetutës, e jo vetëm me kryeministrin Georgievski, sepse  
vetëm në këtë mënyrë mund të arrihen zgjidhje të suksesshme.  
Në sheshin Maqedonia në Shkup, rreth orës 14 u mbledhën disa  
mijëra simpatizantë të PDSH-së, me parulla për paqe dhe drejtë-  
si, të shkruara maqedonisht, shqip dhe anglisht dhe me flamuj  
të kuq, të bardhë dhe portokalli, pa simbole ***(Marsh paqësor i  
PDSH-së në Shkup, 14 mars 2001 – "Zgjidhje për krizën është  
Evropa dhe Kosova e pavarur")***

## Historia dhe politika

**P**ërderisa ne në Maqedoni pohojmë se Nikolla Vapcarovi, Goce Dellçevi dhe Jane Sandanski janë maqedonas, për historianët e Bullgarisë ata janë bullgarë. Ky është interpretimi zyrtar i historisë së dy shteteve, i cili është pasqyruar në librat shkollor. Shembuj të këtillë në Ballkan ka shumë. Nëse për serbët beteja kundër turqve në Zebrenjak – rajoni i Kumanovës, është çlirimtare, për historianët e Maqedonisë ajo është e humbur dhe hyrje në një okupim të ri... Vetëm nëpërmjet diplomacisë historia mund ta pasqyrojë të vërtetën, ose së paku t’i afrojë palët dhe qytetarëve t’ua ofrojë të vërtetën më të pranueshme për numrin më të madh të njerëzve. Lënia e historisë historianëve është në fakt distancim nga thelbi i problemit. Pozita e tillë vetvetiu është vrasëse dhe krijon probleme të reja. Politika pa histori është si druri pa rrënjë, njëjtë sikur edhe që historia pa politikë do të mbetet shterpe (Dirk Lange)... Politikanët dhe diplomatët tanë nuk duhet t’ua hedhin përgjegjësinë historianëve. Nevojitet që në mënyrë të drejtpërdrejtë të kyçen në gjetjen e zgjidhjes për dallimet dhe ngjashmëritë e (pa)tejkalueshme historike. Është koha e fundit që ne, qytetarët e Maqedonisë, të kontribuojmë që dallimet të cilat ekzistojnë mes fqinjëve më shumë të na afrojnë sesa të na largojnë. Të kontribuojmë që historinë ta kemi të përbashkët. ***(Kirilica – "Historia është politike")***

Shoqata e historianëve në Republikën e Maqedonisë në mënyrë më energjike proteston në lidhje me amendamentin 8 të Rezolutës për Republikën e Maqedonisë, të aprovuar nga ana e Komitetit për Punë të Jashtme të Parlamentit të Evropës, me të cilin, në fakt, kërkohet rishikimi i historisë maqedonase. Është absurde që institucione politike merren me çështje të këtilla. Këto janë çështje me të cilat duhet të merren historianët, jo politikanët, duke i përfshirë edhe ata të Parlamentit Evropian. Puna shkencore-hulumtuese, e në kuadër të saj edhe historia, s’duhet të jetë objekt i diktateve dhe ndikimeve politikane. ***(Shoqata e***

***historianëve – Reagim: "Është absurd institucionet politike si PE të merren me çështje historie")***

Qeveri e re, histori e re – ndarje të reja? Përmendoret dhe emërimi i rrugëve duhet të çojnë drejt bashkimit të qytetarëve, e jo drejt ndarjeve, thonë historianët. Në rast se s'ka konsensus për personalitetet e rëndësishme të historisë maqedonase, ka rrezik që çdo garniturë e re politike t'i festojë ata të cilët janë të rëndësishëm sipas tyre. ***(Radio Evropa e Lirë)***

## Gjuha e urrejtjes

**K**rahas komenteve të lexuesve në media, në portalet dhe në forumet në të cilët gjuha e urrejtjes është e shpeshtë kundër atyre të grupit etnik, partiak dhe kulturor kundërshtar, kur flitet për tema, ngjarje dhe personalitete historike, gjuha e urrejtjes vërehet edhe në kontributet e gazetarëve, studime më voluminoze, madje edhe botime të publikuara nga ana e historianëve dhe ekspertëve të tjerë.





# Pjesa III

## Alfabeti shqiptar 1908

**K**ongresi i Manastirit i alfabetit shqip u mbajt më 22 nëntor 1908, ku veprimtarët shqiptarë të kulturës dhe të arsimit e përcaktuan alfabetin shqip. U mor vendimi që gjuha shqipe të shkruhet vetëm me alfabetin latin, me 36 shkronja. Iniciativën për mbajtjen e Kongresit e realizoi klubi shqiptar Bashkimi nga Manastiri. Gjergj Qiriazi dhe Shahin Kolonja kishin rolin kyç në organizimin e kongresit. Shkollat shqipe, lidhjet studentore, shoqatat e historianëve, institucionet universitare në forma të ndryshme e shënojnë luftën e shumë gjeneratave për arsimin shqip. Në Maqedoni në mënyrë tradicionale shënohet 22 nëntori, i cili është festë kombëtare e shqiptarëve.

## Pavarësia e Shqipërisë 1912

**S**hpallja e pavarësisë dhe krijimi i shtetit shqiptar ishin me rëndësi të madhe për popullin shqiptar. Për t'u siguruar fitorja, popullit shqiptar i duhej të luftojë shumë vjet. Lëvizja shqiptare i liroi territoret e populluara me shqiptarë. Kjo është meritë e të gjithë patriotëve shqiptarë, sidomos e patriotit kombëtar dhe diplomatit Ismail Qemali. Vendimi historik për krijimin e shtetit me Deklaratën për Pavarësi të Shqipërisë u soll më 28 nëntor 1912.

Austro-Hungaria ishte e interesuar për një Shqipëri të pavarur dhe ishte kundër krijimit të një shteti të madh sllav, i cili mund të binte nën ndikimin rus, me përjashtim të Bullgarisë, të cilën e shikonin si një aleat.

## Shpërngulja e shqiptarëve në Turqi

**R**eth dhjetë kilometra në jug-perëndim të Manastirit gjendet fshati Porodin. Deri në vitin 1950 ishte i populluar me shqiptarë. Regjimi komunist bëri gjithçka për t'i përzënë shqiptarët prej atje dhe për t'ua konfiskuar tokën, e cila ka qenë në pronësi të bejlerëve të atjeshëm.

Marrja e tokës ishte arsyeja kryesore që banorët e Porodinit për një kohë të shkurtër të shpërngulen në Turqi. Familja e fundit është shpërngulur diku në vitin 1965. Në vendin e tyre janë banuar maqedonas nga Mariova dhe nga Greqia, kështu që 150 familje shqiptare janë zëvendësuar me po aq familje maqedonase. Këtë e rrëfen Tefik Shabani, arsimtar i cili jeton në afërsi të këtij fshati.

## Trazira në Kosovë 1981

**N**ë vitin 1981 shpërthyen trazira në Kosovë në përmasa të mëdha. Këto ishin protesta kundër regjimit serb, i cili shqiptarët i trajtonte si qytetarë të rendit të dytë. Protestat ishin kundër brutalitetit të vazhdueshëm policor, qasjes së pabarabartë deri te drejtësia dhe varfëria nga e cila vuante popullata shqiptare në ish-Jugosllavi. Këto demonstrata kontribuuan për ngritjen e vetëdijes kombëtare. Pa këtë lëvizje nuk do të ndodhnin as demonstratat në vitet në vijim, 1982, 1988 dhe 1990. Sipas karakterit, demonstratat ishin të qeta. Demonstratat ishin në tërësi të paarmatosura dhe nuk paraqisnin kërcënim për organet shtetërore.

## Referendum për pavarësi të Iliridës

**M**ë 11 dhe 12 janar 1992 shqiptarët e Maqedonisë perëndimore organizuan një referendum për autonomi politike dhe territoriale dhe e krijuan Kushtetutën e Republikës së Iliridës. Kjo u bë si reaksion i referendumit për Maqedoni të pavarur në shtator 1991, i cili u bojkotua nga ana e shqiptarëve. Krahas asaj që shumica e shqiptarëve votuan pro në këtë referendum, ai u hodh poshtë. Shqiptarët u ballafaquan edhe me një dekadë sfidash, të cilat kulmuan me një luftë të përgjakur, për t'i siguruar të drejtat e veta.

## Trazira në Bit Pazar 1992

**M**ë 6 dhe 7 nëntor 1992, në Bit Pazar të Shkupit shpërthyen trazira, kur shqiptarët dolën në protestë, në të cilën policia reagoi me brutalitet dhe në të cilën humbën jetën katër persona dhe katërmbëdhjetë të tjerë kishin plagë serioze, ndërsa shumë demonstrues u privuan nga liria.

## Universiteti i Tetovës

**P**ërpjekjet e shqiptarëve për të krijuar një institucion të arsimit të lartë në gjuhën shqipe, Qeveria e Maqedonisë i kundërshtoi ashpër. Më 14 dhjetor 1994, pak para themelimit të Universitetit, qeveria dërgoi forca të shumta policore dhe me buldozerë e rrëzuan objektin ku parashihej të mbahet arsimi në kuadër të Universitetit të Tetovës, atëherë jolegal. Të irrituar nga sjellja brutale e policisë, shqiptarët e Tetovës dolën në protesta. Në përplasjet mes policisë dhe një pjese të demonstruesve kishte shumë të lënduar dhe një demonstrues u vra.

Universiteti Shtetëror i Tetovës u themelua më 4 qershor 1994 në kuvendin themelues të thirrur nga Bashkësia Kulturore Shqiptare në Maqedoni, në cilësi të themeluesit, ndërsa iniciator dhe nënshkrues i dokumenteve për themelimin e Universitetit dhe për emërimin e organeve të përkohshme të universitetit ishte profesor Abdulla Mehmeti, kryetari i Bashkësisë Kulturore të Shqiptarëve të Maqedonisë. Si universitet shtetëror mbetet i papranuar nga pushteti deri në janar 2004, kur u soll Ligji për krijimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

## Lufta në Kosovë dhe kriza me refugjatët 1999

**L**ufta në Kosovë filloi në Prekaz, Drenicë, më 28 shkurt 1998, kur Adem Jashari dhe familja Jashari filluan rezistencë të armatosur kundër policisë dhe ushtrisë serbe. Që atëherë filloi të veprojë Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK).

Fuqitë botërore demokratike dhe progresive menjëherë reagues ndaj ngjarjeve në ish-Jugosllavi. Prandaj, në fillim të krizës së Kosovës ata ishin të detyruar të intervenojnë kundër makinerisë destruktive të Sllobodan Millosheviqit. Bota nuk lejoi një tragjedi si ajo në Bosnjë e Hercegovinë. Më 24 mars 1999, të gjithë kanalet televiziv në tërë botën e paralajmëruan fillimin e bombardimit të NATO-s kundër Serbisë.

Një numër i madh i kosovarëve me dhunë u dëbua nga shtëpitë e tyre në drejtim të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Kryetari i atëherëshëm Kiro Gligorov, në ato çaste të vështira për popullin kosovar, e thirri Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe vendosi në emër të sigurisë të mbyllën kufijtë. Ndaj kësaj ashpër reagoi faktori politik shqiptar në vend, si dhe bashkësia ndërkombëtare, pas së cilës u hap kufiri.

Deri në qershor, numri i shqiptarëve të dëbuar në Maqedoni arriti në 379.523 persona, nga të cilët 92.100 u transportuan në vende të tjera, 154.989 u vendosën në familje shqiptare dhe 112.434 veta u vendosën nëpër kampe.

## Lufta 2001

**L**ufta shpërtheu si pasojë e pakënaqësisë së thellë nga statusi politik dhe juridik të shqiptarëve në Maqedoni. Lufta në vitin 2001 u përkrah nga një numër i madh i shqiptarëve të Maqedonisë, si dhe nga diaspora shqiptare në Evropë dhe ShBA. Lufta në vitin 2001 dhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK) janë jashtëzakonisht të rëndësishme në pjesën e historisë së popullit shqiptar në Maqedoni, si dhe për kombin shqiptar në përgjithësi.

## Marrëveshja e Ohrit

**M**ë 13 gusht 2001, në Ohër u nënshkrua marrëveshja me të cilën iu dha fund konfliktit të armatosur në Maqedoni. Marrëveshja është krijuar sipas pesë parimeve themelore, të cilët u shoqëruan me ndryshime kushtetuese dhe me të cilët u vërtetua karakteri shumetnik i Republikës së Maqedonisë. Marrëveshja Kornizë ka për qëllim të kontribuojë drejt zhvillimit harmonik të maqedonasve, njëkohësisht duke e respektuar identitetin dhe interesat etnike të të gjithë qytetarëve në Maqedoni. Marrëveshja e Ohrit ka për qëllim t'i trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët në Maqedoni, megjithatë në praktikë kjo shumë pak aplikohet. Marrëveshja e Ohrit, si një dokument me rëndësi të madhe ndërkombëtare dhe e afirmuar në nivel global, është pjesë e historisë së popullit shqiptar në Maqedoni.



# Pjesa IV

## On-line burime për historinë e Maqedonisë në gjuhën shqipe

**Ë**shtë për t'u habitur se sa pak materiale ka për historinë e Maqedonisë në përgjithësi, sidomos për atë të periudhës nga viti 1903 e këtej, në internet, në gjuhën shqipe. Në asnjë vend nuk hasëm letërsi profesionale nga historia, por vetëm në mënyrë sporadike, në disa forume, ku vetëm sipërfaqësisht shkruhet për ngjarje të caktuara. S'ka botime të plota, për shembull.

Madje edhe në Wikipedia nëse shkruhet "Historia e Maqedonisë", del një shkrim prej tre rreshtave, në të cilin shkruan për pavarësinë e Maqedonisë në vitin 1991 dhe kundërshtimin e Greqisë të njohjes së pavarësisë për shkak të emrit. Krahas kësaj, ka një shkrim për konfliktin në vitin 2001 në Maqedoni. Në të janë përfshirë disa segmente: kushtet shoqërore-ekonomike dhe politike, arsytet e konfliktit, rrjedha e konfliktit dhe aktivitetet ushtarake në rajon, ndikimi mbi rajonin, roli i parlamentit, qeverisë, policisë dhe ushtrisë në konflikt, kontributi i bashkësisë ndërkombëtare, fundi i konfliktit dhe domethënia e Marrëveshjes së Ohrit, si dhe ndikimi i tij mbi proceset demokratike. Të gjitha këto kategori ndahen në nënkategoritë: version radikal shqiptar, version radikal maqedonas dhe version i përbashkët.

Në portalin informativ mesazhi.com gjendet teksti i publikuar në korrik 2010, i titulluar "Disa fjalë mbi historinë e Shkupit dhe

shpërngulja e shqiptarëve myslimanë në Turqi". Në përshkrimin më të gjatë për shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje, thuhet se ajo ka filluar nga fundi i shekullit XIX dhe ka zgjatur deri në fund të shekullit XX. Shpërngulja ka ndodhur në disa etapa, me marrëveshje të pushtetit të atëhershëm jugosllav dhe turk. Kjo shpërngulje interpretohet si dëbim i shqiptarëve nga ana e sllavëve, ndërsa interesi turk ka qenë që t'i popullojë rajonet e papopulluara të Anadollit.

Në ueb-portalin peshkupauje.com është publikuar një analizë e titulluar "E vërteta e shqiptarëve në Maqedoni dhe shtrembërimi i Enciklopedisë së Shkupit". Në të autori i shqyrton pjesët të cilat kanë të bëjnë me shqiptarët në "Enciklopedinë e Maqedonisë" kontroverse, e botuar në vitin 2009, nga ana e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, e cila më vonë formalisht u tërhoq. Kjo enciklopedi shkaktoi revolt të madh të shqiptarët, të cilët e vlerësuan si një "pamflet të politikës së ditës, përplot me pohime qesharake dhe joshkencore". Në të shkruan se shqiptarët nëpër shekuj në mënyrë të planifikuar e kanë kolonizuar Maqedoninë, ndërsa faza e fundit, ajo e katërta, e këtij kolonizimi ka ndodhur në vitin 1944. Në analizën e publikuar, profesori Kristo Frashëri kryesisht merret me prejardhjen sllave të maqedonasve, duke e mohuar lidhjen e maqedonasve të sotëm me ata antikë, pohim ky i cili gjerësisht është i pranishëm në enciklopedinë e tërhequr. Sa u përket shqiptarëve, ai shkruan: "Nuk është hera e parë të dalin nga rrethet nacionaliste maqedonase fyerje dhe shtrembërimi në dëm të shqiptarëve".

Në kërkim të historisë së Maqedonisë në gjuhën shqipe në internet, u përpoqëm të hulumtojmë ueb-faqe të bibliotekave në Maqedoni. Nuk gjetëm asnjë në gjuhën shqipe. Në ueb-faqen e dy bibliotekave më të mëdha, Biblioteka Popullore Universitare dhe Biblioteka "Vëllezërit Milladinov", fare s'ka publikime elektronike, ndërsa vetë faqet janë vetëm në gjuhën maqedonase. E njëjta gjë ndodhë edhe gjatë kërkimit të librave shkollor.





CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.1:316.7(497.7)

BALLAFAQIM me realitetin : përkujtim i së kaluarës - modelim i ardhmërisë : vështrim gjithëpërfshirës në kulturat lokale të mbamendjes në tri komuna multietnike / autorë Xhabir Deralla... [и др.]. - Shkup : CIVIL - Qendër për liri, 2014. - 134 стр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Автори: Xhabir Deralla, Kirsten Shonefeld, Gordana Duvnjak, Biljana Jordanovska, Arbana Qerimi, Sasho Talevski, Kreshnik Ajdini

ISBN 978-608-65629-6-0

а) Меѓуетнички општества - Културолошки аспекти б) Македонија - Меѓуетнички односи - Социологија на културата

COBISS.MK-ID 97478154





[www.civil.org.mk](http://www.civil.org.mk)

ISBN-10 608-65629-6-2  
ISBN-13 978-608-65629-6-0  
EAN 9786086562960